AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

# RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në:**
**"Elektroenergjitikë"**
**"Universiteti Politeknik i Tiranës"**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**
**Dr. Fatmir Basholli**
**Dr. Alketa Grepcka**

**Shkurt / 2024**

## TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

### Master Profesional në "Elektroenergjitikë"

| | | |
|---|---|---|
| 1 | IAL aplikues: | Universiteti Politeknik i Tiranës |
| 2 | Njësia bazë që e ofron: | Departamenti i Sistemeve Elektrike të Fuqisë |
| 3 | Emërtimi i programit të studimit: | Master Profesional në "Elektroenergjitikë" |
| 4 | Urdhëri/VKM i licencimit: | |
| 5 | Urdhëri/VKM i riorganizimit: | Urdhër MASR Nr. 523 datë 09.09.2022 |
| 6 | Forma e regjistrimit të diplomës: | - |
| 7 | Urdhëri/VBA i akreditimit të parë: | - |
| 8 | Cikli i studimit: | Cikli i Dytë |
| 9 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 2 vite akademike |
| 10 | Kreditet në total (ECTS): | 120 ECTS |
| 11 | Forma e studimit: | Me kohë të plotë |
| 12 | Gjuha (shqip/tjetër): | Gjuha shqipe |
| 13 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera: | - |
| 14 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | - |
| 15 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): | - |
| 16 | Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve: | Niveli i 7 (shttatë) |
| 17 | Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit: | 8 PAE/ 2 PAK |
| 18 | Numri i studentëve: | 2021 – 2022 32 studentë<br>2022 – 2023 24 studentë |
| 19 | Komente / të tjera: | - |

**PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Programi i studimit Master Profesional në "Elektroenergjitikë" zhvillohet në Departamentin e Sistemeve Elektrike të Fuqisë (DSEF) në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike në Universitetin Politeknik të Tiranës i cili është Institucion i Arsimit të Lartë me eksperiencë në fushën inxhinierike dhe me një historik që daton fillimet e tij në vitin 1957. Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike (FTE) përbëhet nga tre njësi bazë respektivisht:

1. Departamenti i Elektroteknikës;
2. Departamenti i Sistemeve Elektrike të Fuqisë;
3. Departamenti i Automatikës;

Programi i studimit ofrohet në Departamentin e Sistemeve Elektrike të Fuqisë. Kjo njësi ofron programe studimit duke mbuluar një program studimi të ciklit të parë, një program studimi të ciklit të dytë Master Shkencor, nje program studimi Master Profesional dhe nje program studimi Doktoraturë. DSEF ka ruajtur në vite numrin e stafin akademik efektiv duke përmbushur standartet ligjore.

Programi i ciklit të dytë Mastër Profesional në "Elektroenergjitikë" është ndërtuar në perputhje të plotë me dispozitat e Ligjit Nr. 10247, datë 04.03.2010, "Për Kuadrin e Kualifikimeve Shqiptare", të ndryshuar. Ky program studimi ka ardhur nga riorganizimi i programit MP. "Elektroenergjitikë", me 60 kredite ECTS (hapur me UMASh Nr. 597, datë 09.12.2011), në MP. "Elektroenergjitikë", me 120 kredite ECTS, me urdher te MAS nr. 523, datë 09.09.2022. Sipas këtij urdhëri, veprimtaria akademike për këtë program studimi të riorganizuar fillon në vitin akademik 2022-2023.

Ky program ofron njohuri dhe zhvillon aftësi dhe kompetenca tek studentët në perfundim të studimeve në programin e ciklit të dytë Mastër Profesional në "Elektroenergjitikë" në perputhje me Nivelin 7 të Kornizës Shqiptare. Programi i studimit në shqyrtim si pasojë e riorganizmit ka një kohëzgjatje 2 vite akademike dhe në total ka 120 kredite. Ngarkesa vjetore është 60 kredite me një numër total të lëndëve dhe moduleve 15, nje Praktikë Profesionale dhe nje Përgatitje Teza e Diplomës. Forma e studimit është me kohë të plotë dhe zhvillohet në gjuhën shqipe.Programi i studimit Mastër Profesional në "Elektroenergjitikë" zhvillon kompetenca të nevojshme për studentin për një formim të specializuar dhe profilizim të tij në fushën e energjitikës.

## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Burimi parësor i informacionit për grupin e punës ishte Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, i përgatitur në Tetor 2023. Ky Raport siguron një pamje të detajuar të sistemeve dhe mekanizmave që ka ngritur FIE/UPT për të përmbushur objektivat e veta si dhe për të arritur efektivitetin e procedurave të tij për menaxhimin e cilësisë dhe standardeve. UPT, po ashtu, nëpërmjet sistemit AMS të ASCAL, vuri në dispozicion të vlerësuesve një numër eviencash mbështetëse. Për realizimin e këtij vlerësimi, GVJ u mbështet kryesisht tek kërkesat e parashkruara nga Ligji Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM Nr.531, datë 11.9.2018 "Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë", VKM Nr.41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë", në VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", në Udhëzimin e MASR Nr. 1, datë 14.1.2020, për "Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e Institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë", Udhëzimin e MASR Nr. 22, datë 3.9.2020, Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin Nr. 1, datë 14.1.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat per hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e Institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë" si dhe gjithë aktet e tjera nënligjore që kanë të bëjnë me organizmin e studimeve në institucionet e arsimit të lartë. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhet nga Dr. Alketa Grepcka dhe Dr. Fatmir Basholli. GVJ gjatë vlerësimit të jashtëm u mbështet nga specialistja e ASCAL, Msc. Majlinda Demirneli. Takimet në institucion, u zhvilluan sipas programit të miratuar nga ASCAL. Takimet në institucion konsistuan në zhvillimin e diskutimeve, me Dekanin e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike, Përgjegjësin e Departamentit të Sistemeve Elektrike të Fuqisë, takim me grupin e vlerësimit të brendshëm për programin e studimit, takim me stafin akademik të angazhuar në programin e studimit, takim me studentët në këtë program studimi. GVJ zhvilloi takime më përfaqësues të Drejtorisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Drejtorisë së Komunikimit & Koordinimit, Drejtorisë së Kërkimit Shkencor dhe Projekteve, Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Drejtorisë së Kurrikulës. Gjithashtu u zhvillua edhe një vizitë e auditorëve, laboratorëve si dhe bibliotekës, shoqëruar me diskutime për elementë lidhur me këtë infrastrukturë. Vlerësimi i programit të studimit u fokusua në analizën e programit, në shqyrtimin e syllabuseve: vendosjen e objektivave të të mësuarit, kompetencat që synohen të fitohen, rrugët nëpërmjet të cilave fitohen (metodat e mësimdhënies), literaturën bazë dhe atë shtesë, mënyrat e vlerësimit të dijeve, përcaktimin e krediteve, kualifikimin e stafit akademik, etj. Informacioni dhe të dhënat që përmban ky raport bazohen në burimet e sipërpërmendura dokumentare, në takimet e zhvilluara, si dhe në materialet shtesë që iu vunë në dispozicion GVJ-së sipas kërkesave të paraqitura.

Universiteti Politeknik i Tiranës është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 10.01.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 38 Prot, datë 10.01.2024. Universiteti Politeknik i Tiranës më datë 05.02.2024, përcjell në ASCAL nëpërmjet shkresës me Nr.86/3 Prot, datë 01.02.2024 " Përcillen komentet mbi Draft Raportin e Vlerësimit të jashtëm për programin e studimit MP në "Elektroenergjitikë".

*Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:*

Për komentin e IAL mbi **standartin IV.4,** GVJ ka vlerësuar paraprakisht Standardin IV.4 në statusin përmbushet "Kryesisht", por duke parë reflektimin e menjëhershëm të Dekanatit, shprehur në vendimin Nr.3 Prot., datë 23/01/2024 të Dekanit të Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike, shkresa Nr. 40/1 Prot., datë 23/01/2024 me lëndë: "*Për unifikimin e metodologjisë për vlerësim të vazhdueshëm të studentëve në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike*", i cili përcakton qartë metodologjinë e vlerësimit të vazhdueshëm të studentëve, ku krahas formatit standard në respektim të Rregullores së zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT, e plotëson edhe me formatin e vlerësimit me pikëzim sipas kurrikulës për cdo lëndë dhe në të gjitha programet Bachelor dhe Master që mbulon FIE. Në zbatim të vendimit Nr.3 të Dekanit, DSEF me shkresë Nr.22/1 Prot., datë 26/01/2024, pasqyron formatin e miratuar që do të ndiqet në vazhdimësi për Programin e Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në "Elektroenergjitikë".

Nga sa më sipër, GVJ konkludon se: Rekomandimi në konkluzionet për Standardin IV.4 është marrë parasysh dhe GVJ e cilëson vlerësimin për Standardin IV.4 në **"Përmbushet Plotësisht".**

**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në "Elektroenergjitikë"**

## I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi I.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë | Universiteti Politeknik i Tiranës është institucion i Arsimit të Lartë me status të personit juridik dhe në qendër të veprimtarisë së tij ka lirinë akademike si nocion universal *[Ref_001 Statuti i UPT, neni 2]*. Programet e ofruara nga ky institucion nuk bien ndesh me interesat kombëtare, madje në të kundër kontribuon në |

| | |
|---|---|
| ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. | rritjen e vlerave të vetë intitucionit dhe të vendit në tërësi përmes ofrimit të programeve të studimit të cilat garantojnë cilësi në mësimdhënie dhe ofrojnë përmes studentëve të diplomuar cilësi në tregun e punës. UPT ofron programe studimi pjesë e të cilës është edhe programi i studimit Master Profesional në "Elektroenergjitikë" të cilat forcojnë vlerat akademike dhe kulturore. Në pikën 6 të nenit 3 në Statutin e UPT theksohet: *"UPT mbështet dhe mbron studentët në ushtrimin e të drejtës së tyre për arsim cilësor dhe siguron përfaqësimin e tyre si partnerë të plotë në qeverisjen e tij. UPT përpiqet në promovimin e mirëkuptimit ndërkulturor, mendimit kritik, tolerancës politike dhe fetare, barazisë gjinore, vlerave demokratike dhe qytetare, në mënyrë që të forcojnë qytetarinë Evropiane dhe globale të studentëve, të cilët do të hedhin themelet për një shoqëri gjithëpërfshirëse" [Ref_001 Statuti i UPT]* |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. | UPT zhvillon veprimtarinë e tij në përputhje me qëllimin, vizionin dhe misionin e tij të cilat shprehen qartë në nenin 3 në Statut të UPT-së. Qëllimi kryesor është përparimi i shkencës, i teknologjisë dhe i arsimit të lartë nëpërmjet integrimit të tyre. UPT promovon dhe rrit rolin e tij në procesin e zhvillimit të shoqërisë, përmes transferimit të teknologjisë dhe informacionit, si edhe shërbimeve për territorin dhe komunitetin. Misioni i tij është:<br>• *të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë e të mbrojë dijet me anën e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve, si edhe të formojë specialistë të lartë dhe të përgatitë shkencëtarë të rinj;*<br>• *të ofrojë mundësi për të përfituar nga arsimi i lartë gjatë gjithë jetës në fushat e tij të ekspertizës;*<br>• *të ndihmojë zhvillimin ekonomik në nivel kombëtar dhe rajonal;*<br>• *të kontribuojë në rritjen e standardeve të demokracisë e të qytetërimit të shoqërisë dhe në përgatitjen e të rinjve për një shoqëri të tillë.* |
| | • *Veprimtaria akademike e UPT zhvillohet në përputhje me parimet dhe standardet e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë (HEAL), duke reflektuar parimet dhe objektivat e Procesit të Bolonjës. [Ref. 1. Statuti i UPT; Ref. 3. Plani* |

| | |
|---|---|
| | *strategjik UPT 19-24].*<br><br>Programi i studimit Master Profesional në "Elektroenergjitikë" ofrohet në përputhje me misionin dhe qëllimet e Institucionit dhe strategjinë për zhvillim të tij *[Ref_010 Plani Strategjik 2019-2024 i UPT.; Ref_011 Plani Strategjik 2019-2024 i FIE; Ref_012 Plani Strategjik 2019-2024 i DSEF_FIE;Ref_005 Strategjia Kombetare e Energjise;]*<br><br>Programi i studimit ka për qëllim të pajisë të diplomuarit me njohuri të thella, profesionale në të gjithë aspektet e punës të Sistemit Elektroenergjitik dhe rrjetave të furnizimit me energji elektrike. Ky program studimi synon tu ofrojë kandidatëvë një diplomë të ciklit të dytë në fushën e Inxhinierisë së Sistemeve Elektroeenergjitike, kompetenca profesionale për problemet e prodhimit (burime konvecionale dhe të rinovueshme), transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, teknologjitë e reja në këtë sistem, rrjetat smart dhe komunikimi ne sistemin elektroenergjitik dhe të sektorit elektrik në tërësi.<br><br>*[Ref_074 Guida Program Studimi (programet e shkurtuara) MP Elektroenergjetikë DSEF].* |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit. | Programi i studimit Mastër Profesional në "Elektroenergjitikë" zhvillohet në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit të Institucionit. Synimet kryesore të Strategjisë së Zhvillimit të UPT (2019-2024) janë pjesë përbërëse e synimeve të këtij program studimi. GVJ konstaton pika kryesore si:<br><br>**1.** Ndërkombëtarizimi përmes rritjes së njohjes ndërkombëtare të diplomës së ofruar në këtë program studimi;<br>**2.** Rritja e veprimtarisë ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor përmes pjesëmarrjes në projekte kërkimore kombëtare, evropiane dhe rajonale;<br>**3.** Zgjerimi i bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e shkëmbimit të personelit akademik;<br>**4.** Intesifikimi i shkëmbimeve të studentëve në përputhje me kornizën e marrëveshjeve dypalëshe;<br>**5.** Zhvillimi i nje infrastrukture të qëndrueshme me synimin në përgatitjen e studentëve me aftësi në fushen e inxhinierisë elektrike; |

| | |
|---|---|
| | Departamenti i Sistemeve Elektrike të Fuqisë (DSEF) pranë Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike zhvillon aktivitetin e tij në akordancë me Planin Strategjik të Zhvillimit të UPT-së dhe të FIE-së. DSEF synon përsosjen dhe konsolidimin e formimit akademik dhe bashkëpunimin me të gjithë aktorët e sektorit elektroenergjitik në vend dhe jashtë tij me qëllim adresimin në kohë të problematikave dhe zgjidhjeve në fushën e tregut të energjisë elektrike, prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, projektimit të rrjetave elektrike të shpënrdarjes, projektimit të furnizimit me energji elektrike të ndërrmarjeve industrial, civile etj. GVJ përmes evidencave dhe takimeve të zhvilluara në institucion konstaton se programi i studimit është në përputhje me synimin e zhvillimit strategjik të institucionin në tërësinë e tij.<br>*[Ref_010 Plani Strategjik 2019-2024 i UPT; Ref_011 Plani Strategjik 2019-2024 i FIE; Ref_012 Plani Strategjik 2018-2023 i DSEF_FIE]* |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar. | Programi i studimit Master Profesional në "Elektroenergjitike" përmes kurrikulumit të tij ka dhënë gjithmonë kontributin ne zhvillimin e vendit përmes ofrimit të breza studentësh te diplomuar në këtë program të cilët tashmë janë ekspertë në fushën e inxhinierisë elektrike. Ky program që në fillesat e tij të formimit ka plotësuar kërkesat dhe nevojat e vendit me inxhinierë të kualifikuar të cilët me kontributin e tyre kanë nxitur në përqasjet e reja teknologjike *[Ref_074 Guida Program Studimi (programet e shkurtuara) MP Elektroenergjetikë DSEF]*. |
| **Konkluzione** | *Programi i studimit Master Profesional në "Elektroenergjitikë" zhvillohet në Departamentin e Sistemeve Elektrike të Fuqisë (DSEF) në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike (FIE) ne Universitetin Politeknik të Tiranës (UPT). Ky program është unik në Republikën e Shqipërisë. Programi është në përputhje me Planet Strategjike të Zhvillimit në nivel institucional, Njësi Kryesore dhe Njësi Bazë. Programi nuk cënon interesat kombëtare dhe ofron përmes brezit të studentëve të diplomuar specialistë në fushën e elektroenergjitikës duke plotësuar nevojat në vend për këtë sektor.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

<table>
<tr><th colspan="2">Standardi I.2<br><br>Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</th></tr>
<tr><th>Kriteret</th><th>Vlerësimi i ekspertëve</th></tr>
<tr><td>Kriteri 1. Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</td><td>UPT zotëron kapacitete dhe burime të duhura për të mundësuar zhvillimin e programit mësimor Master Profesional në “Elektroenergjitikë”. Ky program zhvillohet në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike (FIE) i cili përbëhet nga tre njësi bazë si vijon më poshtë:
<ol>
<li>Departamenti i Elektroteknikës (DE);</li>
<li>Departamenti i Sistemeve Elektrike të Fuqisë (DSEF)</li>
<li>Departamenti i Automatikës (DA);</li>
</ol>
FIE angazhon një staf akademik me përvojë dhe eksperiencë. Të dhënat statistikore të paraqitur nga institucioni në lidhje me numrin e stafit akademik të angazhuar në njësinë bazë ku zhvillohet programi i studimit shprehin një qëndrueshmëri. Për periudhën 2023-2024 dëshmohet angazhimi i nje stafi akademik PAE dhe PAK me eksperiencë dhe me grada shkencore të duhura për programin mësimor konkretisht:
<table>
<tr><th rowspan="2">Kualifikimi i stafit</th><th colspan="2">Departamenti i Sistemeve Elektrike të Fuqisë</th></tr>
<tr><th>PAE</th><th>PAK</th></tr>
<tr><td>Prof.Dr</td><td>2</td><td>-</td></tr>
<tr><td>Prof.Asoc</td><td>-</td><td>-</td></tr>
<tr><td>Dr/PhD</td><td>2</td><td>1</td></tr>
<tr><td>Msc</td><td>6</td><td>3</td></tr>
<tr><td>Gjithsej</td><td>10</td><td>4</td></tr>
</table>
<br>
Në mbështetje të programit të studimit angazhohet edhe një personel ndihmës akademik (1 në total). Institucioni ofron një infrastrukturë të duhur për zhvillimin e programit mësimor me një bazë të gjerë laboratorike.<br><br>
[Ref_017 Tabelat 1-24 Të dhënat tabelore për Departamentin e Sistemeve Elektrike të Fuqisë; Ref_018 Planet dhe programet mësimore; Ref_046 Infrastruktura fizike në UPT; Ref_051</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| | *Laboratoret në FIE dhe Departamentet e saj].* |
| **Kriteri 2.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. | Programi i studimit ofrohet në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike, në Departamentin e Sistemeve Elektrike të Fuqisë. Programet e ofruara në këtë department në total janë 4 për periudhën 2022-2023. Fusha e studimit të Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të programit të studimit. Bazuar edhe në evidencat e paraqitura FIE/DSEF ofron një larmi programesh që variojnë nga niveli Bachelor deri në studime Doktorature në Inxhinieri Elelektrike – Energjitike.<br><br>*[Ref_017 Tabelat 1-24 Të dhënat tabelore për Departamentin e Sistemeve Elektrike të Fuqisë; Ref_018 Planet dhe programet mësimore]* |
| **Kriteri 3.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje. | GVJ konstaton se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike kërkimore të Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike. Konstatimi bazohet në:<br>- Shqyrtimin e permbajtjes se programit mesimor;<br>- Objektivat e programit mësimor që konkludojmë janë në linjë me objektivat strategjik të DSEF-së dhe të FIE-së;<br>- Kushtet e pranimit të studentëve ku theksohet që kandidtët duhet të kenë mbaruar program Bachelor në Inxhinieri Elektrike;<br>- Fusha kërkimore e stafit akademik dhe eksperienca e tyre përkon me fushen e inxhinierisë elektrike;<br>- Baza laboratorike dhe infrastruktura e ngritur mbështesin lëndët në fushën e elektroenergjitikës;<br>- Marrëveshjet e bashkëpunimit dhe fusha kërkimore – shkencore e DSEF-së;<br><br>Për sa më sipër konkludojmë se program studimi është i realizuar në përputhje me Strategjinë Institucionale të UPT-së, direktivat dhe udhëzimet evropiane dhe me Strategjinë Kombëtare të Energjisë.<br><br>*[Ref_056 Njësia bazë dhe programet e studimit që ofrojnë; Ref_057 Numri i Programeve të Studimit FIERef_010 Plani Strategjik 2019-2024 i UPT; Ref_005 Strategjia Kombetare e Energjise]* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Në rastet kur institucioni ofron program "Master profesional" në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere. | GVJ bie dakord me citimin e dhënë në RVB: "*...Programi i studimit Master Profesional në Elektroenergjitikë është brenda profilit të Departamentit të Sistemeve Eektrike të Fuqisë në Fakultetin e Inxhinierisëe Elektrike të UPT-së. Kjo shprehet në Rregulloren e Njësisë Bazë dhe në Strategjinë e Zhvillimit të tij*".<br><br>Për sa më sipër dhe bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni, nga takimet e zhvilluara, GVJ konkludon se cilësia e programit të studimit garantohet nga njësia bazë dhe njësia kryesore pa qenë e nevojshme të ofrohet nga institucionet partnere.<br><br>*[Raporti i Vleresimit te Brendshem Master Profesional ne Elektroenergjetike; dokumentacion nga institucioni; takime në institucion]* |
| **Kriteri 5.** Institucioni i arsimi të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit. | Institucioni në mënyrë të vazhdueshme kryen trajnime për inxhinierët që përfundojnë ciklet e diplomimit. GVJ u njoh me evidenca të tyre dhe në takimet me stafin akademik u shpreh puna në këtë drejtim.<br><br>*[takim më stafin akademik; Ref_027 Evidencë mbi trajnimet e personelit në FIE-DSEF]* |
| **Konkluzione** | *Programi i studimit Mastër Profesional në "Elektroenergjitikë" ofrohet nga një staf akademik me përvojë të angazhuar në DSEF. Programi i studimit është brenda profilit të njësisë bazë dhe njësisë kryesore. DESF ofron një infrastrukturë dhe bazë laboratorike të duhur dhe të përmirësuar në mbështetje të programit të studimit.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi I.3** | |
|---|---|
| **Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.** | |
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni për | UPT ushtron aktivitetin e tij bazuar në dokumenta ligjore |

| | |
|---|---|
| hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. | institucionale të hartuara në përputhje me kërkesat ligjore të ligjit nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shiperisë". Kreu II në Statut përcakton strukturën akademike të UPT-së të cilën GVJ e gjen në përputhje edhe më organigramën e institucionit. Detyrat dhe përgjegjësitë janë dhënë qartë në kapitullin "Autoritete Drejtuese të UPT-së", ku neni 19 dhe 20 përcakton detyrat e autoritetit të njësise kryesore dhe njësisë bazë *[Ref_001 Statuti i UPT]*. Referuar edhe Rregullores së Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies këto detyra përcaktohen qartë ne hartimin dhe zhvillimin e programeve të studimit ku Kreu I – IX përshkruajnë edhe dispozitat ligjore të funksionimit të programeve të studimit të ofruara në këtë institucion *[Ref_037 Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies e UPT]*. Më eksplicite GVJ gjen një ndarje të detyrave dhe përgjegjësive në Rregulloren e Njësisë Bazë dhe ne Rregulloren e Programit të Studimit *[Ref_008 Rregullore Njësi Kryesore FIE; Ref_009 Rregullore Njësi Bazë DSEF_FIE]*. Specifikat në lidhje me lëndët, ngarkesën mësimore dhe detyrimet e studentëve janë dhëne qartë në Rregulloren e Programit të Studimit *[Ref_074 Guida Program Studimi (programet e shkurtuara) MP Elektroenergjetikë DSEF]*. Në këtë kontekst GVJ gjen një kuadër ligjor që buron nga niveli i vendimarrjes deri në nivelin e programit të studimit të institucionalizuar ku secila hallke ka të percaktuar qartë rolin e saj. GVJ konstaton bashkëpunimin edhe me struktura organizative ku përmendet Drejtoria e Bibliotekës Shkencore, Drejtoria e Komunikimit dhe Koordinimit, Drejtoria e Kërkimit Shkencor dhe Projekteve, Drejtoria e Kurrikulave, Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Juridike ku marrëdhëniet janë përcaktuar qartë në rregulloret përkatëse të këtyre strukturave *[Ref_047 Rregullore e Bibliotekës Shkencore; Ref_115 Rregullore e zyrësnjësisë së këshillimit dhe karrierës; Ref_122 Njësia e Sigurimit të Cilësë në FIE Programi I Trasparencës UPT]*. |
| **Kriteri 2.** Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie | Në qendër të strategjisë së zhvillimit të saj UPT ka bashkëpunimin me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit, forcimin dhe zgjerimin e bashkëpunimit me institucione shtetërore dhe kompanitë private. Në këtë kuadër, GVJ gjen dëshmi dhe evidenca të shumta të cilat tregojnë një kooperim të |

| | |
|---|---|
| bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj. | punës midis Departamentit të Sistemeve Elektrike të Fuqisë dhe grupeve të interesit. Konkretisht janë aktive dhe në fuqi:<br>- 13 bashkëpunime me universitete brenda vendit;<br>- 34 marrëveshje me institucione dhe universitete homologe jashtë vendit;<br>*[Ref_019 Marrëveshje Institucionale]*<br>- 55 marrëveshje me industrinë brenda vendit;<br>- 15 marrëveshje me insitucione shtetërore;<br>*[Ref_020 Marrëveshje me Industrinë.]* |
| **Kriteri 3.** Për realizmin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademikt dhe studentëve. | Zhvillimi i praktikës profesionale është përfshirë në programin mësimor të studimit Mastër Profesional "Elektroenergjitikë" vlerësuar me 12 ECTS dhe planifikuar të zhvillohet në semestrin e dytë të vitit të dytë. Në realizimin e saj DSEF mbështetet në marrëveshjet e bashkëpunimit që ka nënshkruar me një sërë kompani në fushën e biznesit *[Ref_019 Marrëveshje Institucionale; Ref_020 Marrëveshje me Industrinë]*.<br>DSEF bashkëpunon ngushtë me OST, KESH, OSHEE si partnere kryesore për kryerjen e praktikës profesionale por edhe të praktikës lëndore e cila është pjesë e planit mësimor dhe inkorporohet në çdo lëndë. |
| **Kriteri 4.** Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. | DSEF ka hartuar raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit. Rishikimi dhe përmiresimi i përmbajtjes së programit mësimor erdhi si bashkëpunim i ngushtë i njësisë bazë me partnerët e saj dhe me intitucionet homologe për të marrë modelin më të mirë. GVJ konkludon se njësia bazë ndjek në mënyrë të vazhdueshme tregun dhe është e aftë të përthithë mendimin më të mirë nga partnerët bashkëpunues të saj *[Ref_095 Projekte Ndërkombëtare (ENGINE) DSEF; Ref_072 Pyetësori mbi permirsimet e programeve të studimit DSEF]*. |
| **Konkluzione** | *DSEF/UPT ushtron veprimtarinë e saj bazuar në dokumenta ligjore te aprovuar nga Senati Akademik. DSEF ka nënshkruar* |

| | |
|---|---|
| | *një sërë marrëveshje bashkepunimi me institucione shtetërore, privatë për kryerjen e praktikës profesionale. DSEF përthith mendimin e bashkëpunëtorëve në lidhje me përmirësimet që kërkohen në drejtim të përmbajtjes së programit mësimor.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## II. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi II.1**<br>**Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). | Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se programi i ciklit të dytë Mastër Profesional në "Elektroenergjitikë" është i ndërtuar në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit Nr.80/2015 "Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Programi i studimit në shqyrtim ka një kohëzgjatje 2 vite dhe në total ka 120 kredite. Ngarkesa vjetore është 60 kredite me një numër total të lëndëve dhe moduleve 17 (15 lëndë, 1 Praktikë profesionale dhe Punimi i diplomës). Forma e studimit është me kohë të plotë dhe zhvillohet në gjuhën shqipe. Programi i studimit në nenin 1 dhe 2 të rregullores së tij përcakton qartë strukturën e programit dhe bazën ligjore mbi të cilin është ndërtuar dhe funksionon. Programi i studimit Mastër Profesional në "Elektroenergjitikë" është program studimi që i referohet nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe mbulohet nga Departamenti i Sistemeve Elektrike të Fuqisë, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike. *[Ref_074 Guida Program Studimi (programet e shkurtuara) MP* |

| | |
|---|---|
| | *Elektroenergjetikë DSEF*].<br><br>Ky program përmban elementet e nevojshem (modulet, lëndët dhe kreditet përkatëse për secilin prej tyre, shpërndarjen në çdo semestër), kushtet e pranimit dhe përzgjedhjes, metodat e vlerësimit të studentëve dhe progresi i tyre, kushtet për transferim dhe çdo element detyrues në përputhje me kuadrin ligjor dhe specifikisht me VKM Nr.41 datë 24.01.2018 (i ndryshuar) dhe dispozitat e dhëna në Kreun III-VIII të Rregullores së zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT.<br><br>*[Ref_018 Planet dhe programet mësimore; Ref_074 Guida Program Studimi (programet e shkurtuara) MP Elektroenergjetikë DSEF]* |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale. | Programi i ciklit të dytë Master Profesional në "Elektroenergjitikë" është ndërtuar në perputhje të plotë me dispozitat e Ligjit Nr. 10247, datë 04.03.2010, "Për Kuadrin e Kualifikimeve Shqiptare", të ndryshuar. Ky program ofron njohuri dhe zhvillon aftësi dhe kompetenca tek studentët në përfundim të studimeve të tyre në përputhje me Nivelin 7 të Kornizës Shqiptare. Programi i studimeve "Master Profesional në Elektroenergjitikë" ka si qëllim tu ofrojë studentëvë një diplomë të nivelit të dytë në fushën e Inxhinierisë së Sistemeve Elektroenergjitike, kompetenca profesionale për problemet e prodhimit (burime konvecionale dhe të rinovueshme), transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, projektimit të rrjetave elektrike të shpërndarjes, projektimit të furnizimit me energji elektrike të ndërmarrjeve industriale e civile, teknologjite e reja në sistemin elektroenergjitik, rrjetat smart dhe komunikimit neë sistemin elektroenergjitik dhe të sektorit elektrik në tërësi.<br><br>*[Ref_018 Planet dhe programet mësimore; Ref_074 Guida Program Studimi (programet e shkurtuara) MP Elektroenergjetikë DSEF]* |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. | Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. GVJ konstaton përfshirjen e praktikës profesionale të përfshirë në kategorine "D" dhe të vlerësuar me 12 ECTS dhe u njoh me zhvillimin e saj nga studentët *[takim me studentët]*. Dokumentacioni i paraqitur nga institucioni shpreh një rrugë ligjore dhe institucionale që njësia bazë ndjek për zhvillimin e |

| | |
|---|---|
| | praktikës nga studenti. Në përfundim të tij studenti paraqet edhe një raport i cili vlerësohet nga komisioni. Neni 14 në rregulloren e programit të studimit përcakton detyrimet e studentit për ndjekjen e praktikës profesionale. UPT dhe njësia bazë kanë nënshkruar shumë marrëveshje bashkëpunimi me institucione shtetërore dhe private për organizimin e praktikave lëndore dhe praktikën profesionale. Në takimin e zhvilluar me shefen e njësisë bazë u theksua shfrytëzimi i hapësirës ligjore për të organizuar praktika lëndore ku studentët kanë mundësinë të shohin konkretisht zbatimin në praktikë të sistemeve të trajtuar në teori dhe në kushtet laboratorike.<br>*[Ref_042 Kartela e Praktikave Mesimore me Studentet MP; Ref_058 Lista e zhvillimit te praktikes mesimore; Ref_069 Praktika mësimore të studentëve në FIE-DSEF; Ref_018 Planet dhe programet mësimore].*<br>Projekti i diplomës zhvillohet në semestrin e dytë të vitit të dytë dhe futet në kategorinë "E" me 12 ECTS dhe zhvillimi i saj përcaktohet qartë në rregulloren e programit të studimit, kapitulli "Diploma".<br>*[Ref_074 Guida Program Studimi (programet e shkurtuara) MP Elektroenergjetikë DSEF; Ref_018 Planet dhe programet mësimore].* |
| **Kriteri 4.** Programet e ciklit të dytë "Master" në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve "Master", sipas fushave përkatëse të formimit. | Jo e aplikueshme |
| **Kriteri 5.** Programet "Master" në fushën e mësuesisë organizohen me | Jo e aplikueshme |

| | |
|---|---|
| 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet "Master", që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme. | |
| **Kriteri 6.** Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin. | Jo e aplikueshme |
| **Kriteri 7.** Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet | Programi i studimit Master Profesional në "Elektroenergjitikë" është unik dhe nuk ofrohet në asnjë IAL në Republikën e Shqipërisë |
| **Kriteri 8.** Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit. | Programi i studimit Master Profesional në "Elektroenergjitikë" shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga MASR. Ky program i përket kodit: **63BA0713S**<br>*[Ref_007 Kodifikimi i Programeve te studimit]* |
| **Kriteri 9.** Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë | Jo e aplikueshme |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi. | | | | |
| **Konkluzione** | *GVJ konkludon se programi i studimit MP "Elektroenergjitikë" është i hartuar në përputhje me dispozitat ligjore. Programi i studimit zhvillohet në 2 vjet, 120 ECTS dhe ka 15 lëndë, 1 Praktike Profesionale dhe Tezës e Diplomës. Plani mësimor jep një shpërndarje të ngarkesës dhe lëndët sipas veprimtarive formuese. Programi i studimit Master Profesional në "Elektroenergjitikë" i përket kodit 63BA0713S* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi II.2**<br><br>**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin. | Programi i studimit Mastër Profesional në "Elektroenergjitikë" ofrohet nga Departamenti i Sistemeve Elektrike të Fuqisë, në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike të Universitetit Politeknik të Tiranës. Organizimi, struktura dhe funksionimi i Njësisë Kryesore dhe Njësisë Bazë janë përcaktuar qartë në Statut *[Ref_001 Statuti i UPT]*. GVJ konstaton se detyrat dhe përgjegjësitë janë të shprehur qartë në bazat ligjore të rregulloreve përkatëse *[Ref_037 Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies e UPT.;Ref_008 Rregullore Njësi Kryesore FIE.; Ref_009 Rregullore Njësi Bazë DSEF_FIE; Ref_074 Guida Program Studimi (programet e shkurtuara) MP Elektroenergjetikë DSEF]*. Dispozitat e këtyre rregulloreve zbatohen nga njësia kryesore dhe njësitë bazë. Rregulloret janë hartuar në përputhje me Ligjin nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë" në Republikën e Shqipërisë, VKM dhe statutin e UPT-së *[Ref_001 Statuti i UPT]*.<br><br>Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike përbëhet nga tre departamente përkatësisht: |

| | |
|---|---|
| | 1. Departamenti i Elektroteknikës;<br>2. Departamenti i Sistemeve Elektrike të Fuqisë;<br>3. Departamenti Automatikës;<br><br>Bazuar edhe në kuadrin ligjor në fuqi GVJ konstaton se njësia kryesore përmbush të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 25 të Ligjit Nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" në lidhje me stafin akademik të angazhuar më kohë të plotë në departamente.<br><br>Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike, si Njësia Kryesore për programin e studimit për vitin akademik 2023-2024 ka gjithsej 42 pedagogë, nga të cilët 32 janë pedagogë efektiv (PAE) dhe 10 pedagogë me kontratë (PAK), me kualifikimin e mëposhtëm: |

| Kualifikimi i stafit | Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike | |
|---|---|---|
| | PAE | PAK |
| Prof.Dr | 4 | 1 |
| Prof.Asoc | 4 | - |
| Dr/PhD | 13 | 1 |
| Msc | 11 | 8 |
| **Gjithsej** | **32** | **10** |

Departamenti i Sistemeve Elektrike të Fuqisë angazhon nje staf akademik me përvojë dhe eksperiencë në fushën e elektroenergjitikës dhe mësimdhënies. Konkretisht kjo njësi bazë për vitin akademik 2023-2024 ka të punësuar:

| Kualifikimi i stafit | Departamenti i Sistemeve Elektrike të Fuqisë | |
|---|---|---|
| | PAE | PAK |
| Prof.Dr | 2 | - |
| Prof.Asoc | - | - |
| Dr/PhD | 2 | 1 |
| Msc | 6 | 3 |
| **Gjithsej** | **10** | **4** |

*[Ref_017 Tabelat 1-24 Të dhënat tabelore për Departamentin e Sistemeve Elektrike të Fuqisë]*

Universiteti Politeknik i Tiranes si IAL në Republikën e Shqipërisë i është akorduar akreditimi institucional me Vendim BA Nr. 1 datë 07.01.2022, me kohëzgjatje 6 vite akademike, afati vlefshmërisë deri më 06.01.2028. Programi i studimit

| | |
|---|---|
| | Master Profesional në "Elektroenergjitikë" i nënshtrohet për herë të parë procesit të akreditimit. Në RVB dhe në takimin e zhvilluar me grupin e vlerësimit të brendshëm u theksua puna në këtë proces dhe angazhimi i të gjithë stafit përmes ndarjes së detyrave dhe përgjegjësive.<br>*[takim me grupin e vlerësimit të brendshëm]* |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj. | UPT ka të përcaktuar qartë angazhimin dhe rolin e stafit ndihmës akademik dhe administrativ në Statut dhe në rregulloret përkatëse. Bazuar në evidencat e paraqitura nga institucioni dhe në takimet e zhvilluara në mjediset e FIE, GVJ konstaton angazhimin e nje stafi ndihmës akademik në mbështetje të programeve të studimit. Konkretisht Departamenti i Sistemeve Elektrike të Fuqisë angazhon 1 staf ndihmës akademik për vitin 20203 – 2024. *[Ref_017 Tabelat 1-24 Të dhënat tabelore për Departamentin e Sistemeve Elektrike të Fuqisë]* |
| **Kriteri 3.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. | Në funksion të programeve te studimit është ngritur edhe Këshilli i Programit të studimit. Roli i tij në programin Master Profesional në "Elektroenergjitikë" jepet qarte në rregulloren e programit të studimit. Kryetari i KPS luan edhe rolin e koordinatorit i cili në përgjegjësinë e tij ka funksionet për të mbështetutr procesin mësimor, mbajtjen e kontakteve me stafin akademik dhe studentët, krijimin e mundësive për marrëveshje të reja bashkëpunimi në kuadër të kurrikulës së programit të studimit.<br>*[Ref_037 Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies e UPT.;Ref_008 Rregullore Njësi Kryesore FIE.; Ref_009 Rregullore Njësi Bazë DSEF_FIE; Ref_074 Guida Program Studimi (programet e shkurtuara) MP Elektroenergjetikë DSEF]* |
| **Konkluzione** | *Programi i studimit Master Profesional në "Elektroenergjitikë" ofrohet nga Departamenti i Sistemeve Elektrike të Fuqisë, në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike të Universitetit Politeknik të Tiranës. DSEF plotëson kriteret ligjore duke angazhuar 10 si staf akademik efektiv (PAE) dhe 4 si PAK. Në funksion të programit të studimit vepron edhe Këshilli i Programi të Studimit.* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi II.3<br><br>**Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. | Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Departamenti i Sistemeve Elektrike të Fuqisë disponon të gjithë informacionet e nevojshme për organizimin dhe vënien në funksionim të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në "Elektroenergjitikë". GVJ konstaton si më poshtë dokumentacionin më kryesor:<br>- *Statut të UPT-së;*<br>- *Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies e UPT;*<br>- *Rregullore e Fakultetit të Inxhinierise Elektrike;*<br>- *Rregullore e Departamentit të Sistemeve Elektrike të Fuqisë;*<br>- *Procedurë mbi zgjedhjen e drejtuesve të grupeve mësimorekërkimore shkencore;*<br>- *Rregullore e programit të studimit Mastër Profesional në "Elektroenergjitikë"*<br>- *Plani mësimor i programit të studimit Mastër Profesional në "Elektroenergjitikë"*<br>- *Syllabuset e lëndëve për programin e studimit Mastër Profesional në "Elektroenergjitikë";*<br>- *Udhëzues dhe manual për zhvillimin e mësimit në distance;*<br>- *Praktikë miratimi për program të riorganizmi studimi-DSEF;*<br>- *Raport i aktivitetit mësimor në nivel njësi bazë DSEF-FIE;*<br>- *Raport i aktivitetit kërkimor në nivel njësi Bazë DSEF_FIE;* |

| | |
|---|---|
| | - *Miratimi i kritereve të pranimit në MP Elektroenergjitike;*<br>- *Raportet për kapacitetet pritëse në UPT;*<br>- *Praktika Transferimi Studimesh;*<br>- *Pasqyrë e realizimit të ngarkesës mësimore FIE;*<br>- *Praktika mësimore të studentëve në FIE-DSEF;*<br>- *Procedure e Miratimit te temes se diplomest DSEF;*<br>- *Aktivitete informuese mbi programet e studimit;*<br>GVJ konstaton se një pjesë e këtyre të dhënave janë publike dhe të aksesueshme në faqen e institucionit *[https://fie.upt.al]*. |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit. | Organizimi i programit të studimit Master Profesional në "Elektroenergjitikë", si dhe lëndët e ofruara në të janë në përputhje me kërkesat e një programi të ciklit të dytë të studimeve, siç janë të përcaktura në VKM nr. 41, 24.01.2018. Programi është i ndërtuar mbi njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimit, dhe krijon mundësi në thellimin e njohurive në përputhje me kriteret e vendosura. Referuar programit të studimit ndarja sipas kategorive në të cilat përfshihen lëndët dhe modulet është si më poshtë:<br>- *Kategoria A: 12 ECTS;*<br>- *Kategoria B: 42 ECTS;*<br>- *Kategoria C: 12 ECTS;*<br>- *Kategoria D: 12 ECTS;*<br>- *Kategoria E: 18 ECTS;*<br>Për këtë program studimit GVJ konstaton një shpërndarje të duhur të lëndëve sipas disiplinave në çdo semester: |

| Semestri | Disiplina "A" | Disiplina "B" | Disiplina "C" | Disiplina "D" | Disiplina "E" |
|---|---|---|---|---|---|
| Sem I | 1 | 3 | 1 | - | - |
| Sem II | 1 | 2 | 2 | - | - |
| Sem III | - | 2 | 3 | - | - |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Sem IV** | - | - | - | 1 | 1 |
| **Total** | 2 | 7 | 6 | 1 | 1 |

Studimet janë organizuar në lëndë e module dhe vlerësohen në kredite sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe të Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programet janë të organizuara në përputhje me të gjitha udhëzimet e MAS. Gjuha e programit mësimor është gjuha shqipe. Numri i lëndëve është 15, duke shtuar edhe praktikën mësimore dhe mbrojtjen e diplomës, janë 17. Lëndët janë të ndara sipas semestrave dhe krediteve për të balancuar peshën e orëve në auditor. Programi zgjat 2 vite akademike me katër semestra, dy në vitin e parë dhe dy në vitin e dytë. Çdo semestër ka 30 ECTS, ndërsa viti akademik 60 ECTS. Format kryesore të mësimdhënies jane leksionet, seminaret/ushtrimet, punët laboratorike, detyrat e kursit, projekte, praktika lëndore etj. Numri total i veprimtarive formuese është 15, ku zhvillohen 15 provime, praktika dhe teza e diplomës. Studenti zhvillon 25 orë/javë në auditor. Mësimi zhvillohet gjatë gjithë javës paradite. Sipas planit mësimor në vitin e dytë, përgjatë gjithë semestrit të dytë studenti frekuenton "Praktikën Profesionale" e cila është 12 ECTS, ndërkohë që po në fund të semestrit të dytë të vitit të dytë ai mbron edhe temën e diplomës e cila është 18 ECTS.

Programi i studimit MP "Elektroenergjitikë" përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj. Plani mësimor si elementi bazë i programit të studimit përmban:

- *Ndarjen e lëndëve sipas aktiviteteve formuese;*
- *Ndarjen e lëndëve sipas viteve dhe semestrave;*
- *Dhënien për secilën lëndë të ngarkesës në kredite, numrit total të orëve, numrit të orëve në auditor;*
- *Ndarjen e ngarkesës në auditor për secilën lëndë në elementët përbërës si leksione, seminare dhe detyra/projekte kursi, punët laboratorike dhe praktikën lëndore;*

GVJ nga shqyrtimi i përmbajtjes së programit mësimor konstaton:

| | |
|---|---|
| | - *Mesimi zhvillohet në 15 javë kalendarike;*<br>- *Ngarkesa mësimore totale në auditor ështe 1342.5orë;*<br>- *Ngarkesa në leksione është 410 orë;*<br>- *Ngarkesa në ushtrime është 330 orë;*<br>- *Ngarkesa në detyra kursi/projekte është 1423.5 orë;*<br>- *Ngarkesa në orë laboratorike është 350 orë;*<br>*[Ref_074 Guida Program Studimi (programet e shkurtuara) MP Elektroenergjetikë DSEF; Ref_017 Tabelat 1-24 Të dhënat tabelore për Departamentin e Sistemeve Elektrike të Fuqisë; Ref_018 Planet dhe programet mësimore].* |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. | GVJ konstaton se institucioni ndjek nje procedurë të rregullt në lidhje me vendojen e kuotave të pranimit të studentëve. Vendosja e kuotave është subjekt i diskutimeve dhe vendimit të marrë në departament dhe miratohet nga Dekanati i FIE-së. Për vitin 2022 – 2023 u vendos një rritje e numrit të kuotave bazuar në kapacitetet pritëse të institucionit dhe në kërkesën e lartë që ka për specialist në fushën e elektroenergjitikës. Konkretisht për vitin 2022-2023 numri maksimal i kuotave të pranimit është 40, ku 35 janë për studentët brenda vendit, 2 për studentë që aplikojnë për diplomë të dytë, 1 studentë nga trojet (Kosovë, Mal i Zi, Preshevë, Bujanovc, Medvegjë) dhe 2 studentë nga kategoritë e veçanta *[Ref_063 Kuotat e pranimit 2022-2023 DSEF; Ref_064 Raportet për kapacitetet pritëse në UPT]*<br>GVJ konstaton se të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve jepen në Rregulloren e programit të studimit Master Profesional "Elektroenergjitikë". Kreu III "Pranimi i studentëve dhe afatet e studimit" përcaktojnë në nenet 10, 11 kriteret e pranimit dhe të regjistrimit të studentëve. Në këtë program studimi lejohen te ndjekin studimet studentët që zotërojnë një diplome të nivelit të parë Bachelor në Inxhinieri Elektrike të FIE-së pa kredite debi. Për studentët të cilët vijnë nga universitetet të tjera IAL kandidatët duhet të jenë të diplomuar në fushën e Inxhinierisë Elektrike në programe të lilençuara dhe të akredituara. Studentët që vijnë nga IAL të tjera dhe zotërojnë diplomë të ciklit të parë i nënshtrohet edhe një ekuivalentimi. Raste të tilla u paraqitën për studente nga Universiteti i Vlorës të cilët kanë marrë lëndë shtesë |

<table>
<tr>
<td></td>
<td>për të plotësuar njohuritë ndërsa në lidhje me studentët e diasporës (kryesisht nga Kosova) nuk është konsideruar marrja e lëndëve shtesë [takim me stafin akademik, takim me studentët]. Neni 13 në rregulloren e programit të studimit përcakton qartë edhe transferimet. UPT u mundëson transferimin e studentëve në vite të ndërmjetëm, brenda programit të ciklit të dytë dhe të cilat janë programe të njëjta ose të përafërta si brenda UPT-së ashtu edhe në IAL të tjera [Ref_074 Guida Program Studimi (programet e shkurtuara) MP Elektroenergjetikë DSEF].
<table>
<tr><th>Sipas viteve akademike</th><th>Të regjistruar për herë të parë</th><th>Të transferuar</th><th>Të larguar</th><th>Ndërprerë studimet</th><th>Totali</th></tr>
<tr><td>2020-2021</td><td>40</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>40</td></tr>
<tr><td>2021-2022</td><td>32</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>32</td></tr>
<tr><td>2022-2023</td><td>24</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>24</td></tr>
<tr><td>Total</td><td colspan="5">96</td></tr>
</table>
[Ref_017 Tabelat 1-24 Të dhënat tabelore për Departamentin e Sistemeve Elektrike të Fuqisë]</td>
</tr>
<tr>
<td>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</td>
<td>Programi i studimit Master Profesional në "Elektroenergjitikë", është hartuar në përputhje me kërkesat ligjore të MASR. GVJ u njoh me përmbajtjen e tij dhe shumë diskutime u elaboruan gjatë takimeve me përgjegjës të njësisë bazë dhe stafin akademik. Programi i studimit jep një informacion të qartë në lidhje me lëndët, ngarkesën në leksione, orë ushtrime, detyrë kursi/projekte, praktikën lëndore, praktikën profesionale dhe përgatitjen e tezës së diplomës. Ngarkesa në auditor është në përshtatje edhe me lëndët dhe evidentojmë një harmonizim të orëve të leksioneve me orët praktike dhe detyrat e kursit. Informacion më i detajuar pasqyrohet në syllabuse. GVJ u njoh me përmbajtjen e tyre dhe konstaton se ato janë të ndërtuar në përputhje me standartet ligjore në fuqi. Konkretisht kontatojmë elementët bazë:<br><br>
a. Emërtimi i lëndës;<br>
b. Titullari/ pedagogu i lëndës;<br>
c. Ngarkesa ne ore/kredite;<br>
d. Tipologjia e lendes;<br>
e. Viti akademik/semetri kur zhvillohet;<br>
f. Lloji i lëndës;<br>
g. Programi i studimit;</td>
</tr>
</table>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
E-mail: info@ascal.al
Web site: www.ascal.al

| | |
|---|---|
| | h. *Kodi i lëndës;*<br>i. *Adresa elektronike e titullarit;*<br>j. *Kodi i Etikës;*<br>k. *Përmbledhje dhe Rezultatet e të nxënit;*<br>l. *Konceptet themelore;*<br>m. *Temat e lëndës;*<br>• *Leksione ;*<br>• *Seminare;*<br>• *Laboratore ;*<br>n. *Literatura;*<br>o. *Frekuentimi*<br>p. *Kontrolli i vazhdueshëm;*<br>q. *Vërejtje përfundimtare nga pedagogu i lëndës;*<br><br>Në çdo syllabus janë dhënë qartë tematika e orëve të leksionit, tematika e orëve të seminarit, të laboratoreve e shoqëruar secila me literaturën përkatese. Studenti njihet që në fillim të lëndës me përmbajtjen e syllabusit dhe merr njohuri të qarta në lidhje me çështjet kryesore që do te trajtohen nga ana e stafit akademik.<br><br>*[Ref_017 Tabelat 1-24 Të dhënat tabelore për Departamentin e Sistemeve Elektrike të Fuqisë; Ref_018 Planet dhe programet mësimore]* |
| **Kriteri 5.** Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht. | Programi i studimit master profesional në "Elektroenergjitikë" është riorganizuar duke rritur numrin e krediteve (nga 60 ECTS në 120 ECTS) dhe numri i viteve akademike të studimit përkatësisht nga 1 në 2 vjet. Riorganizimi i tij erdhi si pasojë e kërkesave të tregut të punës, kërkesave që kompanitë në bashkëpunim paraqiten në sondazhet e bëra nga institucioni në lidhje me vlerësimin e programit të studimit dhe nga vetë studentët. Plani mësimor jep një panoramë të qartë të riorganizimit të lëndëve duke rregulluar ngarkesat dhe në shtimin e disa lëndëve të reja të cilat vetë tregu i punës i kërkon.<br><br>*[Ref_017 Tabelat 1-24 Të dhënat tabelore për Departamentin e Sistemeve Elektrike të Fuqisë; Ref_018 Planet dhe programet mësimore]*.<br><br>Procedura e riorganizimit të programit të studimit Master Profesional në "Elektroenergjitikë" është mbështetur në nenin 15 të "Rregullores së Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies" të UPT-së. Në kuadër të projektit Erasmus+ Engine *(Project reference No. 619338-EPP-1-2020-1-AL-EPPKA2-CBHE-JP)* janë identifikuar edhe nevojat për përmirësim të cilat tashmë janë |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | reflektuar në planin e ri mësimor. UPT përcakton qartë në dokumentat e saj ligjore edhe rrugët për përmirësimin e vazhdueshëm të programit mësimor. GVJ zhvilloi takime të veçanta me përfaqësues të Drejtorisë së Kurrikulave ku u theksua puna e tyre në lidhje me procedurat e përmirësimit të programeve mësimore kur ato nuk tejkalojnë masën 20% si e drejtë e njësisë bazë dhe stafit akademik.<br>*[takim me përfaqësues të Drejtorisë së Kurrikulave]* | | | |
| **Konkluzione** | *GVJ konkludon se:*<br>• *Programi i studimit Master Profesional në "Elektroenergjitikë", është hartuar në përputhje me kërkesat ligjore të MASR;*<br>• *Plani mësimor i programi të studimit përmban të gjithë elementët e kërkuar edhe nga standartet ligjore në fuqi;*<br>• *Ndarja e lëndëvë është sipas kategorive formuese;*<br>• *Ngarkesa mësimore është e shpërndarë në teori dhe praktikë duke i vënë theksin kësaj të fundit;*<br>• *Syllabuset e lëndëve janë të ndërtuar sipas standarteve ligjore dhe japin tematikat për orët e leksioneve, ushtrimeve, punët laboratorike dhe vlerësimet përkatese për secilën prej tyre.*<br>• *DSEF zbaton procedura të qarta në lidhje me përmirësimin e programi të studimit dhe institucioni ka ngritur struktura të cilat monitorojnë dhe kotrollojnë këtë proces.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushe t kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi II.4**<br>**Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Emërtimi, | Programi i studimit Master Profesional në "Elektroenergjitikë" |

<table>
<tr>
<td>përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</td>
<td>është një program i konceptuar që të kombinojë pjesën teorike me atë praktike. Nga shqyrtimi i DVV dhe takimet në institucion, GVJ është i mendimit se përmbajtja e veprimtarive dhe shpërndarja e lëndëve dhe praktikës profesionale mundësojnë, njohuri, aftësi dhe kompetenca të cilat garantojnë formimin e nevojshëm për punësim të studentëve.<br><br>[Ref_018 Planet dhe programet mësimore; Ref_017 Tabelat 1-24 Të dhënat tabelore për Departamentin e Sistemeve Elektrike të Fuqisë;]</td>
</tr>
<tr>
<td>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</td>
<td>GVJ konstaton se programi i studimit synon në aftësimin praktik të studentëve në fushën e elektroenergjitikës. Programi jep një balancim të drejtë të kuadrit teorik me atë praktik.<br><br>
<table>
<tr><th>Sem</th><th>Leksione</th><th>Ushtrime</th><th>Detyra/ projekte</th><th>Laboratorë</th><th>Praktika lëndore mësimore</th></tr>
<tr><td>I</td><td>145</td><td>102</td><td>17.5</td><td>40</td><td>30</td></tr>
<tr><td>II</td><td>145</td><td>114</td><td>17.5</td><td>30</td><td>20</td></tr>
<tr><td>III</td><td>130</td><td>96</td><td>15</td><td>50</td><td>70</td></tr>
<tr><td>IV</td><td>-</td><td>-</td><td>90</td><td>-</td><td>240</td></tr>
<tr><td>Total</td><td>420</td><td>312</td><td>140</td><td>120</td><td>360</td></tr>
<tr><td></td><td>Leksion e</td><td colspan="4">Orë Praktike</td></tr>
<tr><td>Total</td><td>420</td><td colspan="4">932</td></tr>
<tr><td>%</td><td>31 %</td><td colspan="4">69 %</td></tr>
</table>
<br>Siç vihet re edhe nga tabela evidentojmë më shumë orë në aspektin praktik në semestrin e II dhe të III dhe në semestrin e IV studenti zhvillon tezën e diplomës dhe praktikën profesionale me një total në 330 orë. Programi mësimor jep edhe një panoramë të ngarkesës së studentit për çdo lëndë në orë ushtrime dhe orë praktike. Kryesisht mbizotëron 2 L dhe 2P [Ref_018 Planet dhe programet mësimore].</td>
</tr>
<tr>
<td></td>
<td>GVJ konstaton se përmbajtja e programi është në shërbim të plotësimit të objektivave te tij. Konkretisht në rregulloren e programit te studimit theksohet marrja e njohurive në aspektet metodologjike dhe aplikative dhe në përfundim të studimeve të</td>
</tr>
</table>

| | |
|---|---|
| | jenë të aftë të përdorin këto njohuri për të interpretuar probleme të ndryshme në praktikë *[Ref_074 Guida Program Studimi (programet e shkurtuara) MP Elektroenergjetikë DSEF]*.<br><br>GVJ konstaton zhvillimin e praktikës lëndore si një mundësi e shfrytëzuar nga njësia bazë për të konkretizuar kurrikulën mësimore me situata reale në praktikë. Shembuj të shumtë u sollen nga stafi akademik dhe studentët në këtë drejtim *[Ref_074 Guida Program Studimi (programet e shkurtuara) MP Elektroenergjetikë DSEF; Ref_017 Tabelat 1-24 Të dhënat tabelore për Departamentin e Sistemeve Elektrike të Fuqisë; Ref_018 Planet dhe programet mësimore; takime në institucion.]*<br><br>GVJ konstaton se programi i rishikuar ofron një shpërndarje të drejtë të ngarkesës në 2 vite akademik dhe në semestra. Vendosja e lëndëve në perputhje me karakterin formues siguron përmbushjen e objektivave të programit. Në kategorinë "C" studenti ka mundësi të marre edhe 3 lëndë me zgjedhje si:<br><br>a. *Programet kompjuterike të komunikimit në rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike;*<br>b. *Plotësime në elektroniken industriale të fuqisë;*<br>c. *Menaxhimi i energjisë elektrike në rrjetat smart;*<br>d. *Projektimi i rrjetave elektrike TL;*<br>e. *Cilësia e energjisë elektrike;*<br>f. *Software për menaxhimin dhe analizën SE;*<br><br>Lëndët me zgjedhje i japin mundësi studentit të marrë njohuri më të avancuara në drejtime të caktuara. Nese studenti merr si lëndë detyruese "Projektimi i rrjetave elektrike shpërndarëse" atëhere mund të marrë njohuri të avancuara në "Projektimin e rrjetave elektrike TL" duke e aftësuar në fushën e projektimeve. Vendosja e lëndës detyruese "Rregullimi automatic në SE" shkon në përputhje me lëndët me zgjedhje "Programet kompjuterike të komunikimit në rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike" dhe "Software për menaxhimin dhe analizën SE" duke e aftësuar edhe me njohuri të avancuara kompjuterike. Në të njëjtën linjë konstatojmë edhe për marrjen e njohurive në eficiencën e energjisë dhe rrjetat smart e cila është lëndë detyruese në planin mësimor dhe lëndet me zgjedhje në këte drejtim si "Menaxhimi i energjisë elektrike në rrjetat smart". GVJ konstaton se përmes një kombinimi të marrjes së njohurive në lëndët detyruese dhe përftimin e njohurive të avancuara përmes lëndëve me zgjedhje, krijojnë mundësinë që student të aftësohet në drejtime të caktuara |

| | |
|---|---|
| | dhe më kryesorja në rritjen e potencialit të tij për analizim dhe projektim.<br><br>*[Ref_018 Planet dhe programet mësimore]* |
| **Kriteri 3.** Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit "Master Profesional", ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional. | Programi i studimit Master Profesional në "Elektroenergjitikë" është ristruktuar bazuar në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe mesimdhenies te UPT-se, neni 10 *[Ref_037 Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies e UPT]*. Në rishikimin e programit të studimit njësia bazë është fokusuar në vendosjen e lëndëve të cilat do të mundësojnë studentët të aftësohen në praktikë, të marrin më shumë njohuri në fushën e inxhinierise elektrike/ elektronergjitike dhe në fushën e energjisë së rinovueshme. Rishikimi i tij ka ardhur edhe si kërkesë nga projektet e bashkëpunimit kombëtar, rajonal dhe europiane dhe si kërkesë e tregut të punës. Përmes riorganizimit të tij, studentit i forcohen kompetencat profesionale për problemet e prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, projektimit të rrjetave elektrike të shpërndarjes, projektimit të furnizimit me energji elektrike të ndërmarrjeve industrial e civile dhe të sektorit elektrik në tërësi. Programi është unik në Republikën e Shqiperisë. Për përmirësimin e përmbajtjes së tij, stafi akademik i njësisë bazë është bazuar në modelet më të mira të Universitetit Politeknik të Milanos dhe të Barit. Në RVB është shprehur se raporti teorik me praktikë është 45:55 ndërsa nga llogaritjet duke përfshirë edhe punimit e tezës së diplomës në aspektin praktik konkludojmë se në raport prevalon praktika.<br><br>*[Ref_037 Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies e UPT; Ref_034 Broshura ENGINE; Ref_018 Planet dhe programet mësimore; takime në institucion; Ref_088 Praktikë miratimi për program të riorganizmi studimi-DSEF]* |
| **Kriteri 4.** Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. | Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis pjesës teorike dhe praktikës mundësojnë arritjen e objektivave formues të përcaktuar në këtë program studimi. Gjithashtu vlerësimi me kredite ECTS lejon transferimin e studimeve, mobilitetin dhe punësimin e studentëve në përfundim të programit të studimit Mastër Profesional në "Elektroenergjitikë".<br><br>*[Ref_018 Planet dhe programet mësimore;* |
| **Kriteri 5.** Syllabuset | Nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve të këtij programi studimi |

| | |
|---|---|
| (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit. | GVJ konstatoi se ato janë të përditësuara me literaturë bashkëkohore. Në rastin e programit të studimit në fushën e inxhinierisë elektrike, kjo vjen edhe si domosdoshmëri për arsye të zhvillimeve të shpejta në këtë fushë. Syllabuset japin qartë tematikat në orë leksione, orë ushtrime dhe orë laboratorike duke i dhënë një informacion të detajuar studentit që në fillim të lëndës për përmbajtjen e saj, detyrimet dhe mënyrën e vlerësimit të tij në përfundim të saj *[Ref_017 Tabelat 1-24 Të dhënat tabelore për Departamentin e Sistemeve Elektrike të Fuqisë.-syllabuset faqja 4-81]*.<br><br>Në syllabus janë dhënë qartë edhe tematika e praktikave lëndore ku jepen edhe vizitat që studentit do të kryejë në disa lëndë të caktuara të kurrikulës mësimore. Literatura e dhënë është e detyrueshme dhe e rekomandueshme është e 10 viteve të fundit. Praktika mësimore është reflektuar në një syllabus të veçantë dhe pedagogët e lëndës janë stafi akademik (PAE) i njësisë bazë. Në këtë syllabus synohet që studenti të orientohet në mënyren e duhur në tregun e punës, në kompanitë private, institucionet shtetërore dhe në organizata aktiviteti i të cilave lidhet drejtpërdrejt ose mbështetet në fushën e inxhinierisë elektrike *[Ref_017 Tabelat 1-24 Të dhënat tabelore për Departamentin e Sistemeve Elektrike të Fuqisë.-syllabuset faqja 76-79]*.<br><br>Punimi i diplomës është paraqitur me një syllabus të veçantë. Permes saj synohet që studenti të tregojë aftësinë për të sintetizuar njohuritë praktike dhe teorike të përfituara gjatë viteve të studimit dhe të jetë i aftë ti aplikojë këto njohuri në një situatë praktike përmes të punuarit në mënyrë të panvarur [*[Ref_017 Tabelat 1-24 Të dhënat tabelore për Departamentin e Sistemeve Elektrike të Fuqisë.-syllabuset 80-81]* |
| **Kriteri 6.** Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara. | Programi i studimit Master Profesional në "Eektroenergjitike", në tërësinë e tij i vlerësuar në përmbajtje nga GVJ, garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara dhe është në përputhje me nivelin 7 të KSHK-së.<br><br>*[Ref_018 Planet dhe programet mësimore]* |
| **Kriteri 7.** Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e | Përmbajtja e programit të studimit promovon mundësi të mëtejshme të studimit dhe / ose punësimin e studentëve në përputhje me pritjet dhe kërkesat e tregut të punës. Ky program studimi nuk mundëson thellimin e njohurive në fushën e doktoraturës por garaton një punësim të studentëve në përfundim |

| | |
|---|---|
| studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. | të studimeve të tyre. Të dhënat më poshtë tregojnë një punësim të lartë sipas fushës së studimit.<br>*[Ref_017 Tabelat 1-24 Të dhënat tabelore për Departamentin e Sistemeve Elektrike të Fuqisë.]* |

| (2020-2023) | | | |
|---|---|---|---|
| Programi i studimit | Numri i studentëve të diplomuar | Numri i të punësuarve (sipas fushës së studimit) | Numri i të punësuarve (jo sipas fushës së studimit) |
| MP "Elektro-energjitike" | **111** | **85** | **15** |

| | |
|---|---|
| **Konkluzione** | *GVJ konkludon se programi i studimit përmbush objektivat e tij. Ky program aftëson studentit në fushën teorike dhe praktike. Lëndët janë organizuar duke i dhënë mundësi studentit të profilizojë njohuritë e tij përmes selektimit të lëndëve me zgjedhje. Programi garanton një punesim të studentëve sipas fushës së studimit në përfundim të studimeve.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi II.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet | Programi i studimit Master Profesional në "Elektroenergjitikë" është rishikuar duke bërë edhe përmirësime të dukshme. Konkretisht është bërë kalimi nga një program me 60 ECTS që zhvillohej në një 1 vit studimi në një program të riorganizuar me 120 ECTS dhe me periudhë të studimit 2 – vjet. Për rishikimin e tij GVJ u njoh edhe me dokumentacionin e paraqitur nga institucioni dhe shumë pyetje u zhvilluan në takime. Në kuadër të projektit ENGIN, (Project No. 619338-EPP-1-2020-1-AL-EPPKA2-BCHE-JP) mbështetur nga programi ERASMUS+ |

| | |
|---|---|
| e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës. | Programe EU i cili në implementimin e tij kishte në fokus zhvillimin dhe përmirësimin e kurrikulës mësimore u ndërrmor edhe iniciativa për riorganizimin e programit të studimit. Në kuadër të punës nga ana e njësisë bazë u ndërmorr një studim tregu dhe survey me grupet e interesit ku në qendër të studimit dhe të plotësimit të pyestorit ishin: menaxhere në kompani private, profesionistë, shoqata profesionale, institucione shteteore, bashki, kompani të sektorit të energjisë etj. Siç evidentohet edhe nga të dhënat e studimit ndonëse përqindja e studentëve të punësuar në përputhje me fushën e studimit është e lartë, të dhënat e mbledhura me specifike treguan një nevojë dhe domosdoshmëri të përmirësimit të kurrikulës në përmbajtjen e saj dhe kryesisht në ndërthurjen e teorisë dhe praktikës duke i dhënë përparësi më shumë kësaj të fundit.<br><br>Zhvillimet teknologjike kane sjellë edhe kërkesën për specialistë në fusha specifike dhe konkretisht përmirësimi i kurrikulës në Master Profesional në "Elektroenergjitikë" do të sjellë përgatitjen e një brezi studentësh të aftë edhe në fusha si energji e rinovueshme, menaxhimi i eficiencës së energjise etj. Në këtë drejtim shumë lëndë jane shtuar duke i dhënë mundësi studentëve të marrin njohuri dhe të aftësohen në praktikë. "Gjenerimi i shpërndarë dhe mikrogrid", "Mbrojtja rele në SE", "Eficienca e energjisë në rrjetet smart" janë disa lëndë të detyrueshme të vendosur në programin mësimor për të mundësuar studentët të zgjerojnë njohuritë e tyre edhe në këto drejtime specifike. Përmirësimi i kurrikulës është shoqëruar edhe me përmirësimin e bazës laboratorike e cila do të mbështesë përgatitjen e studentëve në anën praktike. Praktika lëndore është vendosur në ngarkesën mësimore duke i dhënë mundësi studentëve të vizitojnë ndërmarrje dhe të shohin konkretisht zbatimin e teorisë në praktike me raste studime reale, me problematikat dhe rrugët e zgjidhjes.<br><br>*[Ref_030 Vlerësim kërkimor mbi programet e studimit në lidhje me projektin Engine; Ref_033 Raporti final (Analiza e tregut të punës); Ref_034 Broshura ENGINE , Gusht 2022; Ref_029 Rezultatet e Pyetësorit UPT]* |
| **Kriteri 2.** Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe | UPT ndjek në mënyrë të vazhdueshme studentët dhe përthith mendimin e tyre. GVJ konstaton se studentët janë gjithmonë pjesëmarrës në dhënien e mendimit të tyre përmes anketimeve që zhvillohen në fund të çdo semestri ku ata japin edhe opinionet në |

| | |
|---|---|
| konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit. | lidhje me procesin mësimor, infrastrukturën dhe cilësinë e mësimdhënies nga ana e stafit akademik. *[Ref_032 Anketimi Studentor; Ref_071 Pyetësori dhe databaza Alumni]*. Njësia bazë mban kontakte me kompanitë dhe institucionet duke konsideruar rekomandimet e tyre. GVJ u njoh me praktikën e një studimi më të thelluar ku 89 intervistues të grupeve të ndryshme të interesit shprehën mendimin e tyre në lidhje me përmirësimin e kurrikulës *[Ref_029 Rezultatet e Pyetësorit UPT; Ref_030 Vlerësim kërkimor mbi programet e studimit në lidhje me projektin Engine;]*. Në takimin e zhvilluar me grupin e vleresimit të brendshëm u theksua se kjo iniciative paraqiti më të detajuar nevojën dhe domosdoshmërinë e përmirësimit të përmbajtjes së programit mësimor, ndërsa vëzhgimet dhe pyetsorët e dhëne nga NJSBC dhe Zyra e Karrierës dhe Alumni janë më të përgjithshme dhe nuk prekin në thellësi problematikën që mund të ketë në përmbajtje programi mësimor. GVJ konstaton se studimi i ndërmarrë në kuadër të projektit ENGIN është shembulli më i mirë që tregon nevojën për përmirësime dhe drejtimet ku duhet të bëhen ndërhyrjet në mënyrë që përmbajtja e tij ti përgjigjet kërkesa të tregut të punës. |
| **Kriteri 3.** Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private. | Njësia bazë në bashkëpunim me stafin akademik përthith mendimin e kompanive dhe institucioneve me te cilat ka marrëveshje bashkëpunimi në drejtim të përmirësimit të programit të studimit. Siç theksohet edhe në kriterin 2 të ketij standarti përmirësimi i programit mbi 20% ka ardhur si kërkesë e propozimeve të dhëna nga grupet e interesit. Programi është riorganizuar në drejtim të kohëzgjatjes së studimit (2 vjet) në shtimin e numrit të krediteve (120 ECTS). Përmirësime janë bërë në përmbajtjen e çdo lëndë dhe janë shtuar katër lëndë të reja. Rritja e numrit te krediteve dhe kohëzgjatjes së periudhës së studimit ka dhënë mundësi edhe rregulimit të ngarkesës në orë teorike dhe praktike duke përmirësuar këtë raport në funksion të të kësaj të fundit.<br><br>*[Ref_030 Vlerësim kërkimor mbi programet e studimit në lidhje me projektin Engine; Ref_033 Raporti final (Analiza e tregut të punës); Ref_034 Broshura ENGINE, Gusht 2022; Ref_029 Rezultatet e Pyetësorit UPT]* |
| **Konkluzione** | *Programi i studimit Master Profesional në "Elektroenergjitikë" është rishikuar duke bërë edhe përmirësime të dukshme. Konkretisht është bërë kalimi nga një program me 60 ECTS që* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *zhvillohej në një 1 vit studimi në një program të riorganizuar me 120 ECTS dhe me periudhë të studimit 2 – vjet. Në riorganizimin e tij kontribut kanë dhënë të gjithe grupet e interesit duke shprehur qartas mendimin e tyre. Programi i rishikuar ofron mundësi studentëvë të marrin më shumë njohuri teorike dhe praktike. Baza labratorike në kuader të projektit është përmirësuar dhe praktika lëndore është shtuar. Për sa më sipër GVJ konkludon së riorganizimi e programit mbi 20% sjell një përmirësim të dukshëm në drejtim të rritjes se kompetencave profesionale të studentëve.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

| **Standardi II.6**<br>**Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit. | Programi i studimit Master Profesional në "Elektroenergjitikë" zhvillohet në Departamentin e Sistemeve Elektrike të Fuqisë në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike. Programi i studimit shpreh qartë objektivat dhe synimet e tij në Rregulloren e programit të Studimit. GVJ konstaton së këto objektiva janë në linjë me prioritet strategjikë të shprehun në Planin Strategjik të Zhvillimit të FIE-së dhe të UPT-së. Në takimin e zhvilluar me Dekanin e FIE-së dhe Shefin e DSEF u theksua që përmirësimi i programit të studimit ka synimin në përmbushen e objektivave kryesore të studimit dhe prioriteteve strategjike të UPT-së.<br>*[Ref_010 Plani Strategjik 2019-2024 i UPT; Ref_011 Plani Strategjik 2019-2024 i FIE; Ref_012 Plani Strategjik 2019-2024 i DSEF_FIE; Ref_074 Guida Program Studimi (programet e shkurtuara) MP Elektroenergjetikë DSEF].* |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, | GVJ u njoh me dokumenta institucinale të paraqitur nga institucioni. Njësia bazë bashkërendon punën bazuar edhe në kornizen ligjore të përcaktuar në rregulloret bazë:<br>• *Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT;* |

| | |
|---|---|
| duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit. | • *Rregullore e Njësisë Kryesore -FIE*<br>• *Rregullore e njësisë bazë –DSEF;*<br>• *Rregulore e programit të studimit;*<br>*[Ref_037 Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies e UPT; Ref_008 Rregullore Njësi Kryesore FIE; Ref_009 Rregullore Njësi Bazë DSEF_FIE; Ref_074 Guida Program Studimi (programet e shkurtuara) MP Elektroenergjetikë DSEF;]*<br>Njësia bazë ndërmerr iniciativa në përmirësimin e vazhdueshëm të kurrikulës mësimore përmes diskutimeve me stafin akademik dhe e përfshin këtë të fundit të shprehë hapur dhe lirshëm mendimin e tij duke ruajtur parimin e moscënimit të lirisë akademike. Në takimet e zhvilluar në institucion u njohëm me mendimin e stafit akademik dhe punën e njësisë bazë në bashkrendimin e aktiviteteve, në monitorimin e procesit mësimor, në drejtim të përmirësimit të kushteve laboratorike. Njësia bazë harton edhe raporte vjetore të cilat i bashkëngjiten raportit vjetor të FIE.<br>*[Ref_008 Rregullore Njësi Kryesore FIE; Ref_009 Rregullore Njësi Bazë;takime nw institucion; Ref_013 Raport i aktivitetit mësimor në nivel njësi kryesore FIE; Ref_014 Raport i aktivitetit mësimor në nivel njësi bazë DSEF-FIE]* . |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore. | GV konstaton punën e zhvilluar nga stafi akademik në drejtim të përfshirjes së studentëve në punën shkencore. Konkretisht diskutime u zhvilluan në takimet në institucion në lidhje me ndërfutjen e studentëve të programit MP në projektime. Nga ana e stafit akademik u shpjeguae se kërkesa e madhe e tregut të punës për specialistë bën që edhe studentët e programit MP "Elektroenergjitikë" të aftësohen në projektime dhe treguan shembuj të punimeve zhvilluar nga ana e studentëve në këtë drejtim. *[takim me stafin akademik]*<br>Përgatitja e tezës së diplomës në një rast studimor konkret konsiderohet si një punim i mirëfilltë shkencor. Teza e diplomës është vlerësuar me 18 ECTS dhe i jep mundësi studentit në bashkepunim me udhëheqësin e tij të analizojë një rast konkret dhe të japë rekomandime të vlefshme.<br>Përmirësimi i kushteve laboratorike edhe me përfshirjen në projektin ENGIN i krijon kushte studentëve të kryejnë matje dhe të analizojne me teknikisht rastet studimore. Në vizitën në |

| | |
|---|---|
| | institucion GVJ u njoh edhe me makete të ndryshme (në fushën e energjisë së rinovueshme) të zhvilluara nga studentët dhe demonstrime nga ana e tyre u panë në vizitë. Stafi akademik inkurajon studentët të jenë pjesë e punimeve të kryera nga ana e tyre. Në tre vitet e fundit janë aktivizuar 10 studentë nga punimet shkencore individuale të 5 pedagogëve.<br><br>*[Ref_017 Tabelat 1-24 Të dhënat tabelore për Departamentin e Sistemeve Elektrike të Fuqisë]* |
| **Kriteri 4.** Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme. | UPT mbështet stafin akademik të marrë pjesë në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare. Nga të dhënat e paraqitura nga institucioni në tre vitet e fundit konstatojmë:<br>• *5 botime të nga personelit akademik efektiv të njësisë bazë DSEF;*<br>• *5 projekte kerkimore shkencore të fituara në shkallë departamenti/ fakulteti;*<br>• *2 projekte të zbatuara në shkallë departamenti/ fakulteti;*<br>• *3 aktivitete shkencore të organizuar nga departamenti për programin e studimit*<br>• *45 pjesëmarres në konferenca shkencore;*<br><br>*[Ref_017 Tabelat 1-24 Të dhënat tabelore për Departamentin e Sistemeve Elektrike të Fuqisë.]*<br><br>UPT mbështet dhe inkurajon stafin akademik të marrë pjesë në konferenca dhe trajnime. Investime financiare në këtë drejtim janë evidente përmes dokumetacionit dhe takimeve në institucion *[Ref_027 Evidencë mbi trajnimet e personelit në FIE-DSEF; Ref_045 Mbeshtetja financiare per pjesemarrje ne konferenca shkencore]* |
| **Konkluzione** | *Programi i studimit MP në "Elektroenergjitikë" mbështet prioritetet e kërkimit shkencor të DSEF-së dhe FIE-së. Institucioni inkurajon dhe mbështet stafin akademik të marrë pjesë në konferenca dhe projekte kërkimore. Stafi akademik bën pjesë të punimeve individuale të tij edhe studentët.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi II.7**<br><br>**Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor. | DSEF përbëhët nga dy grupe mësimore kërkimore përkatësisht:<br>1. Grupi mësimor- kërkimor i Analizes dhe Monitorimit në Sistemet Elektrike;<br>2. Grupi mësimor – kërkimor i Burimeve dhe Impianteve Elektrike;<br><br>Programi MP "Elektroenergjitikë" mbështet plotësisht nga stafi akademik i DSEF-së dhe stafi PAK. Njësia bazë në kuadër të projekteve kërkimore shkencore bashkëpunon me universitete homologe brenda dhe jashtë vendit. Njësia bazë i jep një rëndësi të veçantë përshirjes në projekte kërkimore dh shkencore. Permes angazhimeve në projekte janë bërë përmirësime të dukshme në përmbajtjen e programit mësimor, përmirësimit të infrastrukturës dhe formave të mësimdhënies.<br><br>*[Ref_048 Projekte kombetare dhe institucionale. Ref_065 Investime në pajisje laboratorike FIE] [Ref_003 Organigrama e FIE _ DSEF]* |
| **Kriteri 2.** Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave. | GVJ konstaton se specifika që ka Departamenti i Sistemeve Elektrike të Fuqisë në FIE mundëson stafin akademik të jetë pjesë e konsutimeve dhe oponencave teknike. Bashkëpunime të vlefshme janë bërë me kompani si KESH, OST, ERE etj të cilat përthithin mendimin e stafit akademik dhe këta të fundit japin edhe vlerësime tekniko – ligjore. DSEF ofron shërbim ndaj palëve të treta. GVJ konstaton shërbime dhe ekspertiza të shumta të kryera në oponenca teknike dhe akt – ekspertiza të projekteve të zbatimit.<br><br>*[Ref_052 Ekspertize per kompanite e sistemit elektroenergjetik;]*<br><br>*[Ref_081 Shërbimet e kryera për të tretë; Ref_079 Lista e shërbimeve të ofruara për të tretë]* |
| **Kriteri 3.** Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin | Departamenti i Sistemeve Elektrike të Fuqisë si pjesë e FIE-së është partnere në organizimin e konferencave që ndërmerren nga njësia kryesore në nivel kombëtar dhe ndërkombetar. Lektore të ftuar janë pjesë e aktiviteteve, workshop-e në kuadër të projekteve dhe zhvillohen në mënyrë të vazhdueshme përgjatë |

| | |
|---|---|
| dhe studentët për arritjen e objektivave. | gjithë vitit akademik.<br>*[Ref_035 Ëorkshopet e organizuar nga DSEF; Ref_041 Konferenca REST 2022; Ref_022 Personel Akademik i huaj i ftuar].* |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës. | Studimi i ndërmarrë nga njësia bazë në kuadër të projektit ENGIN tregoi një punësim të lartë të studentëve në përfundim të studimeve të tyre dhe në përputhje me fushën e studimit. Nga takimi i zhvilluar me studentët konstatuam se një pjesë e tyre ishin të punësuar duke bërë pak sakrifica në lidhje me frekuentimin. Shumica e tyre mendonin të vazhdonin të punonin brenda vendit në përfundim të studimeve ndonëse diploma kishte ekuivalentim në vende si Gjermani etj.<br>*[takim me studentët; Ref_017 Tabelat 1-24 Të dhënat tabelore për Departamentin e Sistemeve Elektrike të Fuqisë].*<br>Programi i studimit ofron mundësi punësimi në sektore të ndryshëm:<br>• *Në ndërmarrjet e prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike (OST, KESH, OSSHE_ etj.*<br>• *Në studio e projektimit të elementeve të sistemeve eletroenergjitike, burimet konvecionale dhe të rinovueshme, rrjetat elektrike të shpënrdarjes dhe transmetimit;*<br>• *Në studio dhe kompani projektimt të impianteve elektrike, të godinave civile dhe industrial;*<br>• *Në kompanitë e menaxhimit të energjisë;*<br>• *Në laboratorët e provave, kalibrimit dhe certifikimit për pajtueshmëri me normat evropiane të impianteve elektrike;*<br>• *Në kompani të ndrushme në rolin e energjitikut;*<br>• *Në institucione qëndrore dhe locale në fushën e elektroenergjitikës;* |
| | • *Në mësimdhënie në shkolla profesionale;* |
| **Kriteri 5.** Njësia përgjegjëse merr parasysh | Njësia bazë (DSEF) bashkëpunon me Urdhërin e Inxhinierëve dhe konsideron edhe udhëzimet e dhëna nga ana e tyre në lidhje |

| | |
|---|---|
| dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës. | me përmirësimin e kompetencave profesionale. *[Ref_066 Komunikimi me rrjete profesionistesh]* |
| **Kriteri 6.** Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (*p.sh. Professional QualificationsDirective, 2005/36/EU*). | Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian. Njesia bazë bashkëpunon me të gjithë partnerët dhe merr në konsideratë rekomandimet e tyre. *[Ref_037Rregullorja e ZhvillimitKurrikular dhe Mësimdhënies e UPT;Ref_074 Guida Program Studimi (programet e shkurtuara) MP Elektroenergjetikë DSEF].* |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se studentët në përfudim të studimeve të tyre kanë mundësi të larta punësimi. Programi ofron fushë të gjerë të angazhimit të tyre dhe mundësi në projektime. Stafi akademik është i përfshirë në oponenca teknike, ekspertiza dhe ofron shërbim ndaj palëvë të treta. Njesia bazë bashkëpunon më Urdhërin e Inxhinierëvë dhe merr në konsideratë udhëzimet e tyre në lidhje me kompentencat profesionale.* |

| **Shkalla e përmbushjes sëstandardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

## III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

| **Standardi III.1** |
|---|

| **Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminaret, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni. | Referuar ligjit në fuqi, akteve nënligjore, Rregullores së programit të studimit si dhe planit mësimor, format e mësimdhënies janë leksionet, seminaret, ushtrimet, punet laboratorike, detyra kursi/projektet, praktika lendore dhe profesionale. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijes sanksionohen:<br>• Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT, Rregullore e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike, Rregullore e Departamentit të Sistemeve Elektrike të Fuqisë dhe rregullore e programit të studimit MP në "Elektroenergjitikë";<br>• **Syllabuset**: Në përmbajtjen e tyre çdo pedagog përshkruan edhe format e mësimdhënies që ai synon të përdorë në lëndën e tij gjatë procesit mësimor;<br>• **Udhëzues i përgatitjes së temës së diplomës-** e cila përcakton qartë përgjegjësitë dhe detyrat e studentit në lidhje me përgatitjen e temës së diplomës;<br>• **Udhëzues i zhvillimit të praktikës profesionale;**<br>Neni 25 në Rregulloren e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT përcakton format e mësimdhënies dhe kontrollit të dijeve të cilat shprehen edhe në rregulloren e programit të mësimit.<br>*[Ref_008 Rregullore Njësi Kryesore FIE; Ref_037 Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies e UPT; Ref_009 Rregullore Njësi Bazë DSEF_FIE; Ref_074 Guida Program Studimi (programet e shkurtuara) MP Elektroenergjetikë DSEF]* |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e | DSEF i kushton një vëmendje të veçantë përmirësimit të formave të mësimdhënies. Përmirësimi i programit të studimit synon edhe në përmirësimin e formave të mësimdhënies. Konkretisht janë bërë ndryshime të theksuara në lidhje me orët teorike dhe praktike duke i kushtuar më shumë vëmendje orës praktike. *[Ref_018 Planet dhe programet mësimore]*. |

| | |
|---|---|
| mësimnxënies. | Përmirësimi i infrastrukturës laboratorike ka sjellë edhe një rritje të tematikës të orëve laboratorike duke aftësuar më shumë studentët në këtë drejtim. *[Ref_065 Investime në pajisje laboratorike FIE.;Ref_051 Laboratoret në FIE dhe Departamentet e saj]*<br><br>Një risi është edhe ndërfutja e praktikës lëndore e cila sjell edhe një konkretizim në situatë reale të rasteve studimore të trajtuara në auditor. Personeli akademik mban kontakte të vazhdueshme me studentët dhe i përgjigjet nevojave dhe kërkesave të tyre në lidhje me mësimdhënien. Në këtë mënyrë, GVJ konstatoi se personeli akademik ka qenë në vazhdimësi i disponueshëm për zhvillimin e konsultimeve për çështje specifike si dhe për t'ju përgjigjur pyetjeve e shqetësimeve individuale të studentëve në lidhje me procesin mësimor. *[takim me stafin akademik; takim me studentët]* |
| **Kriteri 3.** Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit. | GVJ konstatoi se për të mundësuar përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve, institucioni ka vepruar në disa drejtime:<br><br>- **Së pari,** në përmirësimin e infrastrukturës së mësimdhënies, duke ofruar auditorë të pajisur me teknologji bashkëkohore të mësimdhënies. Mjediset jane të reja dhe bashkëkohore;<br>- **Së dyti,** nëpërmjet modernizimit të bazës laboratorike dhe mbajtjes së saj në gatishmëri për zhvillimin e aspekteve praktike të procesit mësimor;<br>- **Së treti,** nëpërmjet krijimit të oportuniteteve për stafin akademik nëpërmjet mobiliteteve të ndryshme në institucione të arsimit të lartë jashtë vendit për të përsosur metodat e mësimdhënies;<br><br>[Ref. *Takime në institucion; Ref_028 Mobilitetet e Realizuara; Ref_096 Blerje Pajisje Laboratorike FIE; Ref_123 Infrastruktura e kërkimit shkencor në DSEF.*] |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe | Personeli akademik i përfshirë në programin mësimor Master Profesional në "Elektroenergjitikë" është me eksperiencë dhe i kualifikuar sipas profilit të lëndës që zhvillon. Konkretisht për këtë program studimi janë angazhuar: 1 Prof. Dr; 1 Prof. Asoc.; |

| | |
|---|---|
| koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.<br><br>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. | 2 Dr; 1 Dr në proces, 5 MSc si staf efektiv dhe 1 Dr; 1 Dr ne process dhe 2 Msc si staf akademik me kontratë *[Ref_017 Tabelat 1-24 Të dhënat tabelore për Departamentin e Sistemeve Elektrike të Fuqisë]*.<br><br>Stafi është i përfshirë në projekte kërkimore shkencore dhe konsulenca dhe ekspertiza teknike me institucione shteterore dhe private *[Ref_052 Ekspertize per kompanite e sistemit elektroenergjetik; Ref_048 Projekte kombetare dhe institucionale]*.<br><br>Takimi në institucion me stafin akademik tregoi angazhimin e tyre në procesin e përmirësimit të kurrikulës duke ofruar alternativat më të mira të hulumtuara nga programe të universtiteve homologe jashtë vendit. Në qendër të punës së tyre janë studentët. GVJ u njoh me raste të zhvillimit të ores mësimore e cila zhvillohej në auditore të pajisur me të gjithë mjetet e duhura për të transmetuar sa më qarte tematikën e lëndës. GVJ konstatoi edhe shume makete të bëra nga studentët në kuadër të projekteve të kursit dhe demonstrime nga ana e tyre u bënë gjatë takimeve në institucion. Personeli akademik përdor metoda interaktive. Prezantimet per lëndet me zgjedhje dhe gjuhë të huaja, detyrat e kursit dhe projekte e kursit që janë individuale ose në grup janë format me të shpeshta që përdoren nga stafi akademik në shërbim të mësimdhënies. Mbrojtja e detyrave të kursit apo projekt – kursi bëhet me presantim ku diskutimet jane të shumta dhe efektive.<br><br>*[Ref_017 Tabelat 1-24 Të dhënat tabelore për Departamentin e Sistemeve Elektrike të Fuqisë]*.<br><br>Stafi akademik zhvillon edhe një punë në lidhje me cilësinë e përgatitjes së tezës së diplomës duke trajtuar raste reale dhe konkrete dhe të cilat në fokus kanë rritjen e aftesisë së studentit në analizimin e situatës dhe ofrimin e një zgjidhje me rekomandimet përkatëse.<br><br>*[Ref_070 Procedure e Miratimit te temes se diplomest DSEF; Ref_036 Shembull diplome MP; takime në institucion]*. |
| **Kriteri 5.** Njësia përgjegjëse për ofrimin e progamit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e | DSEF ka përgjegjësi të drejtpërdrejta për garantimin e procesit mësimor. Të drejtat dhe detyrat e saj janë shprehur në dokumentat institucionale. DSEF është përgjegjëes për mbarëvajtjen dhe monitorimin e procesit mësimor përmes |

| | |
|---|---|
| mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre. | sigurimit të një mjedisi të duhur infrastrukture për punën e stafit akademik dhe studentëve.UPT ka ngritur mekanizma për monitorimin dhe vlerësimin e procesit të mësimdhënies në menyre periodike. GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga institucioni në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin e procesit mësimor nga ana e Institucionit konstaton si vijon më poshte strukturat përgjegjëse :<br>• Drejtuesi i Njësisë Bazë koordinon, kontrollon dhe menaxhon procesin mësimor. Në mënyrë periodike ai përgatit raportet vjetore të punës mësimore, kërkimit shkencor dhe zhvillimit të departamentit, mbështetur në raportet e grupeve mësimore-kërkimore; *[Ref_009 Rregullore Njësi Bazë DSEF_FIE]*.<br>• Në drejtim të sigurimit të brendshëm të cilësisë është ngritur në nivel universiteti Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, dhe në nivel FIE është ngritur Njësia e Sigurimit të Brenshem të Cilësisë; *[Ref_029 Rezultatet e Pyetësorit UPT; Ref_072 Pyetësori mbi permirsimet e programeve të studimit DSEF]*.<br>Studentët janë të përfshirë në të gjithë strukturat vendimarrëse kolegjiale të UPT-së. Në lidhje me vlerësimin e procesit mësimor ata marrin pjesë në anketime ku shprehin mendimin e tyre përmes plotësimit të pyetsorëve; *[Ref_029 Rezultatet e Pyetësorit UPT; Ref_072 Pyetësori mbi permirsimet e programeve të studimit DSEF]*. |
| **Kriteri 6.** Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.<br>Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja | UPT ka ngritur disa struktura të cilat në fokus të punës së tyre kanë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies.Bazuar në Statut të UPT-së Kreu III, neni 17 organizimi dhe menaxhimi i programeve te studimit të ciklit të parë dhe të dytë në nivel njësi bazë bëhet nga Këshilli i Programit të studimit (KPS) duke përcaktuar qartë edhe përberjen e tij. *[Ref_001 Statuti i UPT.]*. Për garantimin e procesit mësimor përgjegjës është edhe njësia bazë per kete program studimi. Detyrat dhe përgjegjësitë e saj janë shprehur në dokumetat institucionale. *[Ref_009 Rregullore Njësi Bazë DSEF_FIE]*.<br>Në garantimin e sigurimit të brendshëm të cilësisë së procesit mësimor në nivel institucional në vitin 2016 me rekomandimin e dhënë nga Bordi i Akreditimit për akreditimin e parë institucional të UPT-së është ngritur edhe Drejtoria e Sigurimit |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja. | të Brendshëm të Cilësisë e cila në vitin e fundit 2021 ka ngritur edhe Njësitë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në Fakultete pjesë e të cilës është edhe FIE. *[Ref_122 Njësia e Sigurimit të Cilësë në FIE Programi I Trasparencës UPT;takime nw institucion]* | | | |
| **Konkluzione** | *GVJ konkludon se bazuar në dokumentat institucionale (rregulloret në të tre nivelet) format e mësimdhënies janë leksionet, seminaret, ushtrimet, punet laboratorike, detyra kursi/projektet, praktika lendore dhe profesionale. Stafi merr pjesë në konferenca dhe ka eskperience ne fushën e mësimdhënies. Njësia bazë monitoron procesin mësimor. DSEF përthith edhe mendimin e studentëve në lidhje me cilësine e procesit mësimor. Mbështetje në këtë drejtim jep edhe NJSBC në nivel universiteti dhe fakulteti.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi III.2**<br>**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët. | Kriteret e vlerësimit dhe testimit të njohurive përcaktohen qartë në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies. Kreu IV dhe V japin informacion në lidhje me organizimin e programeve të studimit dhe vlerësimin e dijeve *[Ref_037 Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies e UPT]*.<br>Për kontrollin dhe vlerësimin e dijeve është hartuar dhe miratuar edhe "Procedura e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve" nga FIE. Rregullorja e programit të studimit përcakton qartë edhe format e vlerësimit të dijeve të studentit të cilat reflektohen edhe në syllabuset përkatëse për çdo lëndë. Dokumenta bazë të cilat japin informacion në lidhje me kriteret e vlerësimit dhe testimit të njohurive të studentëve jepen edhe faqjen zyrtare .www.fie.upt.al |
| **Kriteri 2.** Në fillim të çdo | GVJ konstaton se në fillim të çdo lënde stafi akademik |

| | |
|---|---|
| lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | informon studentët në lidhje me kriteret për lëndën duke theksuar edhe detyrimet e tyre dhe frekuentimet e detyrueshme në leksione, seminare dhe orë laboratorike. Takimet me stafin akademik dhe studentët theksuan njohjen e përmbajtjes së syllabusit në fillim të lëndës dhe detyrimet përkatëse të tyre. Studentët ishin të mirë-informuar në lidhje me masën e frekuentimit në leksione, seminare dhe procedurën e ankimimit në rast kundërshtimi të vlerësimit të bërë nga ana e pedagogut të lëndës *[takime nw institucion; Ref_017 Tabelat 1-24 Të dhënat tabelore për Departamentin e Sistemeve Elektrike të Fuqisë]*. |
| **Kriteri 3.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. | Testimi dhe vlerësimi i njohurive bëhet bazuar në rregulloren kurrikulare të mësimdhënies së UPT-së por edhe në varësi specifike të lëndës. Në këtë drejtim GVJ konstaton bazuar në rregulloren e UPT-së format e vlerësimit që ndërmerren në këtë program studimi janë:<br>- *Provimi me shkrim;*<br>- *Provimi me goje;*<br>- *Vlerësimi i projektit dhe forma të kombinuara;*<br>- *Vlerësimi i punëve laboratorike;*<br>*Format në kontrollin e vazhdueshëm para provimit përfundimtar janë:*<br>- *Detyra kursi;*<br>- *Projekte kursi;*<br>- *Provime të ndërmjetëm gjate semestrit;*<br>- *Punët laboratorike;*<br>Mënyra e organizimit të provimit me shkrim është në funksion të natyrës së disiplinës. Në rregulloren e programit të studimit neni 13 përcakton "*.Organizimi dhe kontrolli i dijeve realizohet në përputhje të plotë me Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT*". Në format e kontrollit të njohurive konstatojmë përcaktimet si vijon më poshtë: |

| **Format e kontrollit të njohurive** | **Programi i studimit MP në Elektroenergjitikë** |
|---|---|
| | **Pjesa në % ndaj totalit** |

| | |
|---|---|
| Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive | 10% |
| Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit) | 20% |
| Testimet gjatë vitit | 10% |
| Provimi përfundimtar | 60% |
| Në total | 100% |

| | |
|---|---|
| | GVJ shqyrtoi me vëmendje syllabuset e paraqitura nga institucioni. Në tërësi GVJ i gjen në përputhje me VKM nr.41 datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" *[Ref_017 Tabelat 1-24 Të dhënat tabelore për Departamentin e Sistemeve Elektrike të Fuqisë]* |
| **Konkluzione** | *GVJ konkludon se kriteret e vlerësimit dhe testimit të njohurive përcaktohen qartë në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies dhe zbatohen edhe për programin e studimit MP në "Elektroenergjitikë" Format bazë të vlerësimit të dijeve janë: Provimi me shkrim; Provimi me goje;Vlerësimi i projektit dhe forma të kombinuara;Vlerësimi i punëve laboratorike.*<br><br>*GVJ konstaton se syllabuset janë të hartuar qartë dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Ata japin qartë tematikën e leksioneve, seminareve/suhtrimeve dhe punëve laboratorike dhe përcaktojnë qartë detyrimet e studentit dhe vlerësimet në lidhje me lëndën.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.3**<br><br>**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë | Kriteret dhe procedurat për testimin e njohurive të studentit janë përcaktuar në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular të Mësimdhënies në UPT dhe në syllabuset e lëndëve*[Ref_017* |

| | |
|---|---|
| gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | *Tabelat 1-24 Të dhënat tabelore për Departamentin e Sistemeve Elektrike të Fuqisë; Ref_074 Guida Program Studimi (programet e shkurtuara) MP Elektroenergjetikë DSEF].* Testimi i njohurive bëhet gjatë vitit akademik që zhillohet lënda.<br><br>Provimet zhvillohen në disa sesione:<br>- Sesioni i provimeve në përfundim të semestrit të parë akademik;<br>- Sesioni i provimeve në përfundim të semestrit të dytë të vitit akademik;<br>- Sesioni i provimeve të vjeshtës të cilat zhvillohen kryesisht në Shtator;<br>- Sesione të veçanta të cilat në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi i japin të drejte studentit të përmbushë detyrimet për lëndët e prapambetura;<br><br>Format e testimit janë përcaktuar qartë ne Rregulloren e UPT-së. Format testimit përfshijnë kontrollin e pjesshëm gjatë vitit, kontrollin në orë ushtrime, në orët laboratorike në detyrat e kursit dhe provimin përfundimtar. Format e testimeve variojnë në varësi të specifikës së lëndës. Studenti informohet në fillim të semestrit për përmbajtjen e syllabusit nga pedagogu i lëndës dhe detyrimet përkatëse të tij. *[Ref. takime ne institucion]*. |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. | GVJ konstanon se FIE nuk ka nje sistem elektronik testimi dhe vlerësimi të studentëve. Siç pranohet edhe nga vetë grupi i vlerësimt të brendshëm në RVB "*.avantazhet e të cilit do të rrisnin transparencën dhe mundësonin reduktimin në maksimum të abuzimit dhe subjektivitetit në vlerësimin e studentëve*". Institucioni përdor platformen elektronike bit-albanian për të hedhur rezultatet për elementet e vlerësimit përfundimtar ndërsa vlerësimi i vazhdueshëm depozitohet në njësinë bazë.<br><br>*<u>GVJ rekomadon</u> përmirësimin e platformës duke mundësuar studentin të ketë akses në kohë reale në lidhje me vlerësimin e vazhdueshëm të bërë nga pedagogu i lëndës dhe reflektimin e pikëve të marra edhe në proçesverbalin përfundimtar.* |
| **Kriteri 3.** Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në | Testimi dhe vlerësimi bëhet nga një komisioni i përbërë nga dy anëtarë ku njëri prej tyre është edhe titullari i lëndës. |

| | |
|---|---|
| përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. | Komisionet aprovohen nga nga Drejtuesi i njësisë bazë në fillim të sezonit të provimit dhe aprovohen nga Dekanati i FIE-së. Tezat e provimit hartohen nga titullari i lëndës. Në syllabus janë përcaktuar qartë sa % zë pjesa teorike dhe përqindja e orëve të ushtrimeve për çdo lëndë në varësi të specifikës përkatëse të tyre. Tezat firmosen nga drejtuesi i njësisë bazë dhe një kopje e saj depozitohet në arshivën e saj.<br>*[Ref_044 Dokumentacion i vlerësimit të studentëve në provime dhe provim e diplomes; Ref_037 Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies e UPT; vizitë në sekretarinë mësimore].* |
| **Kriteri 4.** Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. | Vlerësimi i njohurive bëhet me pikë dhe konvertohet në notë përfudimtare. Provimet e pjesshme të zhvilluara gjatë vitit dhe provimi përfudimtar e shoqeron vlerësimin edhe me sqarime aty ku paraqitet e nevojshme. Bazuar edhe në rregulloren e zhvillimit kurrikular të mësimdhënies ne UPT, Kreu V pika 9, përcakton se vlerësimi i jepet studentit jo më vonë se 5 ditë nga data e zhvillimit të provimit. Komisioni bën me dije studentin për rezultatin e vlerësimit para plotësimit të dokumentacionit përkatës sipas nenit 36. Studenti ka të drejtën e sqarimit dhe të kundërshtimit të tij duke zbatuar të gjithë procedurat për ankimim jo më vonë se 3 ditë nga data e shpalljes së rezultatit.<br>*[Ref_037 Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies e UPT; vizitë në sekretarinë mësimore, takim me studentët dhe stafin akademik]* |
| **Kriteri 5.** Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. | Safi akademik është i kujdesshëm në lidhje me çdo formë abuzimi, kopjimi në detyra kursi dhe provime. Penalitetet zbatohet konform rregullores së percaktuar institucionale të UPT-së. Vëmendje i kushtohet temës së diplomës ku plagjatura nuk tolerohet *[Ref_006 Kodi i Etikës i UPT; Ref_037 Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies e UPT]* |
| **Kriteri 6.** Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. | Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën e studentit dhe jepen në kohë duke qenë se ato diskutohen mes pedagogut dhe studentit. [Ref. 12. Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT, Kreu V].. |
| **Kriteri 7.** Institucioni | Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me |

| | |
|---|---|
| garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. | vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit bazuar në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular të Mësimdhënies në UPT. Komisioni i provimit ka të drejtë ti japë sqarime studentit përpara se të bëjë zbardhjen e notes përfundimtare të tij. [Ref. 12. Rregullore e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT]. |
| **Kriteri 8.** Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet. | Studenti ka të drejtën e kundërshtimit të notës jo më vonë se 3 ditë nga data e shpalljes së notës përfudimtare. Ankesa paraqitet në sekretarinë Dekanit të FIE-së dhe Dekani ose Zv. Dekani per veprimtarinë mësimore kanë të drejtën të kërkojë për sqarim të gjithë palët e përfshira dhe të marrë vendimin në pranimin e notës ose refuzimin e saj aty ku paraqitet që ankesa është e drejtë nga ana e studentit. Çdo vendim i formës së prerë të marrë nga Dekani i FIE-së arshivohet në arkivën e FIE-së *[Ref. 30. Rregullore e brendshme e FTI]* |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se vlerësimi i njohurive dhe kontrolli i dijeve në programin e studimit MP në "Elektroenergjitikë" shprehen qartë në Rregulloren e UPT-së. Syllabuset shprehin qartë format e kontrollit të dijeve dhe pikët në lidhje më to. Frekuentimi është i detyrueshem në punët laboratorike dhe parakusht për të hyrë në provimin final. Në takimin e zhvilluar me studentët evidentojnë se ata njihen që në fillim të cdo lënde me përmbatjen e saj dhe detyrimet përkatëse. Institucioni i kushton vëmëndje antiplagjaturës dhe zbatimi i Kodite të Etikës në provime.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi III.4** | |
|---|---|
| **Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.** | |
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit duhet të garantojë | Programi i studimit Master Profesional në "Elektroenergjitikë" garanton thellimin e njohurive të marra në Bachelor në fushën e |

| | |
|---|---|
| thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve. | Inxhinierisë Elektrike. Siç theksohet edhe në Planin Strategjik të Njësisë Bazë (2019-2024), ky program synon krijimin e një shtrati ku studentët marrin njohuri të thelluara në fushën e elektroenergjitikës dhe avancojnë aftësitë në aspektet metodologjike dhe aplikative me qëllim që ti perdorin këto njohuri për të interpretuar problemet e ndryshme në praktike *[Ref_012 Plani Strategjik 2019-2024 i DSEF_FIE]*. Programi i studimit thellon njohuritë profesionale për problemet e prodhimit (burime konvecionale dhe të rinovueshme), transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, projektimit të rrjetave elektrike të shpërndarjes, projektimit të furnizimit me energji elektrike të ndërmarrjeve industriale e civile, teknologjitë e reja në sistemin elektroenergjitik, rrjetet smart dhe komunikimi në sistemin elektroenergjitik dhe të sektorit elektrik në tërësi. *[Ref_074 Guida Program Studimi (programet e shkurtuara) MP Elektroenergjetikë DSEF]* |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj). | Programi i studimit përfshin një larmi të gjerë lëndësh/modulesh (sipas kategorive nga A në E) të cilat në përputhje me Udhëzimet e MAS përmbushin kërkesat dhe detyrimet. Në programin mësimor janë vendosur edhe një grup lëndë me zgjedhje (6 lënde në total). Rishikimi i programit ka krijuar një hapësirë të re për lëndë me zgjedhje në fushën e teknologjise së informacionit dhe të koncepteve bazë të ekonomisë. Përmes tyre studenti ka mundësi të marre koncepte në lidhje me ekonominë dhe parimet bazë të menaxhimit të cilat e aftesojnë atë në fushën e biznesit edhe në mendurit e një drejtuesi ku përveç aspekteve inxhinierike duhet të jape mendim edhe për zgjedhjet ekonomike kryesisht në drejtim të menaxhimit të energjisë. Studenti në tre semestrat (I, II dhe te III) ka të drejtën e një lëndë me zgjedhje. Spektri i tyre është në fushen e programeve kompjuterike në rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike, përdorimin e softëare në menaxhimin dhe analizën e SE-së, ose në fushën e menaxhimit të energjise elektrike dhe cilësise së saj *[Ref_018 Planet dhe programet mësimore]*. |
| **Kriteri 3.** Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të | Bazuar në kuadrin ligjor ndryshimet për përmirësim në programin mësimor burojnë nga stafi akademik, nga mendimi i studentëve përmes anketimeve të kryera në fund të çdo semestri dhe në analizën e objektivave dhe kompetencave që çdo lëndë ka shprehur në syllabusin përkatës. Përmirësimet bëhen përmes diskutimeve në department dhe aprovohen më pas në hallkat |

| | |
|---|---|
| lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse. | përkatëse në përputhje me rregulloren institucionale dhe kornizën ligjore në fuqi. Pedagogu ka te specifikuar ne syllabus tematikat për orët e leksioneve, ushtrimet, punët laboratorike, paktikën lëndore dhe në përfundim të lëndës harton edhe një raport në lidhje me rezultatet e arritura në dhënien e njohurive, përmirësimin e aftësive dhe kompetencave të studentit, jep një informacion të detajuar pë procesin mësimor dhe metodat e mësimdhënies që ka realizuar *[Ref_077 Raportimi i pedagogut per aktivitetin mesimor per vitin akademik-model raportimi;Ref_072 Pyetësori mbi permirsimet e programeve të studimit DSEF; Ref_044 Dokumentacion i vlerësimit të studentëve në provime dhe provim e diplomes]*. Diskutime zhvillohen edhe në njësinë bazë dhe konkuzionet reflektohen edhe në raportin vjetor të analizës së procesit mësimor *[Ref_014 Raport i aktivitetit mësimor në nivel njësi bazë DSEF-FIE.]*. FIE përgatit bazuar në raportet e çdo njësi bazë raportin e saj vjetor e cila është pjesë përbërëse e raporti institucional që UPT paraqet në MASH *[Ref_013 Raport i aktivitetit mësimor në nivel njësi kryesore FIE]* |
| **Kriteri 4.** Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. | Mësimdhenia bazohet në format e përcaktuara në syllabus, në pëpruthje me ngarkesën e dhënë në planin mësimor dhe në akordancë me rregulloren e programit të studimit dhe të Rregullores së Zhvillimit Kurrikular të Mësimdhënies në UPT *[Ref_017 Tabelat 1-24 Të dhënat tabelore për Departamentin e Sistemeve Elektrike të Fuqisë; Ref_018 Planet dhe programet mësimore; Ref_074 Guida Program Studimi (programet e shkurtuara) MP Elektroenergjetikë DSEF; Ref_037 Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies e UPT]*. Kompetencat që studenti përfton janë dhënë në programet lëndore. Në syllabuse janë përcaktuar qartë tematika e orëve të laboratorit dhe frekuentimi i saj në masën 100% të detyrueshëm është një indikator që tregon rëndësinë që institucioni i kushton aftësimit praktik të studentëve. FIE zotëron një infrastrukturë të duhur për të mundësuar orët laboratorike. Këto zhvillohen në mjedise të përshtashme dhe mbështeten nga një staf ndihmës-akademik me përvojë *[Ref_117 CV e stafit ndihmes akademik; Ref_015 Plan pune te stafit ndihmes akademik]*.<br><br>Praktikat profesionale kryhen në kompani të njohura me të cilat institucioni ka nënshkruar edhe marrëveshje bashkëpunimi. Njësia baze monitoron procesin e zhvillimit të praktikës |

profesionale dhe relacionet e përgatitura vlerësohen nga një komision. *[Ref_042 Kartela e Praktikave Mesimore me Studentet MP; Ref_058 Lista e zhvillimit te praktikes mesimore; Ref_069 Praktika mësimore të studentëve në FIE-DSEF; Ref_090 Model zhvillimi i Praktikës Mësimore të një studenti]*.

Në metodologjinë e të nxënit konsiderohen leksionet, seminaret, orët laboratorike, detyra kursi, projekte kursi, konsultimet, puna në grup dhe individuale. Në zhvillimin e kompetencave të studentit organizohen edhe praktika lëndore tematikat e të cilave reflektohen në syllabusin e lëndëve *[Ref_017 Tabelat 1-24 Të dhënat tabelore për Departamentin e Sistemeve Elektrike të Fuqisë]*. Për zhvillimin e kompetencave shumë lëndë ofrojnë edhe punë laboratorike. GVJ konstaton përfshirjen e tematikës së tyre në syllabus dhe vlerësimin përkates me pikë. Detyrat e kursit/projektet jepen në javën e 5-te deri në javën e 8-të dhe dorëzimi i tyre bëhet në javën e 11-të deri në javën e 12-të dhe është parakusht për hyrjen e studentit në provim. Punët e laboratorit zhvillohen në javen e 5-të deri në javën e 11-të të semestrit. Punët laboratorike zhvillohen në grupe 2-3 studentë. Realizimi dhe relacioni për punët e laboratorit nga ana e studentit bëhen në javen e 11 – 12të dhe dorëzimi i tyre është parakusht për hyrjen e studentit në provim *[Ref_017 Tabelat 1-24 Të dhënat tabelore për Departamentin e Sistemeve Elektrike të Fuqisë; Ref_018 Planet dhe programet mësimore; Ref_074 Guida Program Studimi (programet e shkurtuara) MP Elektroenergjetikë DSEF]*. Njësia bazë monitoron procesin mësimor dhe në raportin vjetor paraqet edhe ngarkesën faktike të realizuar për leksionet, ushtrimet dhe punët laboratorike *[Ref_014 Raport i aktivitetit mësimor në nivel njësi bazë DSEF-FIE]*,

Në javën e fundit të programit zhvillohen edhe një përsëritje e njohurive dhe koncepteve themelore e cila orienton studentët në drejtim të strukturës së provimit përfundimtar.

| **Semestri** | **Orë në auditor**<br>**Detyrë kursi/Projekt kursi** |
| --- | --- |
| Semestri I | 17.5 |
| Semestri II | 17.5 |
| Semestri III | 15 |

| | |
|---|---|
| | Semestri IV \| 90 (Punimi i tezës së diplomës) |
| **Kriteri 5.** Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit. | Njësia bazë organizon edhe mësime të hapura. Personeli akademik efektiv mban orë të hapura ose seminare në lidhje me tematika specifike që japin njohuri për zhvillimet e fundit në fushën teknologjike. Njësia baze siguron edhe trajnime të studentëve ku workshop-i studentor tashmë është bërë një praktike e punës së saj.<br><br>*[Ref_022 Personel Akademik i huaj i ftuar; Ref_076 Aktivitetet e studenteve në FIE-DSEF].* |
| **Kriteri 6.** Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato. | Njësia bazë organizon workshop ku studentët janë pjesëmarrës. Vlen të përmendet workshop "Zhvillimi i qëndrueshëm i sistemit në focus të programeve të studimit që mbështet departamenti i sistemeve elektrike të fuqisë" i organizuar në kuadër të 70-vjetorit të UPT-së nga DSEF ku theksohet përfshirja e studentëvë në punët kërkimore shkencore si një nga sfidat kryesore *[Ref_035 workshopet e organizuar nga DSEF].*<br><br>GVJ u njoh me syllabusin e temës së diplomës. Punimet më të mira të tyre paraqiten edhe në konferenca studentore. Studentët janë pjesë e punimeve shkencore individuale të stafit akademik. Nga të dhënat e paraqitura nga institucioni rezulton se për tre vitet e fundit 10 studentë janë bërë pjesë e punimeve individuale të 6 PAE *[Ref_017 Tabelat 1-24 Të dhënat tabelore për Departamentin e Sistemeve Elektrike të Fuqisë; Ref_040 Projekt studentor "Smart Grid Tirana"].* |
| **Konkluzione** | *GVJ konkludon:*<br><br>*Programi i studimit në përmbajtjen e tij përfshin grup lëndë sipas kategorive formuese nga A në E duke dhënë një ngarkesë totale në 120 ECTS;*<br><br>*Mësimdhenia bazohet në format e përcaktuara në syllabus, në përputhje me ngarkesën e dhënë në planin mësimor dhe në akordancë me rregulloren e programit të studimit;*<br><br>*Format e mësimdhënies jepen në syllabus dhe rezultatet e të nxënit, njohuritë e fituara dhe kompetencat theksohen për çdo lëndë.*<br><br>*Njësia bazë monitoron procesin mëimosr dhe në fund të vitit raporton në lidhje me ngarkesën faktike të realizuar në procesin mësimor.* |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi III.5<br><br>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike. | Organizimi i procesit mësimor dhe kontrolli i dijeve realizohet në përputhje të plotë me Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT *[Ref_037 Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies e UPT]*. GVJ konstaton zbatimin e nenit 25 të rregullores së UPT-së në lidhje me dhënien e formave të kontrollit *[Ref_037 Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies e UPT]*.Format e kontrollit të dijeve: punë laboratorike, marrja/mbrojtja e detyrave, marrje/mbrojtje e projekteve reflektohen në grafikët përkatës të detyrimeve të cilët hartohen nga DSEF *[Ref_080 Afishimi në web i orareve mësimore]*.<br><br>Rregullorja e programit të studimit trajton detyrimet e studentit gjatë ndjekjes së programit mësimor *[Ref_074 Guida Program Studimi (programet e shkurtuara) MP Elektroenergjetikë DSEF]*. Detyrimet për çdo lëndë janë të shprehur qartë në syllabuset lëndore [*Ref_018 Planet dhe programet mësimore]*. Detyrimet përmbyllëse jepen edhe në faqen zyrtare të FIE-së www.fie.upt.al. |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse. | GVJ në takimet e zhvilluara në institucion konstaton se procedura e përgatitjes së temës se diplomës është konform dispozitave të Rregullores së Zhvillimit Kurrikular të Mësimdhënies në UPT dhe Rregullores së FIE-së *[Ref_037 Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies e UPT; Ref_008 Rregullore Njësi Kryesore FIE]*.<br><br>Në përfundim të studimeve studenti duhet të përgatisë edhe temën e diplomës e cila në planin mësimor parashikohet 18 ECTS. Rregullorja e programit të studimit në Kreun V jep të drejtat dhe detyrat e studentit në përgatijen e diplomës *[Ref_074 Guida Program Studimi (programet e shkurtuara) MP* |

| | |
|---|---|
| | *Elektroenergjetikë DSEF]*.<br><br>Tema e diplomës hartohet nga studenti në fillim të semestrit të dytë të vitit të dytë dhe miratohet brenda muajit nga njësia bazë. Tema zgjidhet duke marrë një shembull praktik, të mbështetur në metoda bashkëkohore dhe për të cilën studenti mund të shfrytëzojë edhe bazën laboratorike universitare. Rregullorja përcakton qartë mënyrën e përgatitjes së temës së diplomës dhe strukturën e saj në nenin 16 *[Ref_074 Guida Program Studimi (programet e shkurtuara) MP Elektroenergjetikë DSEF]*. Diplomimi jepet edhe në një syllabus të veçantë ku përcaktohen edhe aftësitë dhe kompetencat që fiton studenti në lidhje me të *[Ref_018 Planet dhe programet mësimore]*. Stafi PAE janë krysisht drejtues të temave të diplomës. Në syllabus janë dhënë qartë edhe kontrollet gjatë semestrit për zhvillimin e temës së diplomës. Punimi i diplomës kontrollohet në mënyrë periodike nga udhëheqësi i saj dhe në tre periudha kontrollohet nga pedagogu i ngarkuar në department.<br><br>Si parakusht për përgatitjen e temës së diplomës janë:<br><br>a. Realizimi i 102 krediteve teorike dhe praktika profesionale në kompaninë e miratuar paraprakisht nga departamenti;<br><br>b. Paraqitja në të gjitha kontrollet e parashikuar nga departamenti;<br><br>Hartimi i materialit të diplomës sipas rregullave të përcaktuara nga departamenti *[Ref_018 Planet dhe programet mësimore; Ref_074 Guida Program Studimi (programet e shkurtuara) MP Elektroenergjetikë DSEF]* |
| **Kriteri 3.** Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. | Programi mesimor nuk parashikon zhvillimin e provimit perfundimtar.<br><br>*[Ref_018 Planet dhe programet mësimore]*. |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe | Personeli akademik është i përfshirë në temat e diplomës. GVJ në takimet e zhvilluar me stafin akademik u njoh edhe me punën e tyre në dhënien e ndihmës dhe asistencës tek studenti |

| | |
|---|---|
| ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. | për përgatitjen e temës së diplomës *[takime me stafin akademik]*. Udhëheqësi i temës së diplomës asiston studentin bazuar në grafikun e punës së hartuar dhe rënë dakord me të. Ai asiston edhe në matjet kryesore dhe vlerëson përpunimin e rezultateve. Udheheqësi i temës së diplomës udhëzon studentin të përgatisë temën bazuar në kërkesat e manualit të punimit të temës së diplomes. Ai asiston studentin edhe gjatë tre sesioneve të kontrollit që departamenti kryen për të monitoruar progresin e studentëve gjatë përgatitjes së temës së diplomës. Udhëheqësi kur është i bindur se punimi i kryer nga studenti përmbush standartet e kërkuara e nënshkruan atë dhe jep aprovimin për paraqitjen e saj në komisionin e mbrojtjes së temës së diplomës. Kontrollet periodike nga njësia bazë organizohen bazuar edhe në rregulloren e programit të studimit dhe studenti duhet të ndjekë ato si parakusht për mbrojtjen e temës. Njësia baze ndjek një procedurë të qartë të miratimit të temës së diplomës. *[Ref_070 Procedure e Miratimit të temës së diplomës DSEF]*. |
| **Kriteri 5.** Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit. | GVJ konstatoi se egzistojnë të gjitha mundësitë për të shfrytëzuar bazën laboratorike të FIE-së për përgatitjen e temës së diplomës nën drejtimin e udhëheqësit. Gjithashtu, departamenti ofron mundësi tek studentët gjatë përgatitjes së temës së diplomës për të kryer matje apo teste edhe në laboratorë të veçantë që UPT disponon në njësi të tjera bazë apo në kompani private bazuar në marrëveshjet e nënshkruara institucionale *[Ref_051 Laboratoret në FIE dhe Departamentet e saj]*. |
| **Kriteri 6.** Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë. | Organizimi i mbrojtjes së temës së diplomës dhe vlerësimi i saj janë përcaktuar në dispozitat e Kreut VIII, neni 57 të Rregullores së Zhvillimit Kurrikular të Mësimdhënies në UPT *[Ref_037 Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies e UPT]*. Tema e diplomës mbrohet përpara një komisioni të posaçëm i cili propozohet nga drejtuesi i njësisë bazë dhe miratohet nga Dekani i FTI-së dhe përbëhet nga 3-5 anëtarë. Mbrojtja e temës së diplomës është publike. Komisioni vlerëson paraqitjen e punimit të temës së diplomës, merr në konsideratë vlerësimin nga recensuesi i diplomës, si edhe përgjigjet që studenti ka dhënë në lidhje me pyetjet e ngritura nga Komisioni i Posaçëm. Vlerësimet e çdo anëtari të komisionit pasqyrohen në proçes verbal dhe nota është mesatarizim i vlerësimit që çdo anëtar i komisioni ka dhënë për punimin e paraqitur nga |

| | |
|---|---|
| | student *[Ref_070 Procedure e Miratimit te temes se diplomest DSEF; Ref_044 Dokumentacion i vlerësimit të studentëve në provime dhe provim e diplomes]*.GVJ u njoh edhe me procedurë të vlerësimit të komisionit të diplomimit dhe konstaton se zbatimi i saj është në përpruthje me nenet e përcaktuara ne Rregulloren e UPT-së *[Ref_084 Komisione të vlerësimit dhe organizimit të provimeve të diplomes; Ref_037 Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies e UPT]*. |
| **Kriteri 7.** Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. | Në përfundim të studimeve MP në "Elektroenergjitikë", studentit i vihet në dispozicion diploma (sipas modelit të miratuar nga MASR) dhe suplementi i diplomës së bashku me listën e notave *[Ref_089 Modeli i Diplomës dhe modeli i suplementit të diplomës]*. Përmbajtja dhe forma e suplementit përcaktohen ne statutin e UPT-së dhe GV konstaton se përmbajtja e saj është edhe në përputhje me udhëzime të MASR për Arsimin e Lartë *[Ref_089 Modeli i Diplomës dhe modeli i suplementit të diplomës; Ref_001 Statuti i UPT]*.<br><br>Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopja e plotë e programit të studimit të zhvilluar. Studenti ka të drejtë të tërheqi një kopje të programit në çdo kohë që ai e sheh të arsyeshme *[Ref_037 Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies e UPT]* |
| **Kriteri 8.** Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen. | FIE dhe DSEF zbatojnë një sistemi arkivimi të materialeve dhe dokumentacionit në përputhje me ligjin e Arkivave, konform kuadrit ligjor në fuqi dhe rregullores institucionale të UPT-së. Dokumentacioni i studentëve në përfundim të studimeve të tyre ruhet në një kopje në të njëjtëen përmbajtje me dosjen që studenti ka pasur gjatë zhvillimit të studimeve. Në raste kërkese nga ana e studentit pas diplomimit të tij, strukturat bazë japin sqarime dhe vërtetime apo referenca nëlidhje me ciklin e studimeve që studenti ka kryer në këtë program studimi *[vizitë në sekretarinë mësimore]*. |
| **Konkluzione** | *GVJ konkludon:*<br>• *Programi mësimor përcakton mbrojtjen e temës së diplomës e cila në planin mësimor është 18ECTS;*<br>• *GVJ konstaton se tema e diplomës hartohet dhe miratohet bazuar në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular të Mësimdhënies;* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | • *Temat e punimeve të diplomës prekin ceshtje reale dhe shoqerohen me rekomandimet përkatëse.*<br>• *Në perfundim të studimeve student pajisjet me Diplomen dhe Suplementin e saj në formatin e aprovuar nga MASR;* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes sëstandardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi III.6**<br>**Në rastin e programit të studimit në "Master Profesional" institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përftimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizmin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale. | Procesi mësimor në programin e studimit Master profesional në "Elektroenergjitikë" zhvillohet në ambjentet e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike e vendosur në korpusin e UPT-së. Godina është ristrukturuar në përputhje me të gjithë standartet që parashikon një godinë arsimore. Mjediset e brendshme sigurojnë salla mësimi, laboratorë, zyra dhe mjedise për studentët. Godina është fuksionale dhe me akses në mjediset e tjera të Universitetit Politeknik. Nga vizita në institucion, GVJ konstatoi se ambientet në të cilat zhvillohet procesi mësimor janë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për një zhvillim cilësor të këtij procesi, që përfshin: ngrohje-ftohjen, ndriçimin, tabelat, projektorë dhe çdo gjë tjetër të domosdoshme për këtë qëllim. Një kontribut i rëndësishëm ofrohet nëpërmjet bazës laboratorike, e cila, në drejtim eshte eprmiresuar nga projektet kerkimore shencore qe njesia baze eshte bere pjese si partnere *[Ref_017 Tabelat 1-24 Të dhënat tabelore për Departamentin e Sistemeve Elektrike të Fuqisë; Ref_051 Laboratoret në FIE dhe Departamentet e saj].* FIE ka në përdorim 12 ambiente laboratorike, 11 prej të cilëve janë laboratorë të lëndëve dhe 1 është laborator informatike. Departamenti i Sistemeve Elektrike të Fuqisë ka tre laboratorë në infrastrukturë për kryerjen e punëve laboratorike dhe kërkimore: Laboratori i Analizës së Sistemit Elektroenergjitik, Laboratori i Tensioneve të Larta dhe |

| | |
|---|---|
| | Materialeve Elektrike dhe Laboratori i Impianteve Elektrike dhe Mbrojtjes Rele. Departamenti ka ndërtuar një mikrorid PV-Wind Generator me aksesorë për monitorimin e regjimeve të tyre; Matësin dhe softin përkatës të shkarkimeve atmosferike; një stacion meteorologjik on-line (për vlerësimin e rregjimeve të punës të impanteve të mësipërm) të cilat përdoren edhe për punime shkencore nga ana e stafit akademik ose përgatitje tema diploma nga studentët. *[Ref_051 Laboratoret në FIE dhe Departamentet e saj]* |
| **Kriteri 2.** Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale. | DSEF ka nënshkruar një sërë marrëveshje bashkëpunimi për kryerjen e praktikës profesionale të studentëve. Praktika profesionale është vendosur në planin mësimor në semestrin e dytë të vitit të dytë dhe monitorimi i saj nga njësia bazë zhvillohet bazuar edhe në përcaktimet ligjore të shprehur në rregulloren e programit të studimit *[Ref_019 Marrëveshje Institucionale; Ref_020 Marrëveshje me Industrinë; Ref_090 Model zhvillimi i Praktikës Mësimore të një student]*. |
| **Kriteri 3.** Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës. | Rregullorja e programit te studimit percakton qarte ne kapitullin IV zhvillimin e praktikës profesionale *[Ref_074 Guida Program Studimi (programet e shkurtuara) MP Elektroenergjetikë DSEF]*. Në takimin e zhvilluar me studentët GVJ konstaton njohjen e procedurës nga ana e tyre për zhvillimn e praktikës profesionale. Informacion në lidhje me te jepen edhe në www.fie.upt.al. Njësia bazë monitoron procesim e zhvillimit të praktikës profesionale. GVJ u njoh me dokumentacion të gjerë në lidhje me zhvillimin korrekt të dhe konkludon se ajo zhvillohet në përputhje me klauzolat ligjore të shprehur në dokumentat bazë institucionalë. *[Ref_042 Kartela e Praktikave Mesimore me Studentet MP; Ref_058 Lista e zhvillimit te praktikes mesimore; Ref_069 Praktika mësimore të studentëve në FIE-DSEF; Ref_090 Model zhvillimi i Praktikës Mësimore të një student]* |
| **Konkluzione** | *GVJ konkludon se procesi mësimor në programin e studimit Master Profesional në "Elektroenergjitikë" zhvillohet në ambjentet e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike i cili zotëron një infrastrukturë me kapacitet te duhura për programin mësimor. Praktika profesionale përfshin në planin mësimor me 18 ECTS. Ajo zhvillohet në përputhje me nenet ligjore të Rregullores së* |

| | |
|---|---|
| | *Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT dhe me Rregulloren e programit të studimit. Studentët zhvillojnë praktikat profesionale në kompanitë me të cilat DSEF ka nënshkruar edhe marrëveshje institucionale bashkepunimi.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi IV.1**<br><br>**Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të | Personeli akademik që mbulon programin e studimit përbëhet nga pedagogë me eksperiencë pedagogjike dhe profesionale, dhe përgjithësisht kualifikimin e duhur profesional në fushat përkatëse që ata zhvillojnë në program.Nga shyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion *[Ref_017 Tabelat 1-24 Të dhënat tabelore për Departamentin e Sistemeve Elektrike të Fuqisë, tab 6.1-6.3]*, për realizimin e programit të studimit MP në "Elektroenergjitikë" janë angazhuar staf akademik për tre vite akademike si më poshtë:<br>1. Për vitin akademik 2020 - 2021 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 10 pedagogë nga të cilët 8 PAE dhe 2 PAK (80% / 20 %);<br>2. Për vitin akademik 2021 - 2022 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 10 pedagogë nga të cilët 8 PAE dhe 2 PAK (80% / 20 %); |

| | |
|---|---|
| tij. | 3. Për vitin akademik 2022- 2023 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 10 pedagogë nga të cilët 8 PAE dhe 2 PAK (80% / 20 %); |

| Tituj/ grada | 2020-2021 | | 2021-2022 | | 2022-2023 | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | PAE | PAK | PAE | PAK | PAE | PAK |
| Prof.Dr. | 2 | - | 2 | - | 2 | - |
| Prof. Asoc. | - | - | - | - | - | - |
| Dr./PhD. | 2 | 2 | 2 | 2 | 2 | 2 |
| Msc. | 4 | - | 4 | - | 4 | - |
| **Totali** | **8** | **2** | **8** | **2** | **8** | **2** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. | Për realizimin e programit të studimit në Master Profesional ne Elektroenergjetike janë përfshirë vetem personel nga Departamenti i Sistemeve Elektrike te Fuqise,ekspertë dhe konsulentë të fushës. Nga shqyrtimi i dokumentacionit *[Ref_017 Tabelat 1-24 Të dhënat tabelore për Departamentin e Sistemeve Elektrike të Fuqisë, tab 12.1-12.3]*, mbulimi i ngarkesës mësimore pë dy vite akademike rezultonsi më poshtë: |

| Viti | Total orësh | PAE | PAK | PAE/PAK (%) |
|---|---|---|---|---|
| 2021-2022 | 520.45 | 423.95 | 96.5 | 81% / 19% |
| 2022-2023 | 602 | 465 | 137 | 77% / 23% |

Nga tabela rezulton që për 2 vite akademike, ngarkesa mësimore për këtë program studimi, është përballuar me mbi 70% nga stafi akademik me kohë të plotë, sipas VKM Nr. 418, datë 10.05.2017.

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e | Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita ne zyren e burimeve njerezore kostatojme se Institucioni ka lidhur kontratat e punësimit të personelit akademik efektiv dhe me kontratë në përputhje me aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi, në të cilat parashikohet mbulimi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Nga të dhënat e vëna në dispozicion në DVV vihet re një |

| | |
|---|---|
| akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore. | qëndrueshmëri e stafit ndër vite.<br>*[Ref_017 Tabelat 1-24 Të dhënat tabelore për Departamentin e Sistemeve Elektrike të Fuqisë, tab 6.1-6.3; 12.1-12.3]* |
| **Kriteri 4.** Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. | U shqyrtuan dy praktika rekrutimi të stafit akademik për programin e studimit MP në Elektroenergjitike. Në to ishin paraqitur kritere të përgjithshme, si niveli i kualifikimit i kërkuar, fusha e arsimimit, eksperienca në punë, kualifikimi shkencor. Në kërkesën e departamentit shprehet edhe fusha për të cilën kërkohet rekrutimi i stafit, duke listuar lëndët në të cilat do të angazhohet në mësimdhënje. Në dy praktikat e shqyrtuara, personeli akademik i rekrutuar kishte ekspertizën në përputhje me kërkesat specifike të shpallura. Komisioni i vlerësimit ka bëre renditjen e kandidatëve që plotësojnë më mirë kërkesat për vëndin e punës dhe ja ka përcjelle dekanit të fakultetit dhe me tej Rektorit per vendimarrje.<br>*[Ref_026 Praktika e Punësimit në FIE-DSEF]* |
| **Kriteri 5.** Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit. | Departamenti i DSEF garanton angazhimin e stafit akademik dhe ndihmës akademik për realizimin korrekt të orëve laboratorike të parashikuara në programin e studimit Master Profesional ne Elektroenergjitikë, si dhe mirëmbajtjen e ambjenteve dhe pajisjeve laboratorike përkatëse.<br>*[Ref_009 Rregullore Njësi Bazë DSEF_FIE, Neni 32; Ref_117 CV e stafit ndihmës akademik].* |
| **Kriteri 6.** Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe | UPT dhe vecanerisht FIE/DSEF ka përditësuar çdo vit akademik të dhënat e personelit akademik dhe ndihmës akademik të angazhuar në programet e studimit që ofron. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Juridike administronte dhe shprehte përgjegjësine për ruajtjen e këtij informacioni, i cili me pas ju vihej në dispozicion njësive kryesore dhe bazë të Institucionit sipas nevojave të tyre.<br>*[Ref_001 Statuti i UPT; Ref_002 Organigrama e UPT; Ref_008 Rregullore Njësi Kryesore FIE; Ref_009 Rregullore Njësi Bazë DSEF_FIE; Ref_017, Tabelat 1 & 2; Ref_116 CV e stafit akademik].* |

| | |
|---|---|
| vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ. | |
| **Kriteri 7.** Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. | Në kuadër të zhvillimit të praktikave profesionale, Institucioni ka vendosur marrëveshje bashkëpunimi (Marreveshje me industrine) me 55 kompani dhe istitucione private dhe 15 shteterore, nga të cilat 60% te kompanive private dhe dhe 24% shteterore, zhvillojnë aktivitetin e tyre direkt në drejtim të fushes se studimit te programit ne Elektroenergjitikë *[Ref_020 Marrëveshje me Industrinë]*.<br><br>Gjithashtu FIE për mbarvajtjen e praktikës ne cdo kontratë te nënëshkrur për kryerjen e praktikës profesionale ka përcaktoheshin ndër të tjera studentët praktikantë, afatin e praktikës, detyrimet e palëve etj. *[Ref_042 Kartela e Praktikave Mësimore me Studentët MP]*.<br><br>GVJ konstaton se Departamenti i DSEF ka ngarkuar dhe kanë vënë në dispozicion të praktikave profesionale një personel të mjaftueshëm e të kualifikuar për ndjekjen e tyre në terren, për orientimin dhe instruktimin e studenteve sidomos me masat e sigurimit teknik. |
| **Kriter 8.** Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale. | Nga gjetjet ne sekretarine mesimore dhe takimi me pedagoget GVJ evidentoj se gjatë kryerjes së praktikës profesionale, personeli akademik që drejton atë, ushtron kontroll të vazhdueshëm dhe mban lidhje me kompanine/institucionin pritës ku ajo kryhet. Institucionet e praktikes profesionale vënë në dispozicion të studentëve personel të kualifikuar për mbikëqyrjen e praktikës profesionale, dhe mbështesin studentët në hartimin e raportit përfundimtar të praktikës dhe marrin pjesë në procesin e vlerësimit të tyre *[Ref_020 Marrëveshje me Industrinë]*.<br><br>Në përfundim të praktikës profesionale, studentet kishin përgatitur një relacion për punën e kryer, i cila pasi kishte marre edhe mendimin e qendrës ku është kryer e ka paraqitur para komisionit te praktikes. Vlerësimi përfundimtar i praktikës profesionale behej nga komisioni i praktikës, i cili vlerëson punën e bërë nga studenti mbështetur në prezantimin e paraqitur prej tij dhe dokumentat shoqeruese e vleresuse kompanite/institucionet e praktikes. *[Ref_074 Guida Program Studimi (programet e shkurtuara) MP Elektroenergjetikë* |

| | |
|---|---|
| | *DSEF].* |
| **Konkluzione** | *Në programin e studimit "Master Profesional ne Elektroenergjitikë", nga Departamenti i Sistemeve Elektrike te Fuqise, Fakulteti Inxhinierisë Elektrike, është angazhuar personel akademik efektiv dhe me kontratë dhe personel ndihmës akademik në përputhje me legjislacionin në fuqi, nevojat dhe specifikat e programit.*<br><br>*Institucioni ka një procedurë të qartë dhe transparente të rekrutimit dhe të vlerësimit te kandidateve, duke garantuar përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën e programeve të studimit. Ngarkesa mesimore mbulohet kryesisht nga personeli akademik efektiv dhe lende specifike nga ai me kontrate në përputhje me legjislacionin në fuqi. Raporti i ngarkeses mesimore PAE/PAK, per v.a.2021-2022 eshte 81% / 19% dhe va 2022-2023 eshte 77% / 23%. Bashkëpunimi me rreth 55 kompani dhe istitucione private dhe 15 shteterore të cilat zhvillojnë aktivitetet e tyre në fushën e Elektroenergjitikës mundëson dhe garanton realizimin korrekt të praktikave profesionale të studentëve.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.2**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve | Fakulteti i Inxinierise Elektrike, ushtron aktivitetin e tij ne pjesën kryesore të godinës historike dhe ne ambjente të përbashkëta me Fakultetin e Teknologjise se Informacionit dhe Fakultetin e Inxhinierise Mekanike. Me numrin e studentëve aktivë, për vitin akademik 2021 – 2022, ka në dispozicion ambiente të mjaftueshme për zhvillimin e procesit mësimor me siperfaqe 7653.78 m², që i korrespondon raporti 5.08 m²/student.<br><br>Nga perpunimi statistikor i te dhenave bazuar ne normat dhe standardet qe kerkohen, GVJ konkludon se Auditorët, |

| | |
|---|---|
| përkatëse. | laboratorët, bibliotekat e ambjentet për stafin akademik dhe për studentët etj, plotësojnë 100% nevojat për mbarëvatjen e programeve të studimit të ofruara nga ky fakultet dhe specifikisht për programin e studimit "Master Profesional ne Elektroenergjitikë".<br>*[Ref_111 Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit (sallat, laboratoret, platformat on line, struktura e teknologjisë së informacionit, hapësirat ndihmëse].* |
| **Kriteri 2.** Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. | Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe gjatë vizitës në institucion, u konstatua se FIE siguron mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse. Programi i studimit MP në "Elektroenergjitike" e zhvillon aktivitetin didaktik në ambientet e FIE-së. Hapësirat në dispozicion për këtë program studimi janë të shpërndara si në tabelën më poshtë: |

| Mjediset për Fakultetin/përgjegjës për programin e studimit | Sasia | Sipërfaqja |
|---|---|---|
| Salla për leksione | 5 | 1150 |
| Klasa për seminare | 9 | 452.7 |
| Laboratorë për lëndët | 11 | 676.58 |
| Salle bibliotekw | 1 | 56.42 |
| Korridore/holle | 8 | 1,365 |
| Nyje hidrosanitare për studentët | 15 | 95.1 |
| Norma m2/për student | 448.57 m2/ 50 studentë = 8.97 m2/student | |
| Mjediset për stafin: | Sasia | Sipërfaqja |
| Zyra për Dekanin/zyrë mbledhjesh | 2 | 49.75 |
| Zyra për sekretarinë mësimore | 1 | 23.85 |
| Zyra për departamentet | - | - |
| Zyra për personelin akademik të departamenteve | 12 | 324.96 |
| Zyrë për financën | 2 | 40.25 |
| Zyrë për Njësinë e SBC | - | - |
| Zyrë për Koordinimin dhe Mbështetjen ndaj Studentëve / Zyrë IT | - | - |
| Nyje hidrosanitare për personelin akademik | 2 | 9.76 |
| Norma m2/për person | 448.57 m2/ 50 persona = 8.97 | |

| | |
|---|---|
| | \| \| m2/person \|<br><br>*[Ref_017 Tabelat 1-24 Të dhënat tabelore për Departamentin e Sistemeve Elektrike të Fuqisë; Ref_123 Infrastruktura e kërkimit shkencor në DSEF].*<br><br>GVJ evidenton një shpërndarje më të mirë të ambienteve brenda godinës në funksion të programit të studimit. GVJ konstaton se mungojnë hapësira për disa struktura mbështetëse siç është Zyrë për Koordinimin dhe Mbështetjen ndaj Studentëve / Zyrë IT, zyrë informacioni për studentët, mjedise shlodhëse si kafeteri/ fast-food/etj mungesë të sallës për aktivitete promovuese, të mjedisit për aktivitete studentore, rekreative, mjediseve sportive për të cilat rekomandojmë të konsiderohen nga institucioni në vijim të plotësimit të kushteve për një ambient ndërveprues studentor.<br><br>*[Ref_065 Investime në pajisje laboratorike FIE], [Ref_123 Infrastruktura e kërkimit shkencor në DSEF].* |
| **Kriteri 3.** Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. | Fakulteti i Inxhinierise Elektrike zoteron 10 laboratore dhe 1 laborator Informatike në dy godinat që zhvillon aktivitetin e tij. *[Ref_111 Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit (sallat, laboratoret, platformat on line, struktura e teknologjisë së informacionit, hapësirat ndihmëse].* GVJ vecon 4 laboratoret e DSEF qe mbulojne lende dhe module specifike ne interes te ketij programi studimi si me poshte:<br><br>1-Laboratori i Analizes se Sistemit Elektroenergjetik.<br><br>*(Disponon rrjet kompiuterash, Softe te Licensuar ATP dhe NEPLAN si dhe nje baze te rendesishme te dhenash per sistemin elektroenergjetik Shqiptar).*<br><br>2-Laboratori i Tensioneve te Larta dhe Materialeve Elektrike.<br><br>*(Disponon pajisje e pjese unikale per provat ne tensione te larta dhe per matjen e parametrave te materialeve izoluese)*<br><br>3-Laboratori i Impianteve Elektrike dhe Mbrojtjes Rele.<br><br>*(Disponon module te ndryshme per studimin e pajisje te mbrojtje rele, module per simulimin e difekteve, modul per shndrimin A/D dhe D/A te sinjale dhe softe per analizen e sjelljes se tyre. Njekohesisht ka edhe nje sere aparatesh te tjera per vleresimin e cilesise se energjise elektrike).* |

| | |
|---|---|
| | 4-Laboratori i Tensioneve te Mesme (Investim i ri).<br>*(Disponon pajisje per provat ne tensione te mesme, matjen e parametrave te materialeve izoluese per te cilat ka investuar vete fakulteti)*<br>*[Ref_051 Laboratoret në FIE dhe Departamentet e saj]*.<br>Njësia bazë përpiqet të pasurojë bazën laboratorike. Në kuadër të projektit 'ENGINE" është mundësuar blerje të shumë komponentëvë të cilët garantojnë edhe cilësinë e orëve laboratorike. *[Ref_096 Blerje Pajisje Laboratorike FIE]* |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron. | GVJ sipas planit te detajuar te vizites, vëren se Institucioni në tërësinë e ambienteve te tij, siguron gjithsej 12 laboratore për lëndët e informatikës dhe teknologjisë së informacionit. *[Ref_111 Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit]*.<br>Nga GVJ u vu re sa ato ishin të pajisur me aparatura të nevojshme dhe specifike, gjithashtu edhe me instrumente ndihmëse sikurse janë video-projektorët dhe printera të lidhur në rrjet. Hapësira brenda laboratorëvë është e mjaftueshme për të garantuar numrin e studntëvë në këtë program studimi. Për zhvillimin e lëndëvë me bazë teknologjinë e informacionit dhe gjuhët kompjuterike shfrytëzohen laboratorët e departamentit të teknologjisë së informacionit (7 laboratorë të cilët janë me parametra të fundit për C. C++, JAVA, Python, sinjalet, rrjetat, sistemet elektronike etj). Në lidhje me garatimin e orëvë laboratorike FIE zotëron një laborator të infrmatikes të cilen në vizitën e zhvilluar në institucion konstatojmë se plotëson standartet për të garantuar një cilësi në këtë fushë *[Ref_051 Laboratoret në FIE dhe Departamentet e saj]*. |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme | Për realizimin e praktikës profesionale institucioni vë në dispozicion jo vetëm mjediset e tij por edhe ato të ofruara nga institucionet me të cilat bashkëpunon. Për zhvillimin e praktikës mësimore hartohet edhe një kontratë e cila nënshkruahet midis studentit dhe kompanisë ku ai/ajo do të zhvillojë praktikën profesionale. GVJ u njoh më formatin e kontratës në evidencat e paraqitura nga institucioni. Vlen të përmendet bashkëpunime me 4-AM për zhvillimin e praktikës profesionale në projektin e tunelit të Krrabës, formularin e vlerësimit nga Inxhinieri Elektrik në rolin e supervizorit për studentin dhe raportet e paraqitur në |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatore me kapacitetet e nevojshme. | përfundim të saj *[Ref_069 Praktika mësimore të studentëve në FIE-DSEF; Ref_058 Lista e zhvillimit te praktikes mesimore; Ref_042 Kartela e Praktikave Mesimore me Studentet MP; Ref_090 Model zhvillimi i Praktikës Mësimore të një studenti]*.<br><br>Nga dokumenti i marrëveshjeve, GVJ konstatoi se FIE ka marrëveshje me 55 Kompani Private, me 13 Universitete Kombëtare, 15 Institucione shtetërore, dhe me 34 Universitetet Europiane. Bashkëpunimi me institucione dhe subjekte të tjera organizohet si në nivel institucioni, por edhe më specifikisht për këtë program studimi, në nivel njësie kryesore dhe asaj bazë *[Ref_019 Marrëveshje Institucionale; Ref_020 Marrëveshje me Industrinë]*. | | | |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se FIE ka në dispozicion ambjente me pajisjet e nevojshme për realizimin e objektivave mësimore të programit të studimit "Master Profesional ne Elektroenergjitikë", duke mundësuar realizimin e procesit mësimor teorik dhe praktik përmes përdorimit të metodave bashkëkohore të mësimdhënies.*<br><br>*Këto laboratore përmbajnë paisjet e nevojshme teknike dhe informatike për të zhvilluar laboratoret dhe praktikat me studentët por përdorem edhe per kerkime shkencore nga stafi i DSEF.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.3**<br><br>**Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e | Nga verifikimi në institucion dhe dokumentat e dorëzuara [Ref_049 Pasurimi i koleksionit të Bibliotekes Shkencore 2017-2020. Ref_050 Biblioteka e UPT dhe Qendra Multimediale e FIE] studenteve të FIE-së, i është ofruar qasje tek bibliotekat e universitetit të UPT përkatësisht:<br><br>a. Bibliotekën Shkencore Qendrore të UPT,<br><br>b. Bibliotekën e Fakultetit të Inxhinierisë Matematike & |

| | |
|---|---|
| studimit. | Inxhinierisë Fizike si dhe;<br>c. "Qendra Multimediale" e përbashkët e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit<br><br>GVJ shqyrtoi me vëmëndje syllabuset për secilën lëndë dhe konstaton se nga ana e stafit akadmeik ofrohet një literaturë e detyruar dhe ndihmëse tek studentët. GVJ konstaton se në literaturën e detyruar ofrohen skripte/leksione të përgatitura, libra ndërsa për literarurën ndihmëse ofrohen libra dhe katalogë. GVJ konstaton së për disa lëndë literatura bazë është e vjetër ndërsa litarura ndihmësë është e 10 viteve të fundit. Literarura bazë garatohet në bibliotekë por edhe shpërndahet nga stafi akademik në formë elektronike dhe leksione te shkruara (Microsoft Teams) *[takim me stafin akademik, vizitë në bibliotekë]*.<br><br>*[Ref_049 Pasurimi i koleksionit të Bibliotekës Shkencore]*. Literatura bazë për çdo modul në këtë program studimesh është në gjuhën shqipe dhe jepet në syllabuset e çdo lënde. *[Ref_018 Planet dhe programet mësimore]*.<br><br>Literatura në pjesen më e madhe e lëndëve mbulohet nga botimet e stafit. Nga stafi akademik i programit të studimit jane përgatitur cikle të leksioneve, të cilat i janë depozituar në klasat virtuale në platformën Microsoft Teams *[Ref_124 Udhëzues për zhvillimin e mësimit në distancë]; https://biblioteka-shkencore.edu.al dhe http://www.fie.upt.al/biblioteka.php* |
| **Kriteri 2.** Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit. | Biblioteka shkencore e UPT si institucion kulturor dhe informues, mbështet studentët dhe stafin akademik në punën shkencore përmes sigurimit të informacionit në fushat e interesit të tyre *[Ref_050 Biblioteka e UPT dhe Qendra Multimediale e FIE]. https://biblioteka-shkencore.edu.al dhe http://www.fie.upt.al/biblioteka.php.*<br><br>Nga DSEF ishin paraqitur kerkesat prane Drejtorise se bibliotekës per shtimin e 65570 titujve qe disponpremin aktualisht dhe 75 vendeve te leximit, *[Ref_049 Pasurimi i koleksionit të Bibliotekes Shkencore 2017-2020], [Ref_024 Shkëmbimet e Literaturës-Biblioteka]*. GVJ konstatoi qe shërbimet teknike, si pasurimi me literaturë të re dhe përpunimi standard i tyre, kryhen respektivisht nga Sektori i Zhvillimit të Koleksioneve |

| | |
|---|---|
| | dhe Sektori i Katalogimit, pranë BSHQ. |
| **Kriteri 3.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. | UPT ofron për studentët në këtë program studimi tre biblioteka:<br>a. Bibliotekën Shkencore Qendrore të UPT,<br>b. Bibliotekën e Fakultetit të Inxhinierisë Matematike & Inxhinierisë Fizike si dhe;<br>c. "Qendra Multimediale" e përbashkët e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit<br>Nga vizitat në nënvizojmë se bibliotekat kane te mirëorganizuar.<br>• Artikujt bashkohor shkencor: Biblioteka Shkencore ka 65570 tituj ku me literaturë bashkëkohore me profil tekniko–shkencor, në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj, në fushat e interesit të studentëve dhe stafit akademik të UPT;<br>• Qendren elektronikle multimediale:<br>o libra të huaj / 660 tituj (754 njësi);<br>o libra shqip / 226 tituj (287 njësi );<br>o Periodike / 8 tituj (76 njësi);<br>o Punime shkencore dhe dorëshkrime, artikuj shkencorë (102 njësi);<br>o Fondi referencial (enciklopedi, fjalorë e tj.) (34 njësi);<br>o CD-ROM (168 njësi);<br>o Kaseta audio-vizuale /58 (cikël leksionesh) (1160 njësi);<br>*[Ref_050 Biblioteka e UPT dhe Qendra Multimediale e FIE]*. |
| **Kriteri 4.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive | GVJ konstaton se fondi i bibliotekës është i pasur duke i ofruar studentëve një bazë të fortë literature në fushën e inxhinierisë elektrike/eletroenergjitikë. Universiteti Politeknik i Tiranës, përveç literaturës se shtypur ofron edhe akses ne bibliotekat elektronike online siç janë JSTOR dhe ULIBRARY *[https://ulibrary.rash.al/]*. Studentët dhe stafi akademik mund të shfrytezojne materialet ne forme elektronike nga kompjuterat e vendosura ne dispozicion. Aksesi është i lirë për të gjithë studentet dhe i disponueshëm në çdo kohe. Gjithashtu është funksional sistemi i katalogimit dhe kërkimit në bibliotekën e Universitetit Politeknik të Tiranës, COBISS |

| | |
|---|---|
| mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. | *[https://plus.al.cobiss.net/opac7/libraries;]*. |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit. | GVJ konstaton se studentëvë u ofrohet një trajtim i barabartë dhe pa kufizim në lidhje me fondin e bibliotekës. Qendra Multimediale ka kapaciteti fizik 32 vende/poste pune-kërkimi dhe ofron shërbimet: Shërbimi në fond të hapur i koleksioneve; Katalogu elektronik (COBISS – UPTFIE); Kartë elektronike anëtarësimi, Interneti (wireless), Fotokopje; Burimet elektronike; Shërbimin me projektor. Nga ana e qasjes në literaturë elektronike biblioteka ka arritur të jetë e ndërlidhur ne rrjet mjaft të gjere COBISS, FGJM, FIE dhe FIN/FAU me mbi ~200 mije libra, ~50 mije revista, 200 milion lajme shkencore, dhe paketa per mësimin e gjuhëve elektronike *[Ref_050 Biblioteka e UPT dhe Qendra Multimediale e FIE]*. Institucioni ofron akses tek studentët edhe në portalin informatik U-Library (https://ulibrary.rash.al/) |
| **Kriteri 6.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët. | Biblioteka ofron kartë elektronike anëtarësimi, Interneti (wireless), Fotokopje; Burimet elektronike; Shërbimin me projector. GVJ konstaton se Biblioteka Qëndrore nuk ofron kompjutera fizik për studentët ndërsa dy bilioteka e tjera janë të pajisur me laptop duke lehtësuar studentët në kërkimet për tituj online *[vizitë në bibliotekë]*.<br><br>*[Ref_050 Biblioteka e UPT dhe Qendra Multimediale e FIE]*. |
| **Kriteri 7.** Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. | GVJ konstaton nga vizitat e kryer në bibliotekë dhe nga evidencat e paraqitur nga institucioni oraret e funksionimit të tyre si vijon më poshtë:<br>1. Biblioteka qëndrore/shkencore qëndron e hapur e Hënë - e Premte: 08.00 - 19.00, e Shtunë: 08.00 - 14.00;<br>2. Qendra Multimediale e FIE qëndron e hapur nga e Hënë - e Premte: 08.00- 16.00;<br><br>*[Ref_047 Rregullore e Bibliotekës Shkencore]*. |
| **Kriteri 8.** Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë | GVJ konstaton nga takimi me stafin akademik punën që ai kryen në lidhje me përmirësimin e përmbajtjes së lëndëvë. Në këtë drejtim pasurim kryhet edhe në lidhje me literaturën e ofruar si nje komponent i rëndësishëm për studentët *[takim me stafin akademik]*. |

| | |
|---|---|
| të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik. | Kërkesa për literaturë buron nga njësia bazë dhe ndjek një procedurë të përcaktuar qartë në rregulloren e institucionit. Pasurimi i bibliotekës bëhet çdo vit. GVJ konstaton se FIE nuk ka përfituar blerje të librave dhe fondi për të ne lidhje me njësitë e tjera është shumë i vogël *[Ref_049 Pasurimi i koleksionit të Bibliotekes Shkencore 2017-2020]*.<br><br>GVJ nuk ka të dhëna në lidhje me blerjen e zhvilluara për vitin 2022, 2023. Evidencat e paraqitura nga institucioni ndonëse tregojnë zbatimin e një praktike të duhur në lidhje me pasurimin me libra të rinj, pasqyrojnë vetëm periudhën 2017-2020 *[Ref_049 Pasurimi i koleksionit të Bibliotekes Shkencore 2017-2020]*. |
| **Konkluzione** | *Nga biblioteka qendrore e UPT dhe ajo mësimore e FIE, vihen në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik të programit të studimit "Master Profesional ne Elektroenergjitikë", në format fizik dhe elektronik pa pagesë, literaturë bazë dhe ndihmëse, në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj, në përputhje me syllabuset e lëndëve, të cilat garantojnë marrjen e njohurive të parashikuara në programin e studimit. Pedagogët e lëndëve kujdesen të përgatisin materiale mësimore të përditësuara në gjuhën shqipe, të cilat vihen në dispozicion të studentëve.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.4**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e | UPT disponon bazën e të dhënave, që përmban informacion mbi studentët të tilla, si: gjeneralitetet, datëlindja, programi i studimit që ndjekin, viti i studimit, shkolla e mesme nga kanë ardhur, notat e fituara përgjatë ciklit të studimeve, kontaktet, datën e regjistrimit në universitet, datë çrregjistrimi dhe transferimi (për ata që ndërpresin studimet ose që transferohen nga IAL të tjera), |

| | |
|---|---|
| tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. | datën e diplomimit etj. Këtë bazë të dhënash e plotësojnë, përditësojnë dhe e disponojnë sekretaritë mësimore të secilit Fakultet dhe Sektori i IT dhe e vënë në dispozicion të organeve drejtuese me kërkesë të tyre *[Ref_085 Aksesi në sekretarinë online nga studentët]*.<br><br>Nga vizita e GVJ ne Sekretarine mesiore, u kontrollua dokumentacioni perkates dhe disa praktika, ku rezultoj qe zbatoheshin me korrektesi kerkesat e rregullores se brendshme te Fakultetit te Inxhinierise Elektrike *[Ref_008 Rregullore Njësi Kryesore FIE neni 35, neni 36]*.Sekretaria mësimore e fakultetetit i plotësonte këto regjistra në formë fizike dhe elektronike konforme rregullores se brendshme *[Ref_055 Referencë Model Regjistri Hard Copy dhe Elektronikisht nga Sistemi i Sekretarisë Mësimore]*.<br><br>Nga sekretaria per menaxhimin dixhital te dokumentacionit (procesverbale detyrimesh, procesverbale provimi, vertetime studentesh etj) perdorej sistemi SEKRETAR *[Ref_055 Referencë Model Regjistri Hard Copy dhe Elektronikisht nga Sistemi i Sekretarisë Mësimore]*, *[Ref_099 Shembull i dosjes së studentit nga sekretaria mësimore]*. |
| **Kriteri 2.** Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. | Nga vizita e GVJ ne Drejtorine e Burimeve njerezore konfirmohet se UPT dhe FIE administrojne informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe te gjithe personave të angazhuar në realizimin e programit konforme statutit te UPT dhe rregulloreve te brendeshme te FIE duke zbatuar kerkesat e Kodit te Etikes. Komunikimi shkresor zyrtar, në Universitetin Politeknik të Tiranës dhe administrimi i dokumentacionit bëhet nga Sektori i Arkivit dhe Protokollit në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Juridike sipas përcaktimeve në legjislacionin përkatës në fuqi *[Ref_001 Statuti i UPT]; [Ref_006 Kodi i Etikës i UPT]; [Ref_008 Rregullore Njësi Kryesore FIE]*. |
| **Kriteri 3.** Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. | Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në Elektroenergjetike. *[Ref_118 Udhëzues për përdorimin e teknologjisë së informacionit]*.<br><br>Nga takimi qe beri GVJ me studentët, na u konfirmua qe ata |

| | |
|---|---|
| | informoheshin në çdo kohë pranë sekretarise mesimore dhe kishin akses per të marre të gjithë informacionin e kërkuar dhe të dedikuar ne platformen bit-albania.com *[Ref_085 Aksesi në sekretarinë online nga studentët]*. |
| **Kriteri 4.** Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. | Në funksion të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit studentët dhe pedagogët janë të paisur me adresa emaili zyrtare të formatit *emer.mbiemer@fie.edu.al*, por përdorin edhe platforma të tjera komunikimi elektronik si Platforma bit-albania.com qe mundeson anketimin studentor dy tre jave para sezonit te provimeve dhe punon 100% e sinkronizuar me sistemin SEKRETAR.<br><br>Sistemi SEKRETAR ofron mundësinë e zhvillimit të provimit me tezë të personalizur, kjo procedurë nuk është zyrtarizuar por është në fazën e testimit. Komunikimi interaktiv ndërmjet personelit dhe studentëve realizohet duke përdorur platformën e Microsoft Teams, duke krijuar klasat virtuale për çdo klasë fizike *[Ref_083 Udhëzues dhe manual për zhvillimin e mësimit në distancë]*. |
| **Kriteri 5.** Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. | Sistemi i menaxhimit (bit-albania.com) garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese *[Ref_085 Aksesi në sekretarinë online nga studentët]*. |
| **Kriteri 6.** Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe. | UPT disponon një faqe web në dy gjuhë: shqip dhe anglisht. Në web publikohet çdo informacion i mundshëm mbi institucionin, informacion mbi organizimin akademik dhe administrativ, informacion mbi fakultetet, ciklet e studimit, programet e studimit dhe stafin akademik për çdo njësi, informacion mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore, programet e shkëmbimeve studentore Erasmus+, aktivitetet e ndryshme dhe të shumta që zhvillohen në UP përgjatë gjithë vitit, si dhe shërbimet e ofruara për studentët *(https://www.upt.al/fakultete-dhe-institute)*, *(http://fie.upt.al/master.php/)*; *[Ref_080 Afishimi në web i orareve mësimore]*; *[Ref_120 Shembuj njoftime në web nga departamenti DSEF]*. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Konkluzione** | *UPT disponon një faqe web-i në dy gjuhë: shqip dhe anglisht. Në web publikohet çdo informacion i mundshëm mbi institucionin.*<br><br>*Komunikimi interaktiv ndërmjet personelit dhe studentëve realizohet duke përdorur platformat bit-albania.com, Microsoft Teams.*<br><br>*Nga sekretaria e FIE per menaxhimin dixhital te dokumentacionit (procesverbale detyrimesh, procesverbale provimi, vertetime studentesh etj) perdoret sistemi SEKRETAR.*<br><br>*UPT, FIE nuk disponon platformën ESSE3 e ofruar nga RASH, përmes të cilës administrohen të dhënat e studentëve, stafit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ.*<br><br>*GVJ e vlerëson si jo produktiv sistemin "SEKRETAR", mbasi në procesin e vlerësimit të studentit, në inputet e vlerësimit të Laboratorëve dhe Detyrave të kursit ka vlerësim taksativ "Fiton" nuk "Fiton" (nga vëzhgimi i Pv në sekretarinë mësimore) dhe jo me pikëzim. Për sa më sipër rekomandojmë që FIE, të kalojë sa më shpejtë në platformën ESSE3 (PITAGORA) e ofruar dhe asistuar nga RASH, përmes së cilës të administrohen të dhënat dhe rezultatet e studentëve në procesin mësimor.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.5**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për | UPT harton çdo vit, Referuar Ligjit per Arsimin e larte 80/2015 dhe specifikisht VKM nr. 638 dt 22.07.2015 (i ndryshuar), dhe miraton tarifat e shkollimit për çdo cikël studimi, harton raporte financiare, që përmbajnë një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera.<br><br>Ne faqen web të institucionit mund të evidentohen tarifat e |

| | |
|---|---|
| mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. | miratuara studentore te regjistrimit dhe kalimit në vitet pasardhese *(https://www.upt.al/keshilli-i-administrimit).*<br><br>*[Ref_039 Evidencë mbi hartimin e Buxhetit në nivel njësie kryesore-bazë];[Ref_038 Projekti Buxheti Afatmesëm]; [Ref_087 Planifikimi i buxhetit në nivel Departamenti-DSEF].* |
| **Kriteri 2.** Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë. | Plani i financimit të programit të studimit me karakter profesional në "Master Profesional ne Elektroenergjitike", përmban financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shërbimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës, aksesi në bibliotekat online dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij *[Ref_011 Plani Strategjik 2020-2024 i FIE] i cili eshte pjese integrale e planit strategjik te UPT].*<br><br>Universiteti Politeknik i Tiranes nuk harton një plan financiar të dedikuar një programi studimi specifik, por ky plan vjen si pjesë integrale e planit financiar të njesise kryesore *[Ref_010 Plani Strategjik 2019-2024 i UPT].*<br><br>. |
| **Kriteri 3.** Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. | Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. UPT e kryen veprimtarinë dhe harton raporte financiare bazuar në:<br><br>• Ligjin "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe zbaton të gjitha detyrimet që lindin prej tij;<br><br>• Ligjit Nr. 9720, datë 23.04.2007 "Për auditin e brendshëm në sektorin publik" dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;<br><br>• Ligjin Nr. 9228 datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" të ndryshuar dhe Udhëzimin Nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"; |

| | |
|---|---|
| | Pasqyrat financiare të hartuara janë objekt i analizës në Senatin Akademik të Universitetit Politeknik të Tiranës dhe Bordit te Administrimit të UPT-së *[Ref_038 Projekti Buxheti Afatmesëm; Ref_039 Evidencë mbi hartimin e Buxhetit në nivel njësie kryesore-bazë.; Ref_078 Tabela e të ardhurave dhe investimeve; Ref_105 Pasqyre e buxhetit te realizuar UPT]*.<br><br>Në faqen web zyrtare të UPT janë të publikuara të dhënat mbi aktivitetin financiar të UPT *[www.upt.al/rreth-nesh/programi-i-transparences]* dhe në portalin U-Transparenca *[https://u-transparenca.al/]*<br><br>UPT i nënshtrohet çdo vit një auditi të brendshëm, të kryer nga njësia e auditimit të brendshëm dhe të drejtuar nga Bordi i Administrimit. Të dhënat mbi veprimtarisë financiare prokurimet dhe buxhetet, bëhet publike përmes programit të transparencës në faqen zyrtare të UPT, përmes lidhjes *[http://www.upt.al/rrethnesh/programi-i-transparences] dhe në portalin [https://u-transparenca.al/].[Ref_002 Organigrama e UPT]; [Ref_001 Statuti i UPT]*. |
| **Kriteri 4.** Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. | Referuar dokumentacionit të paraqitur GVJ konstaton se UPT ka të ngritur Drejtorinë Ekonomike e cila është përgjegjëse për planifikimin dhe hartimin e buxhetit vjetor, buxhetit afatmesës dhe ndjekjen e te gjithë procedurave të prokurimeve në lidhje me blerjen e pajisjeve dhe elementëvë të rëndësishëm në procesin mësimor. Drejtoria ekonomike zhvillon veprimtarinë e saj bazuar në Statut të UPT-së dhe në rregulloren e evcantë të saj. GVJ konstaton një transparencë në lidhje me realzimin e buxhetit të miratuar për vitin paraardhës. GVJ konstaton produkte si raportet financiare të cilat u vihen në dispozicion njësive kryesore dhe bazë dhe publikut përmes pasqyrimit të tyre ne website të UPT-së.<br><br>Institucioni raporton në njësinë kryesore dhe njësinë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës *(https://upt.al/dega-finance); [Ref_038 Projekti Buxheti Afatmesëm]*. |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet | Institucioni dëshmon qëndrueshmëri financiare për zhvillimin e programit të studimit dhe kapacitete financiare të mjaftueshme për gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme për vijueshmërinë e tij në të ardhmen, duke evidentuar një gjendje luhatjeje rreth një pike ekuilibri. |

| | |
|---|---|
| financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve. | Institucioni dhe vetë programi i studimit paraqet qëndrueshmëri financiare. Drejtoria Ekonomike ndjek zbatimin e të gjitha procedurave financiare të lidhura me planifikimin dhe realizimin e buxhetit në UPT. Evidencat e paraqitura nga institucioni japin treguesit financiar për vitin 2021. Referuar të dhënave të paraqiura nga institucioni konstatojme si vijon më poshte;<br>a. Rritje te buxhetit vjetor në masën 8-10%;<br>b. Realzim të buxhetit në maswn 96% nga ana e FIE-së për vitin 2021;<br>c. 53% e te ardhurave gjenerohen nga tarifa e shkollimit;<br>Dokumentacioni dhe takimet e kryera garantojnë stabilitetin financiar të këtij program studimi ndonëse në raportet financiare nuk jepet qartë pesha financiare e këtij programi studimi.<br>*[Ref_105 Pasqyre e buxhetit te realizuar UPT]* |
| **Konkluzione** | *UPT dëshmon qëndrueshmëri financiare për zhvillimin e programit të studimit "Master Profesional ne Elektroenergjitike" dhe kapacitete financiare të mjaftueshme për gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme për vijueshmërinë e tij në të ardhmen.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| **Standardi V.1** |
|---|
| **Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.** |

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. | Institucioni zbaton politika dhe procedura, të cilat garantojnë të drejta të barabarta, për të gjithë kandidatët për studentë, duke mundësuar ndjekjen korrekte të kandidatit që nga momenti i aplikimit, më pas regjistrimit dhe deri në përmbylljen e detyrimeve akademike dhe diplomimin e tij, e shprehur kjo ne statutin e UPT-se, kreu V dhe VI *[Ref_037 Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies e UPT]*, e cila i dedikohet tërësisht zhvillimit dhe menaxhimit të programeve të studimit dhe të procesit mësimor nga hyrja deri në dalje (diplomim) *[Ref_013 Raport i aktivitetit mësimor në nivel njësi kryesore FIE], [Ref_014 Raport i aktivitetit mësimor në nivel njësi bazë DSEF_FIE].* |
| **Kriteri 2.** Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. | GVJ konstaton se procedurat e hartimit dhe miratimit të kritereve specifike për pranimin e studentëve në këtë program studimi janë të mirëpërcaktuara në aktet rregullatore institucionale të UPT *[Ref_001 Statuti i UPT]. Kriteret e pranimit vendosen bazuar në kapacitete pritësë të institucionit të cilat verifikohen çdo vit nga MASR [Ref_063 Kuotat e pranimit 2022-2023 DSEF; Ref_063 Kuotat e pranimit ne MP 2022-2023-DSEF], [Ref_064 Raportet për kapacitetet pritëse në FIE_DSEF].*<br><br>Kriteret e pranimit diskutohen cdo vit në njësinë baze dhe më pas vijon me miratimet në njësinë kryeore dhe në Senatin Akademik. GVJ konstaton një procedurë të diskutimit në lidhje me kriteret e pranimit për këtë program studimi. Cdo student qe regjistrohet në Master Profesional në Inxhinieri Elektroenergjitike, mbështetet në formimin Bachelor në Inxhinieri Elektrike me notë mesatare jo më pak se 7 (shtatë). GVJ konstaton se institucioni ka zbatuar kriteret e përcaktuara në nenin 76/4 dhe nenin 76/5 të Ligjit Nr. 80/2015. Institucioni garanton të drejta të barabarta për çdo student që plotëson kriteret e pranimit duke pranuar cdo student nga programe të tjera studimi në Inxhinieri Elektrike ekuivalente të Institucioneve të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit por të akredituara *[Ref_062 Miratimi i kritereve të pranimit në MP Elektroenergjitike]*. GVJ konstaton zbatimin me rigorozitet të procedurave që garantojnë barazinë në çdo student. Procedura dhe kriteret specifike bëhen publike sipas akteve rregullatore të hartuara nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe të miratuara |

| | |
|---|---|
| | në njësinë bazë, atë kryesore dhe në Senatin Akademik të Universitetit Politeknik të Tiranës *[Ref_062 Miratimi i kritereve të pranimit në MP Elektroenergjitike]*. |
| **Kriteri 3.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. | Departamenti i DSEF, përgjegjës për programin e studimit, për çdo vit akademik përcakton për programin "Master Profesional ne Elektroenergjitike", kuotat dhe kriteret e pranimit dhe të përzgjedhjes së aplikantëve fitues, të cilat miratohen nga Dekanati, deri ne Senatin Akademik *[Ref_062 Miratimi i kritereve të pranimit në UPT], [Ref_063 Kuotat e pranimit 2022-2023-MP]*.<br><br>Pranë FIE-së për rastin e PS Master Profesional ne Elektroenergjetike ngrihet në fillim të çdo viti akademik një komision *ad-hoc* për ekuivalentimin dhe njohjen e lëndëve/krediteve *[Ref_073 Këshillat e Programeve të Studimit dhe Kordinatorët], [Ref_114 Procedurë mbi zgjedhjen e drejtuesve të grupeve mësimore/kërkimore shkencore]*. Ky komision shqyrton dokumentacionin e studentit dhe kryen ekuivalentimet përkatëse *[Ref_067 Praktike transferim studimesh ]*.<br><br>Kriteret vendosen mbështetur në një analizë të kushteve konkrete në të cilën veprohet, duke synuar të tërhiqen kandidatët me rezultate më të larta *[Ref_037 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhenies ne UPT, Neni 19, Neni 20]*. |
| **Kriteri 4.** Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. | Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, janë të shprehura qartë në rregulloren e Departamentit dhe të programit të studimit dhe publikohen në faqen elektronike të Fakultetit. *[Ref_062 Miratimi i kritereve të pranimit në UPT], [Ref_063 Kuotat e pranimit 2022-2023-MP]*.<br><br>Në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular të UPT jepen qarte kriteret e përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku, *[Ref_037 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhenies ne UPT]*.<br><br>Studentët mund informohen për vijushmërinë e studimeve të tyre dhe rezultatet e provimeve përmes aksesimit të faqeve të tyre personale në *online* "Sekretar". |

<table>
<tr>
<td></td>
<td>
<table>
<tr><th>Sipas viteve akademike</th><th>Të regjistruar për herë të parë</th><th>Të transferuar</th><th>Të larguar</th><th>Ndërprerë studimet</th><th>Totali</th></tr>
<tr><td>2020-2021</td><td>40</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>40</td></tr>
<tr><td>2021-2022</td><td>32</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>32</td></tr>
<tr><td>2022-2023</td><td>24</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>24</td></tr>
<tr><td>Total</td><td colspan="5">96</td></tr>
</table>
</td>
</tr>
<tr>
<td>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</td>
<td>
GVJ evidenton që kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë të pasqyruara në dokumentet bazë institucionale [Ref_001 Statuti i UPT; Ref_008 Rregullore Njësi Kryesore FIE; Ref_009 Rregullore Njësi Bazë DSEF_FIE; Ref_037 Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies e UPT; Ref_074 Guida Program Studimi (programet e shkurtuara) MP Elektroenergjetikë DSEF;]
Në takimet e zhvilluar në institucion u theksua njohja nga ana e studenteve të procesit mësimor, të drejtave dhe detyrimeve të tyre. Ky informacion transmetohet si nga pedagogët kujdestar të përcaktuar por edhe nga stafi akademik [vizitë në institucion].
Sensibilizimi bëhet edhe përmes:
<ul>
<li>Portaleve [https://ualbania.al/], [www.upt.al] dhe [www.fie.edu.al]. për të gjitha programet e studimit të ofruara në UPT dhe FTI. Në faqen e web-it sutdentët mund të gjejnë informacion për rregulloren e programit të studimit, planet mësimore ose për procedurat për transferimin e studimeve [Ref_043 Informimi i studentëve nëpërmjet platformave online].</li>
<li>“Ditët informuese” ku stafi akademik i Universitetit Politeknik të Tiranës mundëson informimin e studentëve potencial jo vetëm për kriteret dhe procedurat e pranimit, por edhe për ofertën iformative të UPT, mundësitë e punësimit përnstudentët e diplomuar në UPT [Ref_061 Aktivitete informuese mbi programet e studimit].</li>
<li>Guidës studentore e hartuar në nivel institucional së</li>
</ul>
</td>
</tr>
</table>

| | |
|---|---|
| | bashku me një broshurë përmbledhëse *[Ref_021 Guida Studentore; Ref_060 Broshura informuese,guida për studentët]*.<br><br>Institucioni, gjithashtu, vë në dispozicion të kandidatëve për student dhe studentëve të regjistruar të gjithë informacionin e nevojshëm në çdo kohë që ajo kërkohet me të gjithë administratën. |
| **Kriteri 6.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të margjinalizuara. | Institucioni gjithashtu ka hartuar një rregullore për krijimin e kushteve të përshtatshme në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies për studentët me aftësi të veçanta të pakicave dhe shtresave të margjinalizuara në programet e studimit që ofron.<br><br>*[Ref_062 Miratimi i kritereve të pranimit në MP], [Ref_063 Kuotat e pranimit 2022-2023-MP_DSEF]*. |
| **Kriteri 7.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. | UPT nëpërmjet organeve te brendëshme përcakton kriteret specifike dhe ato të përgjithshme, duke i përshtatur sipas akteve nënligjore të Ministrisë se Arsimit dhe Sportit në përputhje edhe me kriteret e maturës shtetërore. Midis të tjerash përcaktohen edhe procedurat dhe kuotat për regjistrimin e studenteve të huaj apo ata te ardhur nga trevat shqiptare jashtë vendit.<br>Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera, kryesisht nga trevat shqipfolese. Kriteret e pranimit hartohen dhe bëhen publike një vit përpara se ato të hyjnë në fuqi dhe shpallen nga UPT në website e tij. Kriteret për përzgjedhjen e studentëve hartohen nga departamenti, miratohen në dekanat dhe më pas në SAUPT, *[Ref_062 Miratimi i kritereve të pranimit në MP], [Ref_063 Kuotat e pranimit 2022-2023-MP_DSEF]*. |
| **Kriteri 8.** Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit. | Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresat në nevojë dhe për përfshirjen e studentëve në programet prioritare në përputhje me VKM Nr. 386, datë 01.06.2022. GVJ u njoh me praktike të dhënies së bursës dhe të dhëna statistikore në lidhje me numrin e përfituesve në programin e studimit Energjitikë ndonëse për këtë program studimi nuk ofrohet bursë *[Ref_092 Praktikë e dhënies së bursave];[Ref_101 Të dhëna mbi studentët e trajtuar financiarisht]*. |
| **Konkluzione** | *Institucioni zbaton politika dhe procedura, të cilat garantojnë të drejta të barabarta për të gjithë kandidatët për studentë, vendas dhe të huaj, duke mundësuar ndjekjen korrekte të kandidatit, që* |

| | |
|---|---|
| | *nga momenti i aplikimit, më pas regjistrimit dhe deri në përmbylljen e detyrimeve akademike dhe diplomimin e tij.*<br><br>*Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, janë të shprehura qartë në aktet rregullatore të Institucionit. Institucioni ka hartuar një rregullore për krijimin e kushteve të përshtatshme në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies për studentët me aftësi të veçanta në programet e studimit që ofron.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.2**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. | Gjatë takimit me studentët dhe stafin akademik GVJ konstatoi se DSEF/FIE ju vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Mënyrat e marrjes së informacionit nga studentët janë disa:<br><br>• Faqet zyrtare të internetit ku studentët mund të aksesojnë rregulloret. *[www.upt.al], [www.fie.edu.al].*<br>• Sekretaria mësimore dhe zyra e finances;<br>• Pedagogët kujdestar të cikleve të studimit dhe çdo staf akademik i angazhura në këtë program mësimi i informon studentët për kriteret e përparimit akademik për lëndët që mbulon.<br>• Stafi akademik i cili mban kontakte të vazhdueshme me stundentët dhe informon në lidhje me progresin e tyre *[takim me stafin akademik].*<br><br>Nga takimi me studentet studentët e regjistruar pranë këtij |

| | |
|---|---|
| | programi studimi, GVJ u informua se, ata ishin njohur që në seancat e para të leksioneve, në takimet me koordinatorin e programit të studimit dhe përgjegjësin e grupit të tyre mësimor mbi kriteret dhe procedurat e përparimit të tyre akademik. Shembuj u sollën nga takimi me ta në lidhje me punën e bere nga pedagoget gjatë zhvillimit të lëndës, vështirësitë dhe ndihma e ofruar nga stafi akademik pwr tw sqaruar cdo ceshtje, vlerësime në lidhje me përgatitjen e detyrave të kursit/projektit të kursit, provimi final dhe përgatitja e temës së diplomës. *(http://upt.al/kushtet-e-kalimit-ne-vitin-pasardhes), (https://upt.Bit-Albania.rash.al/login), dhe (https://bit-albania.com/upt6.php),*<br><br>*[Ref_115 Rregullore e zyrës/njësisë së këshillimit dhe karrierës],[Ref_112 Raporti i aktiviteteve të zyrës/njësisë së këshillimi të karrierës], [Ref_021 Guida studentore].*<br><br>Që në fillim të vitit akademik studentët njihen me të drejtat dhe detyrimet e tyre. Për çdo lëndë stafi akademik vë ne dispozicion të studentit syllabuset ku jepet qartë përmbajtja e lëndës dhe detyrimet përkatëse që studenti duhet të plotësojë. Sekretaria mësimore vë në dispozicion të studentëve duke ofruar shërbim në lidhje me regjistrimin, paraqitjen e notave dhe ndihmën për dokumentacionin që studenti duhet të paraqesë që në momentin e pranimit të tij në këtë program studimi. Ajo mirë administron edhe proçes verbalet e paraqitura nga stafi akademik për çdo provim të kryer. Platforma elektronike mundëson edhe një akses të studentëve në lidhje me rezultatet e provimeve, procedurat e regjistrimit të tyre në provime. Progresi i studentëve mbështetet nga DSEF dhe nga Këshilltari i Programit i ngritur në këtë departamet. GVJ konstatoi zhvillimin e një praktike të drejtë të tij në këtë i cili u pranua si efektiv edhe nga vetë studentët gjatë takimit të zhvilluar *[takime ne institucion].* |
| **Kriteri 2.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. | UPT ofron mundësinë për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve, midis programeve të të njëjtit cikël studimi brenda institucionit apo institucione të tjera. GVJ gjeti pasqyrimin e akteve rregullatore për transferimet, njohjen e krediteve dhe ekuivalentimi e lëndëve *në kreun VI në rregulloren* përkatëse të Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies. *[Ref_037 Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies e UPT].*<br><br>Në rastet e transferimit të studimeve, dosja e kandidatit |

| | |
|---|---|
| | shqyrtohet nga një komision *ad hoc* i ngritur me urdhër të dekanit, në përputhje me rregulloren e programit të studimit. *[Ref_037 Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies e UPT, Kreu VI]*.<br><br>Këto kritere dhe procedura janë publike dhe të aksesuseshme nga studentët, në faqen web të UPT *(http://upt.al/transferime)* si dhe në faqen web të FIE *(https://fie.edu.al/info/regjistrimetransferime)*.<br>Informacioni jepej edhe nga strukturat e tjera të FIE si: Zv. Dekani për anën mësimore, Sekretaria Mësimore, Zyra e Karrierës, etj. Informacion më të gjerë dhe të larmishme studentët gjejnë dhe në Guidën studentore *[Ref_021 Guida studentore]*. |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. | GVJ konstatoi në vizitën e kryer që studentët ishin të mirë informuar në lidhje me mënyrën e vlerësimit të dijeve të lëndëve në fillim të çdo lënde apo moduli nga pedagogu përkatës ku paraqit edhe planin mësimor të lëndëve përkatëse.<br><br>Gjatë javës së parë të mësimit, në fillim të vitit akademik, studentët njihen me rregulloren e programit të studimit dhe syllabuset e lëndëve, ku ndër të tjera janë përcaktuar kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve, *(http://upt.al/sesionet-e-provimeve), [Ref_044 Dokumentacion i vlerësimit të studentëve në provime dhe provim diplome], [Ref_074 Guida Program Studimi (programet e shkurtuara) MP Elektroenergjetikë DSEF], [Ref_085 Aksesi në sekretarinë online nga studentët]*.<br><br>UPT ka përcaktuar qartë format e vlerësimit të dijeve dhe aftësisë së studentit në dokumenta bazë institucioale. Rregullorja e UPT-se përcakton edhe format e vlerësimit të studentit. Në fillim të çdo semestri akademik studenti informohet në lidhje me kriteret e vlerësimit të tij të cilat janë të shprehur edhe në syllabuse. Nga takimi me studentët u konstatua informimi i tyre në lidhje me provimet e pjesshme, detyrën/projektin e kursit dhe provimin final. Vlerësimi i dijeve është i përcaktuar qartë dhe në çdo syllabus të programit të studimit. Format dhe kriteret e vlerësimit të studentëve përcaktohen në programin e lëndës dhe u bëhen të ditur studentëve. Vlerësimi në një lënde kryhet si vijon më poshtë :<br><br>1. Pjesëmarrje: 10% ;<br>2. Përnbushja e detyrimeve si laboratorë, detyrë kursi, |

| | |
|---|---|
| | projekte kursi: 40%<br>3. Teste vjetore : 20% ;<br>4. Provimi përfundimtar: 30% ;<br><br>Studenti ka të drejtën e ankimit për rezultatin përfundimtar të provimit brenda afatit te percaktuar ne rregulloren e institucionit. Në takimin me studentët GVJ konstaton njohjen nga ana e tyre e procesit të ankimimit, por shembuj nuk u sollën në këtë drejtim *[takim me studentet]*. |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. | Në rregulloren e programit të studimit "Master Profesional ne Elektroenergjetike, përcaktohet procedura për zhvillimin e provimit të formimit/mbrojtjes së diplomës. Në bazë të kriterit të notës mesatare dhe/ose kritere të tjera, studenti ka të drejtë të diplomohet për të fituar titullin përkatës me mbrojtjen e një teze diplome ose me provim të përgjithshëm përfundimtar formimi. Departamenti (DSEF) informon studentët përmes stafit të tij, faqes së internetit, apo edhe takime me studentët, *[Ref_037 Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies e UPT, Kreu VIII]*.<br><br>GVJ u informua se realizimi i temës së diplomës përbën një element shumë të rëndësishëm në procesin e diplomimit në programin e studimit MP në "Elektroenergjitike". Në planin mësimor temës së diplomës i janë rezervuar 18 ECTS. Për realizimin e Temës së Diplomës studentët bazohen në rregulloret perkatese. Kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit u bëhen të njohura studentëve që në ne fillim te semetrit te dyte te viti te dyte. Një fokus i veçantë i jepet mënyrës së hartimit të temës së diplomës kontrolli nga plagjatarizimi, citimi dhe referencat dhe përmbajtja shkencore dhe e argumentuar *[takim me stafi akademik]*. Të gjithë studentët i nënshtrohen punimit dhe mbrojtjes së diplomës. |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e | UPT nepermjet Drejtorise se Komunikimit dhe Koordinimit si njësi strukturore mbështetëse, kujdeset në informimin e vazhdueshëm të studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit dhe mundësitë që lidhen me të, duke planifikuar dhe organizuar veprimtaritë në fushën e bashkëpunimit me palët e interesuara, të marrëveshjeve dhe projekteve të përbashkëta, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. DSEF ndjek një politikë sensibilizimi dhe informimi në lidhje me programin e studimit MP në "Elektroenergjtike". Zyra e Këshillimit të Karrierës ne |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| studimit. | bashkepunim me stafin akademik zhvillojnë takime informuese me maturantët e shkollave të mesme. Materiale promovuese përdoren gjeresisisht për informim të publikut. Takime zhvillohen edhe “Panairin e Karrieres” për informim në lidhje me programin mësimor dhe përmbajtjen e tij. Informacion i gjere gjendet edhe në website duke i shërbyer informimit të publikut të gjerë<br><br>*[Ref_120 Shembuj njoftime në web nga departamenti DSEF];[Ref_061Aktivitete informuese mbi programet e studimit]; [Ref_112 Raporti i aktiviteteve të zyrës/njësisë së këshillimi të karrierës].* | | | |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se studentët e regjistruar pranë këtij programi studimi, njihen gjatë javës orientuese dhe në seancat e para të leksioneve me kriteret dhe procedurat e përparimit të tyre akademik, me procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit dhe informacione të tjera të rëndësishme për mbarëvatjen e studimeve të tyre.*<br><br>*Institucioni kujdeset në informimin e vazhdueshëm të studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit dhe mundësitë që lidhen me të.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi V.3**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. | Struktura, organizimi dhe kohëzgjatja e programit të studimit në Master Profesional ne Elektroenergjitikë janë qartësisht të përcaktuara në Rregulloren e programit të studimit, *[Ref_074 Guida Program Studimi (programet e shkurtuara) MP Elektroenergjetikë DSEF]*.<br><br>Studentët e regjistruar pranë këtij programi studimi, njihen që në seancat e para të leksioneve, në takimet me koordinatorin e |

| | |
|---|---|
| | programit të studimit dhe përgjegjësin e grupit të tyre mësimor mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. Gjatë gjithë periudhës së studimeve studentit i jepet mundësia të komunikojë me pedagogun, jo vetëm në auditor por edhe nëpërmjet postës elektronike *(emer.mbiemer@fie.edu.al)*. |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. | Ne fillim te semestrit secili pedagog që jep mësim në Inxhinieri Elektrike profili Energjitikë bën publik informacionin mbi modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese, informacion ky që pasqyrohet edhe në syllabusin e lëndës, *[Ref_018 Planet dhe programet mësimore], [Ref_074 Guida Program Studimi (programet e shkurtuara) MP Elektroenergjetikë DSEF]*.<br><br>Në kuadër të praktikës profesionale, DSEF vë në dispozicion të studentëve Udhëzuesin e Praktikës Profesionale. Për çdo informacion studentët mund të kontaktojnë direkt ose përmes emailit me: pedagogët kudestarë, Sekretarinë Mësimore, Drejtuesit e departamenteve, Zv. Dekanin, etj.*[Ref_080 Afishimi në web i orareve mësimore]* |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës. | Nga dokumentat e dorëzuara dhe nga vizita në institucion GVJ konstaton se studentët e regjistruar në MP në "Elektroenergjitike" informohen në mënyrë të vazhduar rreth mundësive të punësimit që ofrohen dhe tregut të punës. Disa nga mënyrat e informimit janë:<br><br>• Faqja web institucionale www.upt.al *[Ref_043 Informimi i studentëve nëpërmjet platformave online]*<br><br>• Aktivitetet informuese/trajnuese që organizohen për të rritur aftësitë dhe njohuritë e tyre rreth tregut të punës *[Ref_093 Informim i studenteve per programin e studimit MP]*.<br><br>• Panairin e punës. Në mënyrë të përvitshme, Universiteti Politeknik i Tiranës, me përfaqësues nga të gjitha njësitë kryesore, merr pjesë në panairin e punës ku kompani të ndryshme marrin pjesë duke paraqitur ofertën e tyre të punësimit për studenët.<br><br>• Njësia Qendrore e Sigurimit të Cilësisë (NJSBC) e FIE me anë të komunikimeve ballë për ballë, postës elektronike, rrjeteve sociale të FIE i informon studentët |

| | |
|---|---|
| | për mundësitë e punësimit. *[Shënime në vizitë]*<br>• GVJ u njoh me iniciativa të stafit akademik të cilët në kuadër të hartimit të një studimi kanë ndërmarrë edhe sondazhe më specifike në lidhje me studentët e diplomuar, mendimin kritik të tyre për përmbajtjen e programit, aftësimin e tyre në përfundim të studimeve, fushën e punësimit të tyre *[Shënime në vizitë]*.<br>*[Ref_019 Marrëveshjet Institucionale ]; [Ref_020 Marrëveshjet me industrinë]*.<br>Institucioni përmes Drejtorise të Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës dhe Departamentit informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe i mbështet në hartimin e dokumentacionit të nevojshëm (CV, letër motivimi, letër rekomandimi etj.) përmes aktiviteteve këshilluese të organizuara në mënyrë periodike. |
| **Kriteri 4.** Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. | GVJ konstatoi se DSEF mundëson një shpërndarje të informacionit në shumë drejtime gjatë gjithë karrierës universitare në mënyrë të vazhdueshme. Përmes punës së tij studentët informohen në lidhje me të drejtat, detyrat dhe udhëzimet informuese për procesin mësimor. Informacioni shpërndahet edhe përmes:<br>• Pedagogët në fillim të çdo lënde/moduli, paraqesin plan-programet e lëndëve *[Ref_074 Guida Program Studimi (programet e shkurtuara) MP Elektroenergjetikë DSEF]*.<br>• Posta elektronike @fie.edu.al" ose Platforma Microsoft Teams ku studentët marrin njoftime rreth zhvillimit të laboratorëve, zëvendësimeve të orëve mësimore etj.<br>• Portali online i skretarisë ku studentët informohen rreth vlerësimit në lëndët e programit të studimit që ndjekin. *[Ref_055 Referencë Model Regjistri Hard Copy dhe Elektronikisht nga Sistemi i Sekretarisë Mësimore; Ref_085 Aksesi në sekretarinë online nga studentët]*.<br>• Në faqen web të Universitetit Politeknik të Tiranës *[www.upt.al]* si dhe në atë të Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike *[www.fie.edu.al]* afishohen informacione të azhornuara rreth procesit mësimor, strukturës akademike, afateve dhe modaliteteve të procesit të diplomimit, të dhëna rreth trajnimeve të ndryshme apo mundësive për punësim, orari mësimor, ambientet dhe sallat e zhvillimit |

| | |
|---|---|
| | të aktiviteteve didaktike, informacione rreth bibliotekës dhe shërbimeve biliotekare etj. *[Ref. 60. Model njoftimi në faqen ueb të FIE-së;]*<br><br>Institucioni vë në dispozicion të studentëve në ambjentet e Universitetit dhe në faqen e saj *online*, të dhëna mbi orarin, aktivitete të ndryshme kurrikulare dhe ekstrakurrikulare, si dhe çdo informacion tjetër në funksion të mbarëvajtjes së procesit mësimor.<br><br>*[Ref_104 Tutorët e grupeve mësimore FIE-DSEF].* |
| **Kriteri 5.** Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë. | Nga takimet ne DSEF dhe specialistin e IT, GVJ u njoh nga afer me informacionin qe ju vihej ne dispozicion studentëve te programit të studimit Master Profesional në Elektroenergjetike përmes platformës së sekretarisë mësimore Bit-Albania e cila ofrohet me mbështetjen e Rrjetit Akademik Shqiptar *(https://bit-albania.com/upt6.php).*<br><br>Studentët janë pajisur në momentin e regjistrimit në programin e studimit me *"user name" dhe "passuord"*, per akses në platforma nga distanca. Në FIE, DSEF pedagoget dublojne informacioni mesimor online nëpërmjet platformës Microsoft TEAMS, *[Ref_124 Udhëzues për zhvillimin e mësimit në distancë].* |
| **Konkluzione** | *Studentët e regjistruar pranë këtij programi studimi, njihen që në seancat e para të leksioneve me strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.*<br><br>*Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe i mbështet dhe orienton përmes aktiviteteve këshilluese të organizuara në mënyrë periodike.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.4** | |
|---|---|
| **Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.** | |
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |

<table>
<tr>
<td>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</td>
<td>Informacioni mbi statistikat vjetore, për numrin e studentëve e të diplomuarve për programin e studimit të ciklit të dytë Master Profesional në Elektronergjetike menaxhohet nga Sekretaria Mësimore e FIE-së. Këto të dhëna ruhen në formë të shkruar (hard copy) dhe në formë elektronike në regjistrin e lëshimit të diplomave dhe çertifikatave sipas mënyrës së përcaktuar në udhëzimet përkatëse të MAS, [Ref_054 Informacion mbi Sektorin e Statistikës], [Ref_055 Referencë Model Regjistri Hard Copy dhe Elektronikisht nga Sistemi i Sekretarisë Mësimore].Ruajtja dhe përpunimi i këtyre të dhënave personale të studentëve kryhet bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.<br><br>[<u>http://www.pp.gov.al/web/ligj_mbrojtja_e_te_dhenave_personale_40.pdf</u>].<br><br>Statistikat vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për këtë program studimi pasqyrohen edhe në Raportin e përvitshëm të analizës vjetore të FIE-së, [Ref_016 Raport i aktivitetit mësimor në nivel njësi Bazë DSEF_FIE].<br><br>Bazuar nga të dhënat e marra në sekretarinë mësimore dhe në evidencat e paraqitur nga institucioni konkludojmë në lidhje me numrin e stundentëvë të diplomuar si vijon në tabelen më poshtë:<br><br>
<table>
<tr><th colspan="4">Periudha e të dhënave 2020-2023</th></tr>
<tr><th>Programi</th><th>Numri total I të diplomuarve</th><th>Numri total I të punësuarve në përputhje me diplomën</th><th>Numri total I të punësuarve jo në përputhje me diplomën</th></tr>
<tr><td>MP "Elektroenergjitike"</td><td>111</td><td>85</td><td>15</td></tr>
</table>
</td>
</tr>
<tr>
<td>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e</td>
<td>Informacioni lidhur me statistikat vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik, në të cilin zhvillohet programi i studimeve për ciklin e dytë Master</td>
</tr>
</table>

<table>
<tr>
<td>tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</td>
<td>Profesional në Elektroenergjetike menaxhohet nga Sekretaria mësimore e FIE-së,
<table>
<tr><th>Sipas viteve akademike</th><th>Të regjistruar për herë të parë</th><th>Të transferuar</th><th>Të larguar</th><th>Ndërprerë studimet</th><th>Tot ali</th></tr>
<tr><td>2020-2021</td><td>40</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>40</td></tr>
<tr><td>2021-2022</td><td>32</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>32</td></tr>
<tr><td>2022-2023</td><td>24</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>24</td></tr>
<tr><td>Total</td><td colspan="5">96</td></tr>
</table>
[Ref_055 Referencë Model Regjistri Hard Copy dhe Elektronikisht nga Sistemi i Sekretarisë Mësimore]. Këto të dhëna ruhen në formë të shkruar dhe në formë elektronike në regjistrin e lëshimit të diplomave dhe çertifikatave sipas mënyrës së përcaktuar nga udhëzimet e MAS.Statistikat vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për këtë program studimi, [Ref_017 Tabelat 1-24: Të dhënat tabelore për Departamentin e Sistemeve Elektrike të Fuqisë] dhe pasqyrohen edhe në Raportin e përvitshëm të analizës vjetore të FIE-së, [Ref_016 Raport i aktivitetit mësimor në nivel njësi Bazë DSEF_FIE].
UPT-ja, në nivel institucioni përmes Sektori i Statistikes dhe Informacionit, [Ref_002 Organigrama e UPT] disponon statistika vjetore për numrin e studentëve, [Ref_053 Numri i studentëve aktivë 2021-2022] dhe të të diplomuarve për çdo program studimi, për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve, të cilat raportohen në raportet vjetore të UPT-së . </td>
</tr>
<tr>
<td>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të</td>
<td>Të dhënat statistikore të studentëve të FIE menaxhohen në formë elektronike përmes sistemit të brendshëm të informacionit BIT-ALBANIA. Këto të dhëna janë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar, [Ref_085 Aksesi në sekretarinë online nga studentët], [Ref_118 Udhëzues për përdorimin e teknologjisë së informacionit].</td>
</tr>
</table>

| | |
|---|---|
| verifikueshme nga personat e autorizuar. | Ruajtja dhe përpunimi i këtyre të dhënave personale të studentëve kryhet bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale. |
| **Kriteri 4.** Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse. | Fakulteti Inxhinierisë Elektrike, në mbështetje të akteve ligjore procedurave të kontrollit në UPT ushtron kontrolle periodik për veprimtarinë dhe aktivitetin e sekretarisë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj., si dhe vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.<br><br>Fakulteti Inxhinierise Elektrike harton plane te veprimit vjetore për mirëfunksionimin e njësive. *[Ref_097 Auditim i sekretarise mesimore nga njësia kryesore]*. |
| **Kriteri 5.** Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. | DSEF në perfundim të vitit akademik harton raportet për ecurinë e procesit mësimor dhe kërkimor. Ky raport hartohet mbështetur në raportet individuale të pedagogëve ku pasqyrohet për secilën lëndë cilesia e pergatitjes së studenteve me indikatore si kalushmeria, frekuentimi, nota mesatare, etj.<br><br>*[Ref_014 Raporti i Aktivitetit Mesimore ne nivel njesia baze DSEF_FIE]; [Ref_077 Raportimi i Pedagogut për aktivitetin mësimor per vitin akademik- model raportimi]*.<br><br>Programi i studimeve Master Profesional në Elektroenergjetikë formon profesioniste si për tregun kombëtar dhe atë ndërkombëtar. FIE/DSEF rinovon marrveshjet me kompanitë publike dhe private në sektorin elektroenergjitik me qëllim prezantimin e të diplomuarve në keto kompani. *[Ref_020 Marrëveshjet me industrinë]*.<br><br>Njëkohesisht nga specialistet e karrierës konfirmohet ky trend konkurues i studentëve që perfundojnë këtë program studimi, *[Ref_054 Informacion mbi Sektorin e Statistikës]*.<br><br>Nga takimi ne DSEF dhe zyren e karrieres, GVJ mesoi se rreth 50 % e studenteve te vitit te dyte te ketij programi studimi jane punesuar me kohe te pjeseshme ne Istitucionet e praktikes profesionale pa perfunduar programin e studimeve, *[Ref_058* |

| | |
|---|---|
| | *Lista e zhvillimit te praktikes mesimore].* |
| **Konkluzione** | *Institucioni disponon Sistemin e Menaxhimit të të Dhënave të Studentëve, në të cilin ruhen dhe përditësohen të dhënat për studentët nga regjistrimi i tyre deri në diplomim. Drejtoria e Komunikimit (Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës) ndjek dhe ruan të dhënat mbi punësimin e të diplomuarve.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushe t kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.5**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit. | Statuti i UPT përcakton qartë në Nenin 49 përfshirjen e studentëve në jetën institucionalë, *[Ref_001 Statuti i UPT]*. Studentët kanë përfaqësuesit e tyre si anëtarë të Senatit Akademik të UPT, të cilët zgjidhen me votim të vetë studentëve. Në Senatin Akademik janë zgjedhur senator student të profilit energjitike. Studentët kanë përfaqësues në Këshillin e Etikës, në Këshillat e Programeve të Studimit, *[Ref_006 Kodi i Etikës i UPT]*, *[Ref_106 Këshilli Studentor FIE (Aktivitete)]*, *[Ref_107 Rregullore për Këshillin Studentor]*. Gjithashtu studentët kanë përfaqësuesit e tyre në komisionet e përhershme të Senatit Akademik të UPT.Studentët përfshihen në grupin e vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit si dhe të vlerësimit institucional, *[Ref_121 Miratim i grupit të vlerësimit në DSEF per programin e studimit Master Profesional ne Elektroenergjetike]*. |
| **Kriteri 2.** Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, | Nga takimi me studentet e profilit energjitikë u pohua nga vete ata, që nëpërmjet përfaqësuesëve të tyre në organet drejtuese të shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të UPT si: për planet mësimore dhe programet e studimeve, rregulloret e studimeve, apo çështje qe lidhen me jetën sociale studentore dhe aktivitetet shkencore. Studentët janë përfshirë gjithashtu në grupet e vlerësimit të |

| | |
|---|---|
| konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. | brendshëm të programeve të studimit si dhe të vlerësimit institucional, *[Ref_121 Miratim i grupit të vlerësimit në DSEF per programin e studimit Master Profesional ne Elektroenergjetike]*.<br><br>Përfshirja e studentëve në kërkimin shkencor ka mundësuar pjesëmarrjen e tyre në konferenca kombëtare e ndërkombëtare, *[Ref_094 Përfshirja e studentëve në veprimtari kërkimi]; [Ref_106 Këshilli Studentor (Aktivitete)];[Ref_107 Rregullore për Këshillin Studentor]*.<br><br>UPT mbështet këshillat e studentëve dhe financon veprimtarinë e tyre, *[Ref_108 Financimi i aktiviteteve studentore në UPT]*. |
| **Kriteri 3.** Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj. | FIE dhe DSEF garantojnë përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit, përmirësimit të kurrikulave nepermjet kontakteve me ta, në mënyrë të drejtëpërdrejtë, përmes koordinatorit dhe mentorëve të programit të studimit, si dhe në mënyrë të tërthortë, përmes pyetësorëve për vlerësimin e procesit mësimor. *[Ref_072 Pyetësori mbi permirsimet e programeve të studimit DSEF]*. |
| **Kriteri 4.** Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. | Studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit dhe vlerësimin. Ankesa i drejtohet me shkrim Drejtuesit të Njësisë Kryesore ku bën pjesë studenti, jo më vonë se 3 ditë kalendarike nga dita e publikimit të rezultateve. Institucioni ndjek procedurat e parashikuara në rregullore për zgjidhjen e problematikës sipas Neni 35 te Rregullores së Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies, i garanton studentit të drejtën të ankimohet, në rast se ndaj tij janë shkelur rregullat proceduriale gjatë zhvillimit të provimit ose nuk është dakord me vlerësimin e bërë, *[Ref_037 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhenies ne UPT]*.<br><br>Studentëve gjithashtu u mundësohet të japin mendim mbi ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve gjatë plotësimit të pyetësorëve në fund të semestrit për lëndët qe kane zhvilluar. |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se UPT, FIE, DSEF, kane ndertuar ura* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *bashkepunimi ku përfshihen dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre në përputhje me aktet ligjore në fuqi.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi V.6** | |
|---|---|
| **Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.** | |
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit. | Nga takimet ne istitucion me perfaqesues te Drejtorise se Kurrikulave dhe Drejtorise se Komunikimit dhe Koordinimit, GVJ kostaton se procedurat e ndjekura prej këtyre njësive në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve janë në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të vetë universitetit. *[Ref_002 Organigrama e UPT].*<br><br>Gjithashtu edhe në FIE është ngritur dhe funksionon Zyra e Karrierës dhe Alumnit, që informon dhe këshillon studentët përgjatë gjithë ciklit te studimeve të tyre, *[Ref_003 Organigrama e FIE & DSEF].*<br><br>GVJ konstatoi se DSEF zhvillon forma të larmishme në lidhje me sensibilizimin, informimin dhe mbështetjen ndaj studentëve. Format e informimit në mënyrë të përmbledhur janë:<br><br>• Broshura, fletepalosje;<br>• Informim nga stafi akademik në lidhje me lëndët e programit të studimit, përmbajtjen e tyre përmes syllabuseve në çdo lënde, informacionin në çdo orë mësimi, informimin në lidhje me literaturën detyruese dhe ndihmëse;<br>• Studenti informohet edhe nga struktura e veçanta si DSEF që jep udhëzime, vendime që prekin drejtpërdrejte procesin mësimor;<br>• Sekretaria mësimore luan një rol aktiv në informimin e |

| | |
|---|---|
| | studetëve;<br>• Sisemi BIT-ALBANIA që mundëson një akses të studentit në rregjistrimin në provime, në përcaktimin e progresit të tij në vit akademik etj;<br>• Website i universitetit/ FIE i cili informon studentët në lidhje me kuadrin ligjor në zbatim nga UPT per bursat dhe programet shkencore, aktivitetet që kryhen në territorin e UPT-se, tarifat për regjistrimin dhe pagesat ne çdo vit akademik, mobilitetet për studentët dhe procedurat për aplikim etj. |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. | Drejtoria e Kurrikulave dhe Drejtoria se Komunikimit dhe Koordinimit ne bashkeveprim te ngushte me FIE/DSEF, ndjenin përgjegjësinee, për zhvillimin dhe drejtimin e procesit te këshillimit të karrierës, ofronin asistencë në orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve, mbanin kontakte me të diplomuarit dhe kane krijuar Rrjetin Alumni, duke krijuar mundësi bashkëpunimi me kompanite sipas aktmarrveshjeve për mundësi praktikash dhe punësimi për studentët/alumnit, duke organizuar aktivitete për studentët si trajnime, seminare, workshop-e, *[Ref_003 Organigrama e FIE & DSEF]; [Ref_104 Tutorët e grupeve mësimore FIE-DSEF].*<br><br>Të gjitha strukturat e UPT që kanë lidhje direkt me informimin e studentëve, si zyrat e karrierës, sekretaritë mësimore dhe zyrat e financës kanë të publikuara oraret e pritjes së studentëve me qëllim plotësimin e nevojave të studentëve, *[Ref_120 Shembuj njoftime në web nga departamenti DSEF].* |
| **Kriteri 3.** Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në | Zyra e Karrierës ne UPT, si pjesë përbërëse e mobilitetit rinor, ofron këshillim dhe monitoron zhvillimin e karrierës akademike të studentëve me pikësynim integrimin optimal të të diplomuarve të tij në tregun e punës duke ndërmarre nisma, që synojnë krijimin e vendeve të reja për punë të kualifikuar. Ruan lidhje kulturore, profesionale dhe personale me të diplomuarit, *[Ref_112 Raporti i aktiviteteve të zyrës/njësisë së këshillimi të karrierës].*<br><br>Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMN-it kryente me se miri urën lidhëse midis studentëve dhe tregut të punës, me kontaktet e duhura me punëdhënësit potencial, duke promovuar studentët. Specialistet e ketyre zyrave, nxitn dhe mbështsin krijimtarinë e studentëve, në partneritet të plotë me biznesin dhe |

| | |
|---|---|
| tregun e punës. | mbi bazën e shanseve të barabarta dhe zgjerimin e internshipit. GVJ kostaton se zyrat perkatese ne UPT jane gjithmonë te hapura për aktivitete të përbashkëta me industrinë. |
| **Kriteri 4.** Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. | Zyra e Karrierës njofton vazhdimisht studentët për mundësi për aplikime në lidhje me punësimin e tyre *(http://upt.al/bashkepunime/aktivitete)*. Të gjitha strukturat e UPT, personeli akademik, ndihmës mësimorë shkencorë dhe personeli administrativ angazhohen për zbatimin e politikës për integrimin në punësim të studentëve. Ne UPT disponohen të dhëna, për punësimin e studentëve të vet, me të cilët mbahen kontakte të vazhdueshme. Deri më sot është krijuar një databazë me mbi 200 studente, ku nga keta 29 jane të diplomuar ne kete program studimi, *[Ref_071 Pyetësori dhe databaza Alumni UPT]*.<br><br>*Ne RVB, Standardi V-5, Kriteri 3 theksohet se: Departamenti i Sistemeve Elektrike të Fuqisë ndjek në mënyrë periodike ecurinë në vite të studentëve të diplomuar me qellim analizën e të dhënave të tregut të punës në funksion të përmirësimit të kurrikulave. Pyetësori i fundit eshte pergatitur në **Nëntor 2020** në kuadër të Projektit Engine (Project reference No.619338-EPP-1-2020-1-AL-EPPKA2-CBHE-JP)*<br><br>*[Ref_072 Pyetësori mbi permirsimet e programeve të studimit DSEF]; (https://FIE.edu.al/FIE/alumniae-inxhinieria-Elektrike Energjitike-aim).* |
| **Konkluzione** | *Pranë UPT funksionon Drejtoria e Komunikimit e Koordinimit dhe Karrierës si strukturë përgjegjëse, që zhvillon dhe drejton procesin e këshillimit të karrierës, ofron asistencë në orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve, mban kontakte ne forma te ndryshme me të diplomuarit dhe krijon Rrjetin Alumni.*<br><br>*GVJ rekomandon qe ky bashkepunim UPT-FIE-UPT, te zgjerohet dhe shtrihet me tej ne plotesimin dhe azhornimin ne kohe reale te database me të dhënat mbi punësimin e studentëve, adresat e tyre elektronike etj.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

| Standardi VI.1<br>Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve. | Ne DVV, konkretisht plani strategjik 2019-2024, Kreu VI.5, *"Zhvillimi i infrastrukturës digjitale për përmirësimin e edukimit dhe krijimin e oportuniteteve për personelin akademik"*, përcaktohet se UPT synon të jetë lider në drejtim të përdorimit të IT në të gjithë veprimtarinë e tij duke mbështetur përpjekjet për zhvillimin e infrastrukturës dixhitale në shërbim të mësimit me pikësynim rritjen e përdorimit të software për zhvillim profesional të personelit akademik dhe të studentëve, *[Ref_010 Plani Strategjik 2019-2024 i UPT], [Ref_043 Informimi i studentëve nëpërmjet platformave online]*.<br><br>Në UPT funksionon Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë, e cila promovonë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinon dhe bashkërendon aktivitetet me njësinë kryesore FIE dhe njësinë bazë DSEF në shërbim të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Në këtë kuadër janë hartuar udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies në bazë të fushave të ndryshme të studimit dhe lëndëve specifike, *[Ref 055 Referencë Model Regjistri Hard Copy dhe Elektronikisht nga Sistemi i Sekretarisë Mësimore]*.<br><br>UPT ka unifikuar të sistemit digjital të mësimit në distancë, përmes platformës Microsoft Office me aplikacionet që ajo ofron si Microsoft Teams, Microsoft Forms, etj. *[Ref_083 Udhëzues dhe manual për zhvillimin e mësimit në distancë]*. |
| **Kriteri 2.** Strukturat | DSEF monitoron rregullisht procesin e |






| | |
|---|---|
| përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik. | mësimdhënies/mësimnxënies dhe atë të vlerësimit të studentëve dhe analizon periodikisht situatën duke propozuar përmirësime dhe duke ofruar mbështetje për stafin akademik, *[Ref_014 Raport i aktivitetit mësimor në nivel njësi bazë DSEF-FIE]; [Ref 031 Shembull i parashikimit te ngarkeses mesimore ne DSEF]*.Në këtë kuadër një rëndësi të veçantë kanë edhe sugjerimet që vijnë nga studentët dhe të diplomuarit përmes kontakteve me ta, në mënyrë të drejtëpërdrejtë, përmes koordinatorit dhe mentorëve të programit të studimit, si dhe në mënyrë të tërthortë, përmes pyetësorëve për vlerësimin e procesit mësimor. Përmes rezultateve individuale të personelit akademik, hartohen analiza për të evidentuar pikat e forta dhe problematikat specifike në çdo program studimi, *[Ref_032 Anketimi Studentor]*. |
| **Kriteri 3.** Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve. | UPT garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve nëpërmjet:<br>✓ Pjesëmarrjes së studentëve në procesin e anketimit për çdo lëndë *[Ref_032 Anketimi Studentor]*.<br>✓ Garantimit të së drejtës së studentit për ankimimin e rezultatit të vlerësimit të dijes sipas procedurës së përcaktuar në Rregulloren e e Zhvillimit Kurrikular dhe mësimdhënies në UPT, konkretisht në Nenin 35 të saj, *[Ref_037 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhenies ne UPT]*.<br>Ne vitin akademik (2021-2022) DSEF ka mundur të realizojë procesin e anketimit studentor për vlerësimin e çdo lënde si dhe per te gjurmuar fushat te cilet ata punojne dhe pershtatmerise se vendit te punes me programin e studimit. Kjo u be e munduar nepermjet platformes google form.<br>*https://docs.google.com/forms/d/e/1FAIpQLSceQbCS_-EMGH9QbMEnBUHkNC0vRrTPHANxl0iBWeBCgW4q2A/viewform?vc=0&c=0&w=1&flr=0* |
| **Kriteri 4.** Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit. | Bazuar tek dokumentacioni i vënë në dispozicion si dhe nga takimet me përfaqësues të Drejtorisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Drejtorisë së Kurrikulave, GVJ konstaton se institucioni ka hartuar politika dhe struktura të posaçme për sigurimin e brendshëm të cilësisë në përputhje me parashikimet |

| | |
|---|---|
| | ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. Në UPT funksionon Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë që ka si detyrë rritjen e vetëdijes institucionale për mekanizmat cilësor. Sektori i Statistikës dhe Informacionit të kësaj drejtorie mbledh dhe përpunon vazhdimisht të dhëna sasiore nga të gjitha njësitë përbërëse kryesore dhe bazë të UPT me qëllim raportimin e gjetjeve në organet drejtuese për vendimmarrje.<br><br>Me qëllim sigurimin e cilësisë dhe përputhshmërisë së programeve të studimit të ofruara, në UPT funksionon gjithashtu në nivel institucional, Drejtoria e Kurrikulave. Kjo drejtori kontrollon të gjitha aspektet teknike të lidhura me dokumentacionin e plotë të një programi studimi dhe sugjeron përmirësime në vazhdim të diktuara nga ndryshimet e akteve ligjore dhe nën ligjore. Drejtoria e Kurrikulave çdo vit miraton planet mësimore. Rezultatet e pyetësorëve nga DSBC i transmetohen DSEF, i cili bën analizën përkatëse dhe në bashkëpunim me NjSBC bëhet adresimi i problematikave të evidentuara. Nëpërmjet anketimeve përfshihen të gjithë indikatorët e mësimdhënies, *[Ref_122 Njësia e Sigurimit të Cilësë në FIE Programi i Trasparencës UPT]*. |
| **Kriteri 5.** Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. | DSEF në mënyrë periodike organizon dhe merr në analizë gjithë problematikën që lidhet me procesin mësimor dhe aktivitetin kërkimor. Informacioni i marrë nga pyetësori i studentëve, formulari i vetëvlerësimit të personelit akademik, kontrolleve të ushtruara etj. janë objekt i një analize të thelluar që synon vlerësimin e rezultateve të marra, promovimin e praktikave të mira, si dhe nxitjes dhe inkurajimit të personelit akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies, *[Ref_014 Raporti i Aktivitetit Mesimore ne nivel njesia baze DSEF]*.<br><br>Gjithashtu FIE nxit dhe mbështet financiarisht trajnimin e stafit të saj akademik jashtë vendit *[Ref_125 Mbeshtetje finaciare per kerkim]*. |
| **Konkluzione** | *Në UPT funksionon Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë, e cila promovon përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinon dhe bashkërendon aktivitetet me njësinë kryesore dhe njësinë bazë në shërbim të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *DSID monitoron rregullisht procesin e mësimdhënies/mësimnxënies dhe atë të vlerësimit të studentëve dhe analizon periodikisht situatën duke propozuar përmirësime dhe duke ofruar mbështetje për stafin akademik.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | **Përmbush et kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| | |
|---|---|
| **Standardi VI.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.** | |
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. | UPT (Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë), ka miratuar pyetesorët/procedura të posacshme për sigurimin e brendshëm të cilësisë ka hartuar politika si dhe ka ngritur struktura ne funksion të Sigurimit të Brendëshëm të Cilësise, duke ofruar shërbime sipas standardeve europiane dhe mbështetur në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr.80/2015, pika 1. Më konkretisht:<br>Rrjeti i Cilësisë përbëhet nga:<br>• Njësia Qendrore e Sigurimit të Cilësisë (NJQSC), e ngritur në rektoratin e UPT dhe<br>• Njësitë e Sigurimit të Cilësisë (NJSC) në çdo njësi kryesore të UPT.<br>*[Ref_002 Organigrama eUPT]*.<br>Njësia përgjegjëse për zhvillimin e programit të studimit DSEF (Departamenti i Sistemeve Elektrike të Fuqisë) koordinon punën me NJSBC te FIE, *[Ref_008 Rregullore Njësi Kryesore FIE]*.<br>Në Planin Strategjik 2019-2024, *[Ref_011 Plani Strategjik 2019-2024 i FIE]*, të Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike, theksohet rëndësia e respektimit të standarteve për Sigurimin e cilësisë në veprimtarinë akademike dhe administrative të fakultetit. Zbatimi i standardeve të cilësisë perfshin zbatimin e standardeve akademike, kërkimore, menaxhuese, infrastrukturore, etj me |

| | |
|---|---|
| | qëllim që të arrihen nivele maksimale në procesin mësimor dhe kërkimor. |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. | Pranë FIE është ngritur NJSBC në nivel fakulteti, e cila nxit dhe mbështet punën në kuadër të sigurimit të cilësisë të stafit drejtues, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, studentëve të programit të studimit, si dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm, duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt tyre, *[Ref_010 Plani Strategjik 2019-2024 i UPT, Kreu IV.1]*.<br><br>Në funksion të Sigurimit të brendshëm të cilësisë Departamenti i Sistemeve Elektrike të Fuqisë, *[Ref_056 Njësia bazë dhe programet e studimit që ofrojnë]* operojnë në koherencë të plotë me procedurat e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike FIE, i cili nga ana e tij respekton procedurat që janë përcaktuar nga strukturat e nevojshme në nivel institucioni, në të cilat garantohet dhe përfshirja e stafit dhe studentëve dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm, *[Ref_121 Miratim i grupit të vlerësimit në DSEF per programin e studimit Master Profesional ne Elektroenergjetike]*. |
| **Kriteri 3.** Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit. | NjSBC mbledh të dhënat statistikore dhe përcakton treguesit kyç të performancës për të analizuar kontributin e tyre ndaj arritjes së objektivave strategjikë institucionalë.].<br><br>UPT i është nënshtruar akreditimit të jashtëm institucional dhe është vlerësuar pozitivisht me një akreditim 6 vjeçar të vlefshëm deri në vitin 2028. Institucioni gjithashtu, kujdeset dhe ndjek akreditimin e programeve të tij të studimit në përputhje me legjislacionin në fuqi. |
| **Kriteri 4.** Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve | NjSBC përmes sistemit të saj të informacionit mban të dhëna të ndryshme mbi institucionin dhe mbledh të dhëna nga NjSBC-të në nivel Fakulteti dhe Koordinatorët e Programeve. Të dhënat kryesore statistikore përfshijnë, por nuk kufizohen *[Ref_014Raporti i Aktivitetit Mesimore ne nivel njesia baze DSEF]*:<br>- ecurinë e studentëve dhe nivelet e suksesit;<br>- mundësitë e punësimit të të diplomuarve; |

<table>
<tr><td>cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</td><td colspan="4">- profilin e popullatës studentore;<br>- raportin pedagog/studentë;<br>- plotësimi i kërkesave të studentëve me programet e tyre;<br>- efektivitetin e pedagogëve;<br>- koston e burimeve të mësimnxënies dhe disponueshmërinë e tyre;<br>- monitorimin e situatës së punësimit të të diplomuarve;<br>- nivelin e largimit/transferimit të studentëve;<br>- numrin i stafit dhe studentëve që pranohen dhe largohen;<br>treguesit kyç të performancës së institucionit dhe elementë të ngjashëm.<br>[Ref_032 Anketimi Studentor]; [Ref_028 Mobilitetet e realizuara].</td></tr>
<tr><td>Konkluzione</td><td colspan="4">Nga shqyrtimi i DVV dhe takimet me stafet pergjegjese ne istitucion, GVJ konkludon se njësia përgjegjëse në UPT për sigurimin e cilësisë është Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë me sektoret e saj e saj e cila zhvillon promovimet nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit Master professional ne Energjitike<br>Pranë FIE është ngritur NJSBC në nivel fakulteti. NjSBC mbledh të dhënat statistikore dhe përcakton treguesit kyç të performancës për të analizuar kontributin e tyre ndaj arritjes së objektivave strategjikë institucionalë.</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Shkalla e përmbushjes së standardit</td><td>Nuk përmbushet</td><td>Përmbushet pjesërisht</td><td>Përmbushet kryesisht</td><td>Përmbushet plotësisht</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td></td><td>X</td></tr>
</table>

<table>
<tr><td colspan="2">Standardi VI.3<br>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</td></tr>
<tr><td>Kriteret</td><td>Vlerësimi i ekspertëve</td></tr>
<tr><td>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin</td><td>Dekanati i FIE ne përputhje me procedurat administrative të UPT, eshte shprehur me vendim për miratimin e propozimit për hapjen/ riorganizimin e programit të ri të studimit, e ka përcjelle në rektorat dosjen, vendimin e departamentit, vendimin e dekanatit dhe argumentimin e dekanatit për riorganizimin e këtij</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.<br><br>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit. | programi studimi, nga 60 ne 120 kredite, *[Ref_059 Praktika për riorganizmin dhe rishikimin e Programeve të Studimit FIE]*.<br><br>Institucioni në mënyrë periodike zhvillon pyetësorë me studentët mbi cilësinë e mësimdhënies, që lidhen me stafin akademik/lëndët e zhvilluara dhe pëlqyeshmërinë ndaj tyre. Rezultatet e pyetësorëve analizohen nga Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë.<br><br>Stafi akademik vihet në dijeni individualisht për pyetësorin, i cili lidhet drejtëpërdrejtë me performancën e tij. Departamenti informohet për rezultatet e të gjithë stafit të angazhuar pranë tij.<br><br>Pas analizës së pyetësorëve në nivelet përkatëse, dhe diskutimeve me personat e interesuar, Institucioni merr masa për zgjidhjen e problematikave, *[Ref_037 Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies e UPT, Kreu II]*. |
| **Kriteri 2.** Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët. | Drejtoria e Kurrikulave e Rektoratit, eshte ne procesin e verifikimit ne përputhshmërinë e programit të studimit të rishikuar me standardet e cilësisë, si dhe dokumentacionin e hartuar per propozimin për ndryshim qe pesoj ky program nga 60 ne 120 Kredite, *[Ref_037 Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies e UPT, Neni 15 & 16]*. Këto metoda vlerësimi janë transparente dhe i bëhen me dije individualisht çdo pedagogu.<br><br>Institucioni, FIE, organizon gjithashtu, mbledhje të hapura në të cilat marrin pjesë studentë, staf akademik dhe përfaqësues të tregut të punës, duke nxitur tek ata ndërgjegjësimin dhe rëndësinë e ruajtjes së cilësisë dhe nevojën e përmirësimit dhe korektimin e vazhdueshëm në përputhje me standardet e cilësisë, *[Ref_059 Praktika për riorganizmin dhe rishikimin e Programeve të Studimit FIE]*. |
| **Kriteri 3.** Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, | Referuar natyrës së programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në Elektroenergjetike, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së këtij programi studimi, janë përdorur disa metoda të drejtpërdrejta, duke konsistuar në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit si dhe vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve. Në nivel njësie kryesore, Dekani mbikqyr mbarëvajtjen mësimore, *[Ref_001 Statuti i UPT, Neni13]*. |

| | |
|---|---|
| kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera. | Kryesisht vlerësimi kryesor kryhet përmes analizës mësimore që bëhet cdo fund viti akademik në nivel stafi, departamenti dhe fakulteti, *[Ref_013 Raport i aktivitetit mësimor në nivel njësi kryesore FIE]*.<br><br>Në fillim të vitit akademik Përgjegjësi i DSEF në bashkëpunim me stafin akademik të departamentit kontrollon dhe vlerëson përmbajtjen e syllabuseve, diskutohen në departament dhe aprovohen nga titullari i lëndës. Përgjegjësi i Departamentit kishte planifikuar vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së leksioneve/seminareve etj, *[Ref_008 Rregullore Njësi Kryesore FIE]*.<br><br>Mbyllja e programit të studimit, qe per vitin akademik 2023-2024 kryhej per here te pare eshte planifikuar me ane te provimit të mbrojtjes se Projekt Diplomes, *[Ref_084 Komisione të vlerësimit dhe organizimit të provimeve të diplomes MP]*. |
| **Kriteri 4.** Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program. | Në nivel institutional, Drejtoria e Kurrikulave monitoron cilësinë e zbatimit të kurrikulës, dhe raporton në Rektorat mbi rezultatet e monitorimit. Institucioni përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista me studentët aktualë, me ato të diplomuar (alumni), me personelin akademik, ndihmës akademik e administrativ. UPT disponon të dhëna, për punësimin e studentëve të vet, me të cilët mban kontakte të vazhdueshme. Për ngritjen e rrjetit Alumni ka filluar puna përmes një pyetësori për të identifikuar studentët e diplomuar në UPT dhe për të ndjekur zhvillimin e karrierës së tyre. Deri më sot është krijuar një databazë me mbi 200 të diplomuar që kanë shprehur interes për të qenë pjesë e rrjetit Alumni në UPT, *[Ref_071 Pyetësori dhe databaza Alumni dhe Engine]*. Të diplomuarit i përkasin periudhës kohore 2002-2022 dhe konstatohet qe janë të punësuar aktualisht në masën 88%. 78% e numrit total të të anketuarve punojnë sot në profesionin e tyre. 57% e të anketuarve janë punësuar për herë të parë ende pa mbaruar studimet dhe 36% e tyre janë punësuar brenda vitit të parë të diplomimit.<br><br>Në nivel fakulteti në FIE keto probleme ndiqeshin nga specialisti i Karrierës dhe Alumnit ku eshte krijuar dhe përditësohet rregjistri perkates me qëllim ndjekjen e studentit nga fillimi studimeve deri në punësin, *[Ref_071 Pyetësori dhe databaza Alumni dhe Engine]*.<br><br>UPT favorizon punësimin e studentëve dhe ish studentë ekselentë |

| | |
|---|---|
| | brenda Universitetit, si personel akademik efektiv dhe me kontratë, kur ata plotësojnë kriteret e punësimit të stafit akademik si dhe si staf akademik ndihmës dhe administrativ, *[Ref_025Procedura e Punësimit në FIE-DSEF]*, *[Ref_026Praktika e Punësimit në FIE-DSEF]* Kompanitë e ndryshme në bazë të kritereve të tyre përzgjedhin drejtpërdrejtë studentët e regjistruar në sistemin GRADUA. |
| **Konkluzione** | *GVJ kostaton se Institucioni monitoron dhe vlerëson në mënyrë periodike cilësinë e programit të studimit ne FIE, DSEF, me metoda të drejtëpërdrejta dhe të tërthorta përmes Drejtorisë së Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë, si njësi përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Në mënyrë periodike zhvillon pyetësorë me studentët mbi cilësinë e mësimdhënies, që lidhen me stafin akademik/lëndët e zhvilluara dhe pëlqyeshmërinë ndaj tyre. Rezultatet e pyetësorëve analizohen nga Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë.*<br><br>*UPT, FIE favorizon punësimin e studentëve dhe ish studentë ekselentë brenda Universitetit, si personel akademik efektiv dhe me kontratë, kur ata plotësojnë kriteret e punësimit të stafit akademik si dhe si staf akademik ndihmës dhe administrativ*<br><br>*Kompanitë e ndryshme në bazë të kritereve të tyre përzgjedhin drejtpërdrejtë studentët e regjistruar në sistemin GRADUA.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.4**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe | Në kuadër të programit të studimit *Master Profesional ne Elektroenergjetike*, Institucioni nxit dhe garanton plotësimin e standardeve të cilësisë dhe përfshirjen e gjithë aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të tij në politikat dhe procedurat që lidhen me to. Njëkohësisht në këto dokumente përcaktohen qartë përgjegjësitë dhe detyrat konkrete për njësitë, individët, studentët |

| | |
|---|---|
| të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. | dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit.<br>*[Ref_121 Miratim i grupit të vlerësimit në DSEF per programin e studimit Master Profesional ne Elektroenergjetike].* |
| **Kriteri 2.** Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. | Në Rregulloren e brendshme të FIE, *[Ref_008 Rregullore Njësi Kryesore FIE]* si dhe në Rregulloret e departamenteve përgjegjës *[Ref_009 Rregullore Njësi Bazë DSEF_FIE]*, për këtë program studimi.Studentët janë pjesëmarrës edhe në NJQSC/NJSC dhe në KPS, *[Ref_073 Këshillat e Programeve të Studimit dhe Kordinatorët]*.<br>Përfaqësimi i studentëve si instrument i rëndësishëm realizohet nga tërheqja e mendimit, përfaqësimin e tyre në senat dhe në organe të tjera vendimmarrëse të institucionit, *[Neni 49 & 51, Ref_001 Statuti i UPT]*.<br>Funksionet e KPS dhe detyrat e Koordinatorit të programit të studimit si edhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët, pedagogët dhe palë të tjera të angazhuara për garantimin e cilësisë së programit të studimit përcaktohen në Rregulloren e zhvillimit kurrikular dhe mësimëdhënies *[Neni 4 & 5 & 6, Ref_037 Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies e UPT]*. |
| **Kriteri 3.** Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit. | Për monitorimin në vijimësi të programit te studimit MP ne Energjitike eshte ngritur dhe funksionon KPS, *[Ref_073 Këshillat e Programeve të Studimit dhe Kordinatorët]*.Ndërsa për vlerësimin e sigurimit të cilësisë janë ngritur Grupet e Vlerësimit të Brendshëm, të cilët në përbërje të tyre kanë përvec stafit akademik edhe student, *[Ref_121 Miratim i grupit të vlerësimit në DSEF per programin e studimit Master Profesional ne Elektroenergjetike]*.Këto komisione janë të krijuari rishtazi, Dekanati i mbështet dhe orienton ne politikat për zhvillimin e monitorimin e ofertës akademike të fakultetit dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit. Studentët perfshihen si aktorë aktiv në pyetësorin e organizuar prej NJQSC-së në fund të cdo semestri për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies për cdo lëndë, *[Ref_109 Raportet vjetore të publikuara për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë]*. |
| **Kriteri 4.** Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të | Gjatë implementimit të instrumentave të drejtpërdrejta dhe tërthorta të përdorur prej strukturave përkatëse me qëllim |

| | |
|---|---|
| brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. | vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit është respektuar liria dhe etika akademike si dhe Ligji Nr.9887 datë 10.03.20008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Vlerësimi i cilësisë së programit të studimit Master Profesional ne Elektroenergjetike realizohet nga studentët e çdo kursi në mënyrë anonime duke tentuar të ruajë anonimatin e tyre edhe pse anketimit kryhet përmes përdorimit të sistemit BIT-ALBANIA me numrin e identifikimit që ka çdo student. Kontrolli i procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies ka garantuar bazarinë e plotë midis anëtareve të stafit akademik si dhe midis studentëve. Në FIE ***nuk ka asnjë*** praktikë ankimimi nga ana e studentëve apo stafit akademik dhe administrativ në shërbim të tyre për diskriminim dhe pabarazi |
| **Kriteri 5.** Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj. | Njësia Bazë DSEF në mungesë të një strukture të konsoliduar të vlerësimit të cilësisë operon me të njëjtat metodologji dhe instrumenta që NJSBC/NJQSC-së. Ekziston një praktikë periodike vjetore e marrjes së feedback-ut nga ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit, duke përfshirë biznesmenë, institucione publike dhe private ku të diplomuarit e një program studimi janë punësuar.Ekspertiza e tyre ka qenë e vlefshme sidomos në përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie, në aspektet e lidhjes së teorisë me praktikën. Mendimi i ekspertëve është tërhequr jo vetëm nëpërmjet angazhimit të tyre në mësimdhënie, por edhe në takime të ndryshme, në leksione të hapura, work-shop apo ne anketime dhe pyetesor te realizuar nga Departamenti DSEF,*[Ref_029 Rezultatet e pyetesorit UPT]*. |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se në kuadër të programit të studimit Master Profesional ne Elektroenergjetike, Institucioni nxit dhe garanton plotësimin e standardeve të cilësisë dhe përfshirjen e gjithë aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të tij në politikat dhe procedurat që lidhen me to. FIE, DSEF, personeli akademik, studentët dhe bashkëpunëtorët e jashtëm të Institucionit përfshihen dhe informohen në mënyrë të vazhduar mbi procesin e sigurimit të brendshëm të cilësisë.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi VI.5**<br>**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. | Institucioni është transparent me studentët dhe të gjithë të interesuarit lidhur me veprimtaritë në kuadër të SBC. GVJ gjatë vizitës, konkludoi se studentët dhe stafi kishin informacion të konsiderueshëm lidhur me veprimtaritë e Institucionit në funksion të SBC, duke krijuar kështu një universitet të hapur e transparent me të gjithë aktorët e brendshëm e të jashtëm të tij. |
| **Kriteri 2.** Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. | Stafi akademik vihet në dijeni individualisht për pyetësorin, i cili lidhet drejtëpërdrejtë me performancën e tij. Departamenti informohet për rezultatet e të gjithë stafit të angazhuar pranë tij, *[Ref_109 Raportet vjetore të publikuara për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë]*.Këto raporte publikohen online në web-in e UPT, *[https://upt.al/cilesia-ne-upt]*. |
| **Kriteri 3.** Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. | Pas analizës së pyetësorëve mbi indikatorët në nivelet përkatëse, dhe diskutimeve me personat e interesuar, Institucioni merr masa për zgjidhjen e problematikave.Përmes rezultateve individuale të personelit akademik, hartohen analiza për të evidentuar pikat e forta dhe problematikat specifike, këto analiza përmblidhen në trajtë raporti dhe i përcillen njësive kryesore dhe atyre bazë për të zhvilluar analiza të mëtejshme e për të vijuar punën mbi përmirësimin e cilësisë. Raportet janë publike dhe të aksesueshme online, *[Ref_109 Raportet vjetore të publikuara për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë] [https://upt.al/cilesia-ne-upt]*. |
| **Kriteri 4.** Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të | Nga studimi i DVV, GVJ veren se përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies ne UPT eshte bazuar në strukturat përkatëse si Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Drejtoria e Kurrikulave, *[Ref_002 Organigrama e UPT]*. Analizat periodike dhe ndërgjegjësimi për rëndësinë e ruajtjes së cilësisë |

| | |
|---|---|
| cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. | mundësojnë përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. Pranë departamenteve janë ngritur Këshillat e Programeve të Studimit (KPS) për çdo program studimi nën përgjegjësinë e departamentit si dhe janë caktuar koordinatorët e programeve të studimit, *[Ref_073 Këshillat e Programeve të Studimit dhe Kordinatorët]*. KPS benin rishikimin e programit të studimit, mbështetur në nevojat e tregut të punës, zhvillimet në rajon, e më tej, si dhe propozimet e ardhura nga mësimdhënësit, *[Ref_013 Raport i aktivitetit mësimor në nivel njësi kryesore FIE]; [Ref_014 Raport i aktivitetit mësimor në nivel njësi bazë DSEF_FIE]*, anketimet e studentëve, *[Ref_032 Anketimi Studentor]*,ndryshimet në infrastrukturën laboratorike, *[Ref_096 Blerje Pajisje Laboratorike FIE]*,rezultatet e projekteve të ndryshme të mbështetura nga Bashkimi Europian ose nga vende te tjera të lidhura me zhvillim kurrikular në Shqipëri, *[Ref_095 Projekte Ndërkombëtare (Engine) DSEF]*, kërkesa të ardhura nga biznesi ose qeveria, si përgjigje e kërkesave të tregut të punës, etj. *[Ref_023 Sondazhe mbi tregun e punës dhe kompanitë]*. |
| **Kriteri 5.** Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. | Institucioni organizon mbledhje të hapura, në të cilat marrin pjesë studentë, staf akademik dhe përfaqësues të tregut të punës, duke i informuar ata dhe duke nxitur ndërgjegjësimin dhe rëndësinë e ruajtjes së cilësisë dhe nevojën e përmirësimit të vazhdueshëm në përputhje me standardet e cilësisë.<br><br>Institucioni organizon aktivitete dhe seminareve informuese me studentët, kryesisht në trajtën e fushatave informuese me qëllim ndërgjegjësimin e studentëve mbi rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre në procesin e përmirësimit të cilësisë së programeve të studimit dhe shërbimeve administrative që ata marrin në institucion, *[Ref_060 Broshura informuese, guida për studentët]; [Ref_061 Aktivitete informuese mbi programet e studimit]; [Ref_076 Aktivitetet e studenteve në FIE-DSEF]*. |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se Institucioni nepermjet aktiviteteve te ndryshme dhe larmishme qe organizon është transparent me studentët, stafinakademik dhe të gjithë të interesuarit lidhur me veprimtaritë në kuadër të SBC duke krijuar një kulturë të cilësisë brenda Institucionit.* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI | | | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

**<u>Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në</u> "Elektroenergjitikë"**

a. **Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Departamenti i Sistemeve Elektrike të Fuqisë, kujdeset në përditësimin e vazhduar të programit të studimit, në kohërencë më politikat kombëtare në lidhje me energjinë, në përputhje me nevojat e tregut të punës, kurrikulat analoge të IAL-ve në vëndet perëndimore dhe përmireson infrastrukturën në kuadër të bashkëpunimeve;
2. Institucioni në funksion të këtij programi studimi, disponon laboratorë me pajisje bashkëkohore për zhvillimin e aftësive të studentëve dhe është pjesëmarrës në shumë projekte kërkimore shkencore;
3. Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me Institucione vendase dhe të huaja, përmes të cilave mundëson shkëmbimin e stafit dhe studentëve, ndarjen e eksperiencave dhe zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve në përputhje me nevojat e programit të studimit;
4. Programi i studimit mbulohet plotësisht nga një staf akademik i kualifikuar, qe ka eksperiencë të gjatë akademike dhe profesionale në mësimdhënie, në oponenca teknike, ekspertiza dhe shërbim ndaj palëve të treat;

b. **Pika të dobta:**

1. Institucioni disponon një databaze të kufizuar me numrin e studentëve të diplomuar, ecurinë e tyre dhe adresat elektronike; ***(Standardi V.6, kriteri 4)***

**Rekomandime:**

1. Istituioni të thellojë dhe zgjerojë më tej bashkëpunimin midis Drejtorive në UPT dhe FIE, në plotësimin dhe azhornimin në kohë reale të database me të dhënat mbi punësimin e studentëve,

adresat e tyre elektronike për ta shfrytëzuar në analizën e të dhënave të tregut të punës dhe në funksion të përmirësimit të kurrikulave.

**Evaluation's conclusions for the first cycle study program Professional Master "Electroenergetics"**

a. **Strengths and affirmations:**

1. The Faculty of Electrical Engineering and the Department of Electrical Power Systems takes care of the continuous updating of the study program, in time with the national policies related to energy, in accordance with the needs of the labor market, the analog curricula of HEIs in EU member states and improves the infrastructure within the framework of cooperation;
2. The institution in function of this study program has laboratories with modern equipment for the development of students' skills and is a participant in many scientific research projects;
3. The institution has cooperation agreements with local and foreign institutions, through which it enables the exchange of staff and students, the sharing of experiences and the development of professional practices of students in accordance with the needs of the study program;
4. The study program is fully covered by a qualified academic staff, who has long academic and professional experience in teaching, in technical oppositions, expertise and service to third parties;

b. **Weaknesses:**

1. The institution has a limited database with the number of graduated students, their progress and electronic addresses; ***(Standard V.6 criterion 4)***

**Recommendation**

1. The institution further deepens and expands the cooperation between the Directorates at UPT and FIE, in completing and updating in real time the database with data on the employment of students, their electronic addresses to be used in the analysis of labor market data and in function of curriculum improvement;

**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

| FUSHAT E VLERËSIMIT | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Nuk përmbushen | Përmbushen pjesërisht | Përmbushen kryesisht | Përmbushen plotësisht |
| I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË | | | | X |
| III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT | | | | X |
| IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE | | | | X |
| VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| VLERËSIMI TËRËSOR | | | | X |